



**RAPORTI VJETOR I
MONITORIMIT TË GJYKATAVE**

**COURT MONITORING
ANNUAL REPORT
GODIŠNJI IZVEŠTAJ O
MONITORINGU SUDOVA**

**20
11**

Prishtinë, Qershor 2012

Pristina, June 2012

Priština, Juni 2012

Raporti është shkruar nga:

Genc Nimoni, Koordinator i
Projektit të Monitorimit të
Shërbimeve Publike

Hulumtues/Monitorues:

Florent Spahija, Petrit
Kryeziu, Besiana Gashi, Vlora
Osmani, Erëlehta Popaj, Ukë
Selimaj, Arlind Loxha, Qazim
Hasanaj, Ridvan Ismaili,
Avdyl Beqiri, Ardian Lulaj,
Leart Kryeziu, Mërgime
Ujkani.

**Menaxher i Projektit të
Monitorimit:**

Faik Ispahiu, Drejtor i
Internews Kosova dhe
producent ekzekutiv i
emisionit "Jeta në Kosovë
dhe" Drejtësia në Kosovë".

Kryeredaktore:

Jeta Xharra, Drejtoreshë e
BIRN-it për Kosovë

Zhvillimi i Mediave:

Përkthimi:

NSHP Transcript

Dizajn dhe shtyp:

One Production



Copyright © 2012,

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN

BIRN-i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë.

Botuar nga:



Balkan Investigative Reporting Network

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese

BIRN (Kosovë)

Mensa e Studentëve, kati i parë 10000

Prishtinë, Kosovë

Tel. & Fax: +381 38 22 44 98

E-mail: kosova@birn.eu.com

Ueb: www.birn.eu.com

“Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e BIRN-t dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian”

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
TRANSPARENCA:	9
1. Moslajmerimi i gjykimeve ne tabelen e shpalljeve	9
Mbajtja e gjykimeve ne zyra te gjykatesve	11
Gjyqesia e Izolimit (mungesa e zedhenseve)	13
TE GJETURAT PERMBAJTESORE:	17
1. Problemi me ftesat gjyqesore	17
2. Funkcionaliteti i gjykatave Model.....	20
4. Raporti i Zgjedhjeve te fundit te mbajtura ne Kosove	23
5. Procesi emerimit te gjykatesve dhe prokuroreve	25
6. Certifikata hetimore	28
7. Parashkrimi	31
III. SHKELJET PROCEDURALE GJATE SHQYRTIMIT GJYQESOR:	34
Shkeljet procedurale dhe te Kodit Penal	34
IV. Te gjeturat gjate gjykimeve	38
1. Caktimi i pa-koordinuar i seancave gjyqesore mes gjykatesve e prokuroreve	38
2. Vonesa e fillimit te gjykimeve	39
3. Mospergatitja e prokuroreve ne gjykim	46
4. Pasiviteti i anetareve te trupit gjykues (porote) gjate gjykimit	48
5. Dëshmia e dëshmitareve gjate gjykimit	50
6. Perktimi gjate mbajtjes se gjykimeve	53
7. Procesverbalet e gjykimeve	54
TE GJETURAT TEKNIKE	56
1. Mosefikasiteti i policise per urdherarrest	58
2. Problemet me transportin e te paraburgosurve per gjykim	59
3. Mos perdorimi i pajisjeve elektronike neper gjykata	59
4. Perdorimi i telefonave celular gjate mbajtjes se gjykimeve	60
5. Mosmbajtja e uniformes nga ana e gjykatesve, prokuroreve dhe avokateve gjate gjykimeve ..	62
TJERA:	63
Tranzicioni ne Gjykata	63
Pirja e duhanit ne gjykatat tona vazhdon te jete shqetesuese	65
Urdherat Ndeshkimore	65
REKOMANDIMET:	68

HYRJE

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese për të katërtin vit më rradhë ka vazhduar monitorimin e procedurave gjyqësore pranë gjykatave të nivelit suprem, të qarkut dhe atyre komunale.

Edhe përkundër përpjekjeve të shumta për ta përmirësuar gjendjen e sistemit të drejtësisë në Kosovë, monitorimi njëvjeçar ka identifikuar mungesa dhe shkelje të ndryshme në këtë proces, nga ato procedurale ligjore, teknike e deri te ato të natyrës etike.

Mostransparenca e gjyqësorit është një ndër karakteristikat që vazhdon ta shoqërojë këtë sistem. Moslajmërimi i gjykimeve në tabelën e shpalljeve dhe mbajtja e seancave në zyrat e gjykatësve, vazhdon të jetë shqetësuese edhe këtë vit. Gati gjysma e seancave të monitoruara, nuk kanë qenë të lajmëruara në tabelën e shpalljeve. Për këtë shkak, publiku përkatësisht të interesuarit për gjykime, nuk kanë pasur mundësi për përcjelljen e shqyrtimeve publike.

Një mungesë e këtyllë e transparencës ka ndikuar edhe më shumë për të thelluar përshtypjen në publik se gjyqësori qëllimisht po krijon huti dhe mjegull, për të fshehur parregullësi dhe keqpërdorime. Kjo përshtypje po i hedhë hije të keqe të gjitha përpjekjeve dhe zhvillimeve tjera pozitive në gjyqësor, sidomos kur dihet se shpallja e orarit të gjykimeve nëpër tabelat e lajmërimit është diçka që mund të realizohet shumë lehtë dhe thjeshtë, duke dëshmuar një përpjekje dhe përcaktim ndaj të qenurit të hapur ndaj publikut.

Nga monitorimi i BIRN-it po ashtu janë identifikuar shkelje procedurale dhe shkelje të të drejtave të palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor. Monitoruesit tonë kanë identifikuar

si shkelje procedurale edhe fillimin e seancave pa përbërjen e plotë të trupit gjykues, mos leximin e të drejtave të dëshmitarëve dhe palëve tjera në procedurë, si dhe shkelje tjera procedurale.

Në kuadër të raportit, janë trajtuar po ashtu tema tjera përmbajtësore, probleme këto më të cilat përballet gjyqësori i Kosovës. Sikurse në vitin e kaluar, po ashtu edhe gjatë këtij viti gjyqësori është përballur me problemin e ftesave gjyqësore, të cilat edhe këtë vit kanë shkaktuar zvarritje të gjykimeve.

Çertifikatat hetimore të cilat lëshojnë gjykatat, janë jounike dhe ndryshojnë nga gjykata në gjykatë. Gjatë periudhës për të cilën raportohet në këtë dokument, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) nuk ka nxjerrë një rregullore që do të unifikonte çertifikatat dhe taksat për çertifikatat. Përveç kësaj, nuk ekziston një koordinim i duhur në mes të gjykatave, më rastin e lëshimit dhe pajisjes më këto çertifikata.

Monitorimi i BIRN në gjykimet që kanë të bëjnë me keqpërdorimet në zgjedhje, ka identifikuar probleme tjera të cilat rezultojnë me zvarritje të gjykimeve për zgjedhjet dhe krijimit të përshtypjes në publik se gjykatat janë duke shqiptuar dënime tepër të lehta në krahasim me trendin e krijuar për kryerjen e këtyre veprave.

Gjithashtu, në këtë raport, është trajtuar kultura trashëguesë në Kosovë, me ç'rast monitoruesit e BIRN kanë identifikuar probleme dhe papërgjegjësi nga organet kompetente komunale me rastin e lëshimit të aktvdekjeve dhe njoftimit zyrtar të gjykatës për këtë.

Ndër problemet e shumta që vazhdojnë ta shoqërojnë gjyqësorin tutje, është ai me parashkrimin/vjetërsimin e lëndëve. Edhe pse ekziston një numër i madh i lëndëve që janë parashkruar dhe që rrezikojnë parashkrimin, në mes tjerash edhe për fajin e gjykatësve, ende nuk kemi parë që ndonjë gjykatës të jetë thirrur ose të ketë dhënë përgjegjësi për këtë. Ekzekutimi i lëndëve po ashtu është trajtuar në raportin e BIRN, e që vazhdon ende të jetë në numër të madh.

Edhe pse të trajtuara vazhdimisht nga BIRN, të gjeturat teknike vazhdojnë të jenë të njëjtat, duke parë një përparim të vogël nga viti në vit. Me rastin e caktimit të seancave gjyqësore, gjykatësit dhe prokurorët jo rrallë herë kanë qenë të pakoordinuar. Si pasojë e kësaj, shumë seanca nuk janë mbajtur fare për shkak se në të njëjtën kohë kanë qenë të caktuara seanca tjera gjyqësore. Në kuadër të kësaj, edhe fillimi më vonësë i seancave gjyqësore ka bërë që seancat, përveç se nuk kanë filluar në kohën e paraparë, kanë ndikuar në shtyrjen e seancave tjera dhe në grumbullimin edhe më të madh të lëndëve.

Si të gjetura tjera teknike, të cilat fatkeqësisht po konsiderohen si shkelje të natyrës së lehtë dhe rrjedhimisht të "tolerueshme" për shkak të ngarkesës së madhe dhe kushteve jo aq të mira, janë po ashtu përdorimi i telefonit celular gjatë gjyqimit, mos-mbajtja e uniformës, problemet në përkthim gjatë mbajtjes së gjykimeve, problemet në hartimin e procesverbaleve të sakta, etj.. Edhe pse probleme teknike, të gjitha këto ndikojnë në mbarëvajtjen e shqyrtimeve gjyqësore.

Shqiptimi i dënimeve nga gjykatësit, në të shumtën e rasteve vazhdon të jetë nën minimumin e paraparë më ligj, duke vërtetuar edhe njëherë mungesën e një politike ndëshkimore në të gjithë sistemin e cila korespondon me situatën reale dhe në terren.

Hapësira brenda gjykatave gjithashtu është trajtuar në raport, duke bërë krahasimin në mes të gjykatave model dhe atyre jo model, duke treguar kështu përparësitë e gjykatave model si dhe mangësitë të cilat kanë mbetur pas transformimit të tyre edhe pasi gjykatat kanë filluar të punojnë në këtë sistem.

Në raport janë trajtuar gjithashtu tema tjera në kuadër të gjyqësorit në Kosovë, duke përmbledhur në tërësi problemet kryesore që shoqërojnë gjykatat dhe tërë sistemin e drejtësisë në Kosovë.

METODOLOGJIA

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN që nga marsi 2008 ka filluar projektin e monitorimit të shërbimeve publike në tre sektorë: gjyqësi, arsim dhe shëndetësi.

Monitorimi i gjykatave fillimisht shtrihej në 7 komuna të Kosovës duke mbuluar 4 gjykata të qarkut dhe 6 komunale, për tu zgjerruar në vitin 2009 në 13 komuna dhe duke monitoruar kështu 18 gjykata të rregullta të Kosovës: në gjykatat e qarkut në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicë; në gjykatat komunale në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Deçan, Vushtrri, Podujevë, Lipjan, Klinë dhe Istog si dhe në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë.

Duke parë rezultatin e punës së monitorimit, veçanërisht në sistemin e gjyqësisë, në vitin 2010/11 BIRN ka zgjeruar projektin e monitorimit në 26 komuna të Kosovës, duke mbuluar kështu të gjitha gjykatat komunale dhe ato të qarkut në Kosovë.

Raporti i BIRN-it për monitorimin e gjykatave është përpiluar në bazë të monitorimit vazhdueshëm në këto gjykata të rregullta. Monitorimi i BIRN-it e përmban matjen kuantitative, me çrast janë plotësuar pyetësorë në bazë të vëzhgimit direkt të seancave gjyqësore të monitoruara.

Përderisa gjatë vitit 2008 (mars 2008 – mars 2009) ishin monitoruar 513 seanca gjyqësore, në vitin 2009 (qershor 2009 – mars 2010) janë monitoruar 1,248 sish. Në vitin 2010 (prill 2010 – shkurt 2011), janë monitoruar 2,147 gjykime, kurse tani gjatë periudhes mars 2011 – dhjetor 2011, BIRN ka monitoruar gjithsej 2525 seanca gjyqësore nga të cilat 1920 janë gjykime të mbajtura ndërsa 605 gjykime nuk janë mbajtur. 1920 Pyetësorët e plotësuar nga gjykimet e mbajtura, përmbajnë pyetje rreth mbarëvajtjes së proceseve gjyqësore, për të cilat në raportet e sajë në vitet e kaluara, BIRN-i ka dhënë rekomandime.

Periudha	2008/09	2009/10	2010/11	2011	total
Seanca	513	1,248	2,147	2,525	6,433

Për ndryshim nga viti kaluar, në raportin e këtij viti përveç shkeljeve procedurale dhe të gjeturave teknike, BIRN ka trajtuar tema përmbajtësore që shoqërojnë çdo ditë

gjyqësorin e Kosovës. Rezultatet e këtyre pyetësorëve janë pjesë e këtij raporti në formë të të dhënave kuantitative.

1. Për shkak të gjendjes politike në Mitrovicë, ku gjykatat e kësaj komunë gjenden në pjesën veriore, ekipi i monitoruesve të BIRN-t nuk ka monitoruar në pjesën veriore, mirëpo ka monitoruar seanca nga këto gjykata, e të cilat janë mbajtur në objektin e Gjykatës Komunale në Vushtrri për shkak të funksionimit të vet në kushte të jashtëzakonshme për shkak të pamundësisë për të funksionuar në ndërtesën e vet legjitime në Mitrovicë.

Ndërsa sa i përket anës kualitative, në këtë raport janë paraqitur vetëm ato raste që janë përsëritur në të gjitha gjykatat gjatë kohës së monitorimit. Për çdo pjesë të raportit për këto raste, është paraqitur së paku nga një shembull konkret. Në mënyrë që teksti mos të ngarkohet, shumica e shembujve të marrur janë paraqitur në fusnota.

Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e BIRN-it, përveç përcjelljes së drejtpërdrejtë të seancave gjyqësore, kanë zhvilluar edhe intervista të vazhdueshme me kryetarë gjykatash, gjykatës, kryeprokurore, prokurorë, avokatë, palë tjera në procedurë si dhe me zyrtarë të institucioneve relevante të drejtësisë, si me zyrtarë të KGJK-së, Policisë së Kosovës, Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi pranë Kuvendit të Kosovës, Odës së Avokatëve të Kosovës, etj..

Përveç monitorimit të gjykimeve dhe pyetësorëve të plotësuar, BIRN gjithashtu ka trajtuar tema nga drejtësia edhe në emisionin “Drejtësia në Kosovë”. Në kuadër të këtij emisioni, janë trajtuar tema aktuale që kanë karakterizuar zhvillimet më të reja nga sektori i gjyqësisë në Kosovë. Gjithashtu janë përgatitur edhe reportazhe televizive për praktika dhe fenomene pozitive dhe negative të hasura gjatë këtij viti të monitorimit.

Vetëm në disa raste, këto emisione dhe reportazhe kanë pasur ndikim të menjëhershëm, ngase institucionet përkatëse kanë ndërmarrë hapa konkret për tejkalimin e atyre situatave, duke suspenduar edhe njëherë që kanë abuzuar më pozitën e tyre.

TRANSPARENCA

1. Moslajmërimi i gjykimeve në tabelën e shpalljeve

Parimi i publicitetit gjatë ushtrimit të funksioneve publike është parim i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore. I gjithë ky legjislacion garanton që gjykimet duhet të jenë të hapura dhe transparente, seancat gjyqësore janë publike dhe se çdo qytetar ka të drejtë të jetë i informuar për shqyrtimet publike.


Moslajmërimi i gjykimeve në tabelën e shpalljeve, të cilën duhet ta bëjë secila gjykatë vazhdon të përsëritet duke bërë kështu që gjykatat të jenë të mbyllura ndaj publikut.

Sidoqoftë, në krahasim me vitin e kaluar, është shënuar një përmirësim i dukshëm në shpalljen e tyre.

Vitin e kaluar, nga 2,147 seanca të monitoruara, 49.9% e tyre kanë qenë të lajmëruara në tabelën e shpalljeve. Në tabelën në vijim, mund të vërejmë se gjatë vitit 2011 nga 1,920 seancat e monitoruara të mbajtura, 72.12 % e tyre kanë qenë të lajmëruara në tabelën e shpalljeve.

Përkundër progresit të shënuar, monitorimi i gjykatave tregon që gjykatat ende nuk janë duke e përmbushur obligimin e tyre për të publikuar informatat të cilat qytetarëve do t'ua lehtësonin qasjen në drejtësi.

Numri i seancave të monitoruara të cilat kanë qenë/nuk kanë qenë të lajmëruara në tabelën e shpalljeve



2. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 328, Pika 1, Shqyrtimi gjyqësor është i hapur; Ligji për Procedurën Kontestimore, Neni 444, Pika 1, Shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet publikisht.

Prej gjykatave të monitorura, gjykata komunale e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjilanit dhe Vushtrrisë prijnë për nga numri më i madh i moslajmërimit të seancave në tabelën e shpalljes.

Derisa vitin e kaluar, Gjkata Komunale e Prishtinës nuk ka lajmëruar asnjëherë gjykimet në tabelën e shpalljeve, këtë ka filluar ta bëjë nga maji i 2011-ës kur edhe është inaguruar si gjykatë model.


Sipas të dhënave të siguruar nga monitorimi njëvjeçar, kjo gjykatë ka lajmëruar vetëm 12% të seancave gjyqësore, kundrejt 88% të cilat nuk kanë qenë të lajmëruara. Këto të dhëna vazhdojnë ta rangojnë Gjykatën Komunale të Prishtinës si gjykata më jotransparente në Kosovë.

Mirëpo jo vetëm Gjkata Komunale e Prishtinës shquhet për nga mungesa e transparencës.

Nga monitorimi i BIRN, identifikohen edhe gjykata tjera të cilat asnjëherë nuk lajmërojnë gjykimet në tabelën e shpalljeve. Nga 33 seancat e monitoruara në Gjykatën Komunale në Podujevë, asnjëra ndër to nuk ka qenë e lajmëruar në tabelën e shpalljeve. Në gjendje të ngjashme qëndron Gjkata Komunale në Vushtrri, e cila në 78% (94 gjykime) të gjykimeve të monitoruara, nuk ka lajmëruar në tabelën e shpalljeve.

Për të dhënë një pasqyrë më të qartë të situatës rreth shpalljes së orarit të seancave të gjykimeve, në vazhdim e kemi publikuar tabelën në të cilën mund të shihet se si dallon nga komuna në komunë dukuria e përmbushjes së këtij obligimi ndaj të qenurit më transparent ndaj publikut.

Numri i seancave të monitoruara të cilat kanë qenë/nuk kanë qenë të lajmëruara në tabelë e shpalljeve



Kryetarët e gjykatave janë ata të cilët bartin përgjegjësinë kryesore për këtë mungesë dhe të cilët vazhdojnë të mos ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që secili gjykim, të jetë i lajmëruar në tabelë, përmes së cilës, do të njoftoheshin qytetarët dhe të gjithë të interesuarit për shqyrtimin publik.

Mirëpo që nga janari i këtij viti, pothuajse në të gjitha gjykatat, janë vendosur ekranet LCD, të cilët shërbejnë për lajmërimin e gjykimeve. Pothuajse të gjitha gjykatat, lajmërojnë në baza mujore gjykimet e tyre, të cilat do të trajtohen në raportin vijues të BIRN-it për periudhën raportuese të vitit 2012.

2. Mbajtja e gjykimeve në zyra të gjykatësve

Mbajtja e gjykimeve në zyrat e gjykatësve, vazhdon të jetë e pranishme ende në gjykatat tona, gjë e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në uljen e transparencës së gjykatave. Mbajtja e tyre në zyra dhe jo në sallat e gjykimin, pamundëson në masë të madhe pjesëmarrjen e publikut në seanca gjyqësore duke thyer kështu parimin e publicitetit, si një ndër parimet bazë të mbajtjes së një shqyrtimi gjyqësor.


3. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 328, Pika 1. Shqyrtimi gjyqësor është i hapur; Ligji për Procedurën Kontestimore, Neni 444, Pika 1, Shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet publikisht.

Sipas tabelës në vijim, e cila është ndërtuar në bazë të të dhënave të mbledhura gjatë monitorimit, del se 55.63% apo 1,068 seanca janë mbajtur në zyret e gjykatësve. Kjo e dhënë shqetësuese nuk ka ndryshuar shumë nga viti i kaluar ku prej 2,147 seancave të monitoruara, 57% e tyre ishin mbajtur në zyret e gjykatësve, Prishtina vazhdon të prijë

me numrin më të madh të gjykimeve të mbajtura në zyret e gjykatës.

Gjykata Komunale e Prishtinës 95% të gjykimeve i ka mbajtur në zyrat e gjykatësve. Kjo gjykatë posedon dy salla të gjykimeve, të cilat ka ndodhur të jenë të lira gjersa gjykimet mbaheshin në zyret e gjykatësve.

Vendi I mbajtjes së seancave gjyqësore?



Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të gjykimeve të mbajtura në zyret e gjykatës. Gjykata Komunale e Prishtinës 95% të gjykimeve i ka mbajtur në zyrat e gjykatësve. Kjo gjykatë posedon dy salla të gjykimeve, të cilat ka ndodhur të jenë të lira gjersa gjykimet mbaheshin në zyret e gjykatësve.

Nga të dhënat e monitorimit të BIRN, më keq qëndron Gjykata Komunale në Vushtrri 99% të gjykimeve të mbajtura dhe të monitoruara i ka mbajtur në zyret e gjykatësve. Nga 120

gjykimet e mbajtura dhe monitoruara, vetëm 1 seancë është mbajtur në sallën e gjykimeve. E vetmja sallë e gjykimeve, shërben për nevojat e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, e cila është edhe arsyeja e mbajtjes së gjykimeve në zyrat e gjykatësve.

Dukuria e mbajtjes së gjykimeve nëpër zyret, edhe pse sallat e pakta mbesin të lira dhe të pashfrytëzuara, është e pranishme edhe në gjykatat komunale në Gjakovë, Pejë, Lipjan, Prizren dhe Therandë, që vazhdon të përsëritet si dukuri e njëjtë nga viti i kaluar.

Sikurse në vitin e kaluar, Gjykata Komunale në Ferizaj qëndron më mirë me shfrytëzimin e sallave të gjyqësorëve. Nga 265 seancat e mbajtura dhe të monitoruara në këtë gjykatë, 249 apo 94% janë mbajtur në sallën e gjyqësorëve, kundrejt 16 seancave apo 6% të mbajtura në zyrë të gjykatësve.

Gjithashtu, Gjykatat Komunale në Skenderaj, Drenas dhe Viti, në të shumtën e rasteve mbajnë gjykimet në sallë, duke mundësuar kështu plotësimin e parimit të publicitetit në procedurat gjyqësore.

Përveç hapësirës së ngushtë dhe kushteve të vështira për mbarëvajtjen e gjykimit, në rastet kur seanca mbahet në zyrë të gjykatësve, shumë shpesh procesi gjyqësor pengohet nga palët e treta të cilat vazhdimisht hapin dhe mbyllin derën në kërkim të informatave.

BIRN më 25.06.2012 e ka organizuar një tryezë me përfaqësues të gjyqësorit, prokurorisë dhe Policisë së Kosovës. Në tryezën për diskutimin e të gjeturave gjykatësive dhe prokurorët kanë shprehur qëndrimet e tyre për gjykimet e mbajtura në zyrë, dhe për kushtet në salla dhe gjykata.

Derisa disa kryetarë të gjykatave si: ai i Gjykatës Komunale në Lipjan, në Therandë deklarojnë për mungesë të sallave dhe të kushteve teknike (monitorët, klimatizimi, kompjutorët, etj.) në sallat ekzistuese, kishte prokurorë në anën tjetër që ankoheshin në strukturën organizative të sallave ekzistuese, e që ka të bëjë me një renditje jo adekuate të uljes së palëve në gjykim.

Prokurori i Prokurorisë Komunale në Gjakovë Ali Selimaj deklaroi se sallat ekzistuese kanë mungesë kompjuterësh, mungesë klimatizimi dhe ngrohjeje për dimër, ndërsa në sallat e gjykatave model, janë radhitur gabimisht palët, me ç'rast publiku ndodhet menjëherë pas palëve gjyqësore.

Mbajtja e gjyqësorëve në zyrë të gjykatësve, është një dukuri që po e përcjellë gjyqësorin tash e sa vite. Në bazë të kësaj, publikut i pamundësohet pjesëmarrja në gjyqësor, edhe pse një pjesëmarrje e tillë u garantohet edhe me konventa ndërkombëtare dhe legjislacionin e Kosovës.

Statistikat tregojnë se shifra e njëjtë përsëritet tash e sa vjet, duke na lënë të vijnë në përfundim se kryetarët e gjykatave janë pajtuar me këtë shkelje dhe me këtë situatë, dhe se nuk janë të prirur të ndërmarrin asgjë për ta ndryshuar këtë gjendje.

3. Transparenca (mungesa e zëdhënësve)

Institucionet gjyqësore, ashtu si shumica e institucioneve të tjera, vazhdojnë të mos jenë transparente. Përkundër faktit që këtë vit ka pasur rritje të numrit të gjykatësve dhe të prokurorëve, e njëjta gjë nuk ka ndodhur edhe me stafin administrativ i cili do të mund të luante rol në rritjen e transparencës.

Të gjitha gjykatat e Kosovës kanë vetëm dy zyrtarë për informimin të cilët e luajnë rolin edhe të zëdhënësve, ndërsa të gjitha nivelet e prokurorisë kanë vetëm një të tillë, gjë që ndikon që qytetarët e Kosovës vazhdojnë të përballen më mungesë informacioni për qasje në drejtësi.

4. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë

BIRN gjatë aktivitetit të sajë, qofte në monitorim apo përmes emisioneve “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtësia në Kosovë”, ka hasur në gjykatës dhe prokuror të vullnetshem për tu deklaruar, e gjithashtu në të tillë që kanë refuzuar të deklarohen, edhe pse këtë kanë mundur ta bëjnë mrenda funksionit të tyre si gjykatës dhe prokuror, pa dëmtuar procesin hetimor apo gjyqësor për rastet e ndryshme.

Implementimi i projektit Gjykata Model ka rezultuar me faktin se në çdo gjykatë ekziston një kënd informativ në të cilin qytetarët dhe palët e interesuara mund t'i marrin informatat elementare për orarin e gjykimeve dhe atë se kujt dhe në cilën zyre mund të marrin informata më të detajuara. Sidoqoftë, ky “kënd informativ” nuk e ngritë në mënyrë përmbajtësore transparencën e gjykatave, ngase zakonisht lëndët dhe materialet tjera të rasteve gjyqësore gjenden të vendosura nëpër zyret e gjykatësve dhe janë gjykatësit ata të cilët duhet t'u përgjigjen kërkesave të qytetarëve, kurdo që janë në gjendje dhe pozitë për ta bërë një gjë të tillë dhe kur nuk janë të zënë me gjykime dhe obligime tjera.

Të gjitha nivelet e gjykatave, duke filluar nga ai më i larti, niveli suprem, për të vazhduar më ato të qarkut, komunale dhe së fundmi me atë më të ulët, gjykatat për kundërvajtje, nuk kanë asnjë zyrtar të dedikuar i cili do të mund të ofronte informata për proceset gjyqësore.

Që nga viti 2007, zyra për informim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës mbetet adresa pothuajse e vetme për dhënien e informatave që kanë të bëjnë me tërë sistemin gjyqësor.

Edhe pse shumë gjykata tani funksionojnë në sistemin model, qëllim kryesor i të cilit është transparenca, fatkeqësisht qytetari i Kosovës, vazhdon të hasë në probleme sa i përket informimit për çështjet e nevojshme në

gjyqësi, edhe në qoftë se të tillat kanë të bëjnë me realizimin e ndonjë të drejtë të tij nga Gjykata.

Gazetarët janë ata të cilët ballafaqohen me vështirësi në sigurimin e informacioneve që kanë të bëjnë me rastet gjyqësore ose të dhëna të tjera.

Kreshnik Gashi, gazetar nga emisioni Drejtësia në Kosovë thotë se gjykatësit hezitojnë të japin intervista, në përjashtim të disa rasteve, e sidomos janë hezitues ndaj reportazheve televizive. Kjo shkakton telashe për gazetarët dhe rezulton me një shkallë më të ulët të informimit publik.

Ndërsa Muhamet Hajrullahu deklaroi se gatishmëria e gjyqësorit dhe prokurorëve për tu prononcuar për media është problem i vazhdueshëm në sigurimin e informatave që janë të rëndësishme për publikun.

Për këto shkaqe, shpesh gazetarët janë të detyruar që informatat t'i sigurojnë nga burimet e dyta apo treta. E gjithë kjo, mund të shpie në pasaktësi të informatës për shkak të problemit të sigurimit të saj nga vija zyrtare dhe nga organet përgjegjëse.

Infrastruktura ligjore në fuqi nuk lejon post të veçantë për pozitën e zëdhënësit për gjykata dhe prokurori, mirëpo i obligon kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët që të ofrojnë informata për palët e interesuara, duke e plotësuar kështu këtë nevojë të madhe për informim publik.

Praktika ka treguar që në vitin e fundit, një vendim i tillë nuk është treguar si funksional, ngase monitoruesit e BIRN kanë shënuar ankesa edhe nga ana e gazetarëve, shoqërisë civile dhe qytetarëve, por edhe nga ana e vet kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve.

Njëra palë ankohet për vështirësi të mëdha në marrje të informatave, ndërsa pala tjetër ankohet se nuk janë të trajnuar për dhënie të informatave si dhe për faktin se janë të stërngarkuar me obligime tjera, që ua vështirëson në masë të madhe një komunikim kualitativ me opinionin publik.

Si rrethanë lehtësuese në këtë aspekt është Këshilli Gjyqësor i Kosovës i cili çdo vit publikon raportin vjetor të punës përmes së cilit bëhet vlerësimi i punës së gjykatave. Këto raporte mund të gjenden në faqen zyrtare të KGJK-së.⁵ Sidoqoftë, paraqitet nevoja që këto të dhëna të jenë më të pasura dhe më të specifikuar.

Konkretisht, ky institucion nuk posedon statistika për llojet e veprave penale që gjykohen nga gjykatat tona dhe për dënimet e shqiptuara për lloje të caktuara të veprave penale për periudhat e caktuara. Kjo paraqet vështirësi sidomos për palët e interesuara që kanë nevojë për këto të dhëna si studentët, profesorët dhe hulumtuesit e interesuar në këtë fushë.

Në mungesë të këtyre të dhënave, është e pamundur që institutet hulumtuese të tregojnë trendet e bërjes dhe ndëshkimit të veprave penale apo zhvillimin e politikave ndëshkimore.

Në anën tjetër, Prokuroria e Kosovës, nivelet e së cilës po ashtu kanë vetëm një zëdhënës, ka filluar të lëvizë për të mirë sa i përket publikimit të punës së tyre, duke prezantuar

raportet e tyre çdo tre apo gjashtë muaj. Faqja e tyre e internetit është e rifreskuar dhe në të mund të gjenden jo vetëm raportet e punës por edhe planet për vitet në vijim siç është ai për vitin 2012. Sidoqoftë, ende mbetet shqetësues hezitimi i prokurorëve që të deklarohen për opinionin për çështjet brenda përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre.

Misioni i EULEX, funksioni kryesor i të cilit është sundimi i ligjit, po ashtu është i rezervuar sa i përket transparencës. Përveç hezitimit për tu deklaruar për çështjet që janë në trajtim, EULEX po ashtu nuk është transparent sa i përket të dhënave dhe raporteve të tyre të punës, përkundër faktit që janë transparent sa i përket lajmërimeve të seancave gjyqësore. Kjo mbyllje dhe jotransparencë rëndon edhe më tutje situatën edhe ashtu mjaft jotransparente në gjyqësorin e Kosovës.

Në anën tjetër, përfaqësues nga gjyqësori dhe prokuroritë, në tryezën e organizuar nga BIRN për diskutimin e të gjeturave nga gjyqësia, të mbajtur më 25.06.2012,⁶ kishin mendime të ndryshme rreth temës së transparencës.

Derisa Fillim Skoro, gjykatës në Gjykatën e Qarkut në Prizren deklaroi se gjykatësit duhet të jenë të kujdesshëm në atë që thonë dhe që ka përvoja jo të mira me interpretimet e ndryshme të avokatëve në media, kishte gjykatës që mendonin ndryshe nga ky i fundit.

5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Web. <<http://www.kgjk-ks.org/>>.

6. Prokurori i Shtetit. Web. <<http://www.psh-ks.net/>>.

Sipas kryetarit të Gjykatës Komunale të Ferizajt Bashkim Hyseni, gjyqësori ka problem me zëdhënësit, përkatësisht me mungesën e zëdhënësve dhe sistemi jap shumë pak informacione për publikun. Ai shtoi se Policia e Kosovës duhet të merret si një model i mirë se si duhet të japet informacioni dhe të informohet publiku. Të njëjtin mendim ndanë edhe kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, sipas të cilit, gjykatat ishte dashur ta kenë nga një zëdhënës.

Në anën tjetër, kishte propozime nga gjykatësit drejtuar gazetarëve që këta të fundit, të marrin pjesë më shumë në shqyrtimet publike dhe të raportojnë edhe për zhvillime dhe ngjarje pozitive nga gjykatat, ngase është krijuar një përshtypje në publik se nëpër gjykata nuk ka suksese dhe të arritura pozitive.

Kryetari i Gjykatës Komunale të Malishevës ka kritikë ndaj KGjK-së, përkatësisht në mungesën e informatave të nevojshme në faqën e internetit të KGjK-së. Lulëzim Paqarrizi kërkon nga KGjK që faqja zyrtare e internetit e KGjK-së, t'i ketë informacionet e nevojshme, me të cilat mund të shërbehen

edhe gjykatësit, e që në veçanti, ka të bëjë me mungesën e të dhënave dhe kontakteve për gjykatësit.⁷

Si përfundim, duhet theksuar obligimin të cilin edhe gjykatat edhe prokuroritë e Kosovës e kanë ndaj opinionit publik. Duke e respektuar natyrën e punës dhe duke mos e cenuar rrjedhën e hetimeve dhe gjytimeve sipas ligjeve në fuqi, opinionit publik me të drejtë pret nga gjykatat e prokuroritë një transparencë më të lartë.

Njëra nga mundësitë më reale të avansimit në këtë drejtim është trajnimi i gjykatësve dhe prokurorëve për marrëdhënie me publik, në mënyrë që të mundësohet një komunikim profesional mes gjykatësve dhe prokurorëve në njërën anë dhe publikut e medieve në anën tjetër, gjithmonë në korniza të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

7. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

TË GJETURAT PËRMBAJTËSORE

1. Ftesat gjyqësore

Në kuadër të monitorimit të sistemit gjyqësor BIRN ka trajtuar dhe identifikuar problemet që kanë gjykatat komunale dhe të qarkut me dërgimin e ftesave për palët.

Gjatë trajtimit të këtij problemi sqarohet rregullimi ligjor i komunikimit gjykatë-palë, e gjithashtu trajtohet fakti se cilat institucione janë ligjërish të përgjegjëse për dërgimin e këtyre ftesave, si dhe komunikimi në mes të këtyre institucioneve.

Dërgimi i ftesave është i rregulluar me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Ligjin e Procedurës Kontestimore (LPK), ku përcaktohet në mënyrë të qartë se cilit person duhet t'i dorëzohet ftesa dhe si duhet të veprohet në qoftë se personi i caktuar nuk është prezent.⁸

Gjykatat dhe Prokuroritë janë të obliguara që ftesat me adresa të sakta dhe informata komplete t'i dorëzojnë me kohë.

Policia e Kosovës është e obliguar që të ekzekutojë urdhërat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik dhe/ose gjyqtari kompetent.⁹

Kuvendi Komunal, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ka për obligim emërimin dhe riemërimin e saktë të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike.¹⁰

Posta e Kosovës ka për obligim që ftesat e gjykatës dhe prokurorisë t'i dërgojë në adresa të sakta.¹¹

Në këtë raport janë identifikuar problemet të cilat ndikojnë në mos dërgimin e ftesave të gjykatës dhe prokurorisë në mënyrë të rregullt, e të cilat janë:

- Mungesa e koordinimit në mes të gjykatave, prokurorisë, Kuvendit Komunal, Postës dhe Policisë;
- Dështimi i sigurimit të shënimeve të sakta (emrit, adresës, numrit personal, etj.)
- Dështimi i mbikëqyrjes së procesit të dorëzimit të ftesave përmes informatës kthyes nga Posta ose nga shërbimi i korrierëve të gjykatave;
- Dështimi i Kuvendeve Komunale për ta përfunduar dhe unifikuar procesin e emërimit të rrugëve dhe vendbanimeve;

Ky raport është bazuar në monitorimin e vazhdueshëm në të gjitha gjykatat e nivelit të qarkut dhe atij komunal të Kosovës.¹² Gjithashtu janë bërë 103 intervista me persona adekuat nga gjykatat, komunat, Posta dhe Telekomit të Kosovës, Policia si dhe raste konkrete të palëve. Në bazë të këtij hulumtimi vërehet se komunikimi në mes institucioneve përgjegjëse që kanë për detyrë të rregullimin e dërgimit të ftesave, është minimal.

8. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Nenet 124- 134; Ligji i Procedurës Kontestimore, Nenet 103 – 116, 121-123.

9. Ligji i Policisë së Kosovës, Neni 6, Pika 1.

10. Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 40, Pika 9.

11. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 124, Pika 1; Ligji i Procedurës Kontestimore, Neni 103, Pika 1.

12. Gjykatat e qarkut të Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Mitrovicës; Në gjykatat komunale të Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Ferizajit, Gjilanit, Deçanit, Vushtrrisë, Podujevës, Lipjanit, Shtërpçës, Rahovecit, Malishevës, Therrandës, Drenasit, Kamenicës, Skenderajit, Vitisë, Kaçanikut, dhe Istogut.

Derisa gjykatësit ankohen në flëtëdorëzuesit, të njëjtit ankohen për kushtet e vështira që kanë në punë. Gjithashtu flëtëdorëzuesit ankohen edhe për plotësimin jo të rregullt të ftesave nga ana e gjykatës, për çka ankohen edhe flëtëdorëzuesit e PTK-së.

Po ashtu, zyrtarët policorë ankohen për punën e gjykatës më rastin e lëshimit të urdhrit nga gjykata për personat që duhet sjellur në gjykatë, për shkak të mungesës së informatave në lidhje me adresën e palëve. Ndërsa, gjykata ankohet në policinë se të njëjtit e shfrytëzojnë problemin e adresave të pasakta si pretekst për mos sjelljen e personave të caktuar në gjykatë.¹³

Në anën tjetër, PTK dhe gjykatat në shumicën e komunave ankohen se asnjëherë zyrtarisht nuk kanë pranuar listën zyrtare me emra dhe numra të rrugëve, që do të ndihmonte në identifikimin e adresave të sakta.¹⁴

Mirëpo nga ajo që është identifikuar, nuk vërehet nëse gjykatat dhe prokuroritë kanë menduar ta përdorin regjistrin civil, i cili do të ndihmonte këtyre në identifikimin e personave të nevojshëm në proceset gjyqësore. Nje shtet normal do të duhej ta kishte sistemin e identifikimit të qytetarëve të vet përmes emrit, mbiemrit, numrit personal, adreses, etj. Edhe nëse një qytetar e ndërron adresën, shteti do të duhej të ishte në gjendje që brenda 24 orëve, ta gjejë personin e kërkuar përmes metodave tjera të regjistrimit civil, ngase moslaajmerimi i vendbanimit konsiderohet si shkelje.

I tërë ky problem, jo rrallë kalon edhe në banalitet kur përfaqësuesit e gjykatës dhe ata të komunës ia hedhin fajin njëra tjetrës. Ka përfaqësues të këtyre dy institucioneve të cilët konsiderojnë se komuna është e obliguar që t'i dërgojë automatikisht informatat rreth emërtimeve të rrugëve, përdërisa pala tjetër e konsideron se këtë do ta bëjë vetëm nëse "gjykata shkon në komunë" për t'i kërkuar këto informata zyrtarisht.

Një qasje e tillë e bazuar në kryeneqësi, joprofesionalizëm dhe mendjemadhësi burokratike rezulton drejtpërsëdrejti që edhe më tej ta zvarrisë përmirësimin e gjendjes lidhur me dërgimin me kohë të ftesave të gjykatave dhe prokurorive.

Nga intervistimi i zyrtarëve kompetent të këtyre Institucioneve,¹⁵ vërehet se bashkëpunimi mes këyre institucionëve nuk është as afër nivelit të duhur. Bashkëpunim relativisht të mirë kanë Gjykatat me Stacionet e Policisë, ndërsa nuk mund të thuhet se ekziston bashkëpunim i mjaftueshëm në mes gjykatave me Postën dhe komunat. Ka raste që Posta dhe Komuna nuk janë të informuara fare me problemin që gjykatat kanë me dërgimin e ftesave, për shkak të neglizhencës së punës nga postierët e Postës dhe adresave të pasakta.

Në bazë të drejtoreshës së PTK-së në Pejë Besa Gaxherri, posta nuk është informuar lidhur me problemin që gjykata ka me dërgimin e ftesave. "Nëse gjykata ka ndonjë problem, mund ta padisë postën"- deklaroi drejtoresha Gaxherri.

13. Më shumë mund të lexoni në raportin e BIRN-it për problemet me ftesat gjyqësore.

14. Po aty.

15. Të gjitha gjykatat e nivelit të qarkut dhe atyre komunale, degët e PTK-së, rajonet e policisë, në komunat përkatëse si dhe komunat.

PTK në bazë të ligjit¹⁶ është e obliguar që të kryejë shërbimet e gjykatës, përfshirë këtu edhe dërgimin e ftesave. KGjK-ja për shërbimet që PTK kryen, vetëm për nëntë muaj gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 432,102.57 euro.¹⁷

Muaji	Viti	Shuma
Janar	2011	43,290.07€
Shkurt	2011	56,532.30€
Mars	2011	46,364.13€
Prill	2011	48,579.50€
Maj	2011	49,404.46€
Qershor	2011	51,370.80€
Korrik	2011	37,924.55€
Gusht	2011	40,573.05€
Shtator	2011	54,963.71€
	TOTALI	432,102.57€

Mirëpo, përkundër të gjitha këtyre shpenzimeve, problemi me dërgimin e ftesave nga ana e postës është ndër problemet më të theksuara në shumicën e komunave.¹⁸ Për më shumë, KGjK nuk ka ndonjë mekanizëm më anë të të cilit, do të kontrollonte shërbimet e PTK-së që kanë të bëjnë me gjykatat.

Nuredin Abazi, kryetar i Gjykatës Komunale në Therandë, problemin me ftesa më shumë e identifikon me fletëdorëzuesit të cilët nuk dorëzojnë ftesat tek personat e kërkuar nga gjykata, e gjithashtu nuk konstatojnë si duhet në fletëkthesë. Për shkak të kësaj, vie deri të shtyrja e seancave gjyqësore.

raste kur policia dështon për ta sjellur në gjykatë personin e kërkuar nga gjykata. Edhe pse gjykata ka lëshuar urdhër për sjellje të detyrueshme në gjykatë ndaj personit të caktuar të nevojshëm për procesin gjyqësor, policia ka dështuar ta sjellë atë në datën dhe orën e kërkuar, e cila më pas ka ndikuar në shtyrjen e lëndëve, shton Nuredin Abazi.

Në anën tjetër Baki Kelani, zëdhënës në Policinë e Kosovës i cili pajtohet me të gjeturat e raportit, përkatësisht me problemet me ftesat, deklaron se kjo çështje është e rregulluar me ligj.

Po ashtu sipas gjykatësit Abazi, ka shumë

16. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Nenet 124 - 134; Ligji i Procedurës Kontestimore, Nenet 103 - 116, 121 -
17. Shpenzimet postare të paguara nga KGjK për vitin 2011: janar: EUR 46,390.07; shkurt: EUR 56,532.30; mars: EUR 46,364.13; prill: EUR 48,579.50; maj: EUR 49,404.46; qershor: EUR 51,370.80; korrik: EUR 37,924.55; gusht: EUR 40,573.05; shtator: EUR 54,963.71.
18. Nga 18 gjykata të monitoruara nga BIRN prej tyre Gjykata Komunale e Prishtinës, Pejës, Ferizajit, Rahovecit, Skenderajit, Malishevës, Podujevës, Drenasit, Vitisë, Shtërpçës, Therandës dhe Lipjanit janë të pakënaqura me punën që bënë PTK me dërgimin e ftesave. Gjykatat të cilat nuk kanë problem me PTK janë Gjykata e Prizrenit, Kamenicës, Vushtrrisë dhe Deçanit. Ndërsa për komunat ku PTK nuk ka pranuar të jep informata janë Gjilani dhe Gjakova.

Sipas tij, ka shumë raste kur policia ka hasur në persona me të njëjtin emër dhe mbiemër, e gjithashtu tregon për problemet me ndërrimin e vendbanimeve. Ai shton se institucionet kryesore të ndërlidhura më këtë, duhet të ulen dhe ta zgjidhin problemin me ftesat gjyqësore, jo të presin që BIRN ta zgjidhë këtë problematikë.¹⁹

Lëndët e vjetra vazhdojnë të jenë problem për të gjitha gjykatat. Arsyeja kryesore në dërgimin e ftesave për këto lëndë është fakti që palët kanë ndryshuar vendbanimin por nuk e kanë njoftuar gjykatën, ashtu siç parashihet me ligj. Palët në masë të madhe nuk janë të vetëdijësuar se e kanë për obligim një gjë të tillë. Si pasojë e kësaj, proceset gjyqësore zvarriten dhe palët nuk arrijnë të njoftohen me kohë.

Në anën tjetër, si i vetmi arsyetim për adresa të pakompletuara nga ana e komunave ipet mos miratimi i Ligjit për legalizim nga ana e Kuvendit të Kosovës. Mungesa e këtij ligji po ju pamundëson komunave miratimin e rregulloreve për legalizim, trajtim dhe emërtim të objekteve dhe lagjeve.

2. Funksionaliteti i Gjykatave Model

Shumica e objekteve të gjykatave në Kosovë janë të vjetra dhe të ndërtuara në kohën e ish Jugosllavisë ose edhe më herët. Shumë nga

gjykatat si ato në Gjiilan, Pejë, Prizren, Istog, Klinë, Gjakovë, Prishtinë, Ferizaj, Vushtrri, Deçan punojnë në objekte të përbashkëta me prokurori dhe me gjykata më të ulëta. Jo të gjitha gjykatat i plotësojnë kushtet teknike për të qenë gjykata dhe në vijim janë listuar problemet e identifikuar në ndërtesat e gjykatave:

- mungesa e sallave të gjykimit,
- mungesa e zyrave për gjykatës dhe personel tjetër të gjykatës,
- mungesa e dhomave të veçanta për dëshmitarë të mbrojtur,
- mungesa e dhomave për këshillim dhe votim të trupit gjykues,
- mungesa e hapësirave për publik,
- mungesa e hapësirave për qëndrimin e të burgosurve,
- mungesa e hapësirave për të ndaluarit nga policia të cilët pritet të dalin para gjykatës për paraprak,
- mungesa e hapësirave për parkim të automjeteve,
- mungesa e qasjes për personave me aftësi të kufizuara në katet më të larta të gjykatës ngase me përjashtim të Prizrenit të gjitha sallat janë në katin e dytë,
- mungesa e hyrjeve dhe daljeve emergjente,
- mungesa e hyrjeve të veçanta për të pandehur apo të burgosur,
- mungesa e hyrjeve për dëshmitarë (sidomos në rastet kur të njëjtit janë të mbrojtur),

19. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

- mungesa e hapësirës për avokatë dhe prokurorë ku të njëjtit mund t'i linin gjësendet që nuk ju nevojiten gjatë një gjykimi,
- mungesa e hapësirës për t'i arkivuar lëndët,
- mungesa e hapësirës në zyrat për menaxhimin e lëndëve,
- mungesa e monitorëve për avokatët dhe prokurorët gjatë përpilimit të procesverbaleve në gjykim,
- mungesa e hapësirave në zyrat e përmbarimit.

Që nga paslufta gati të gjitha objektet e gjykatave janë rinovuar nga brenda, por në të gjitha rastet duke e ruajtur strukturën e mëparshme të sallave dhe të zyrave për gjykatës dhe personel tjetër të gjykatës.

Por USAID në muajin korrik²⁰ të vitit 2007 ka filluar me realizimin e Programit për Mbështetjen e Drejtësisë²¹ i cili ka kushtuar 19.5 milionë dollarë. Në kuadër të këtij programi është paraparë krijimi i Gjykatave Model, i cili fillon së realizuari në dhjetor të vitit 2007 në 6 gjykata të Qarkut dhe Komunale, ndërsa në prill të vitit 2009 ky program shton edhe 4 gjykata të tjera komunale. Gjykata e parë Model që inaugurohet është Gjykata Komunale në Ferizaj në shtator të vitit 2009²² ndërsa në vazhdim inaugurohen edhe gjykatat e tjera Model.

Por edhe pse është paraparë funksionalizim më i madh i gjykatës me sistemin model, prapëse prapë ka probleme të vazhdueshme të cilat BIRN gjatë monitorimit i ka identifikuar.

Gjykatat model, vazhdojnë të kenë mungesë të hapësirës, me që vetëm është ri dizajnuar hapësira ekzistuese, e këto mungesa janë:

- mungesë të sallave të gjykimit,
- mungesë të zyrave për gjykatës dhe personel tjetër të gjykatës,
- mungesë të dhomave për dëshmitar të mbrojtur,
- mungesë të dhomave për paraburgim,²³
- mungesë e hapësirave për avokat e prokurorë etj.

Gjykatat model kanë paraparë që ZQML-të (Zyra Qendrore për menaxhimin e lëndëve) të kenë kompetenca për menaxhimin e lëndëve duke i ju hequr lëndët nga zyrat e gjykatësve, por në realitet kjo nuk ndodh pasi në shumicën e gjykatave model²⁴ lëndët vazhdojnë të jenë në zyrat e gjykatësve, ndërsa ZQML-të janë ngarkuar me lëndë të kryera dhe lëndët e reja që vijnë në gjykatë.

20. Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar; USAID. <<http://www.drejtesia-ks.org>>

21. "Gjykatat Model." USAID. Web. <<http://www.drejtesia-ks.org/?cid=1,23>>.

22. "Rritja e Efikasitetit Nëpër Gjykata." Emisioni Jeta në Kosovë. BIRN, 24 Shtator 2009. Web. <<http://jetanekosove.com/sq/Kulmi-i-javes/Rritja-e-efikasitetit-neper-gjykata-467>>.

23. Gjykata e Qarkut dhe Komunale në Pejë.

24. Gjykata Komunale Ferizaj, Gjykata e Qarkut dhe Komunale në Pejë, Gjykata Komunale Gjakovë, Gjykata Komunale Prishtinë etj.

Edhe përkundër faktit se janë mbajtur shumë trajnime për personelin e gjykatës se si të punohet me sistemin e ri të menaxhimit të lëndëve dhe si të organizohet puna brenda gjykatës, nga monitorimi i BIRN del se në shumë pak raste është bërë aplikimi i praktikave të reja që ka sjellur sistemi model, kjo për faktin se lëndët vazhdojnë të mbesin në zyrat e gjykatësve dhe shumica e gjykatësve vazhdon të mbajë gjykime në zyrat e tyre.

Gjykatat model kanë arritur që së paku të krijojnë ndjenjën se janë më të hapura ndaj palëve, ngase tani në këto gjykata kemi nga një pult për informim, ku qytetarët mund të marrin informatat bazike lidhur me atë se kujt dhe në cilën zyre mund të drejtohen për përgjegje.

Në të shumtën e rasteve, palët nuk arrijnë të marrin informatën e kërkuar ngase gjyqtarët zakonisht janë të zënë me gjykime tjera dhe nuk janë në gjendje t'i japin informatat e kërkuara, edhe pse materialet e këtyre lëndëve zakonisht gjenden në zyrat e gjykatësve.

Implementimi i sistemeve të teknologjisë informative me një seriozitet dhe përkushtim më të lartë do ta evitonte këtë pengesë. Personeli i Gjykatave Model dhe vet gjykatësit në këto gjykata duhet që ti aplikojnë format e menaxhimit të lëndëve që ka paraparë sistemi model, pasi që kjo do të ndikonte në efikasitetin e gjykatave dhe në lehtësimin e punëve për gjykatësit si dhe vet personelit të gjykatës.

Në Kosovë deri në vitin 2009, zgjedhjet janë organizuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSCE). Të gjitha këto u patën vlerësuar si zgjedhje të organizuara mirë, dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Zgjedhjet komunale të vitit 2009, të parat të organizuara krejtësisht nga autoritetet vendore, e sidomos zgjedhjet nacionale të vitit 2010, dëshmuar një dallim të madh kualitativ na krahasim me zgjedhjet e oraganizuara paraprakisht.

Ato nuk u lavdëruan për organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre. Për më tepër, ato u karakterizuan me manipulime dhe parregullsi të shumta. Organi për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) pranoi 454 ankesa, shumica e të cilave kishin të bënin me vjedhje votash.

Prokuroritë Komunale të Republikës së Kosovës, gjerë më tani kanë akuzuar 1,343 persona që kanë të bëjnë me veprat penale të 'Keqpërdorimit të drejtës së votimit' nga neni 178 dhe veprës penale 'Mashtrimi në votime' nga neni 180 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe veprave penale të parapara nga ky kapitull. Këto lëndë me urdhër të Prokurorit të shtetit janë trajtuar si lëndë me prioritet. BIRN gjatë vitit 2011 ka monitoruar mbi 80 seanca në gjykatat komunale për

keqpërdorimet në zgjedhje. Prokuroria i kishte ndjekur për veprën penale 180 i Kodit Penal të Kosovës - Mashtrimi në votime dhe nga neni 178 Keqpërdorimi i të drejtës së votimit.

Kodi Penal i Kosovës për këto lloje të veprave penale ka paraparë dënime të ndryshme të cilat dallojnë prej mënyrës së kryerjes së veprës penale. Për ata të cilët cenojnë të drejtën e votimit ky kod parasheh dënim me gjobë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje nga 6 muaj deri në 3 vjet.

Ndërsa për personat të cilët klasifikohen se kanë bërë mashtrimi në votime, sanksioni për ta është paraparë dënim me burg efektiv prej 6 muaj deri në 5 vite.²⁵

Nga të gjitha dënimet e shqiptuara deri më tani 18 persona janë dënuar me burg (1 person është dënuar me 40 ditë burg, 10 persona janë dënuar me 3 muaj burg, 1 person është dënuar me 4 muaj burg, 4 persona janë dënuar me 6 muaj burg, dhe vetëm 2 persona janë dënuar me nga 1 vit burg).

Nga dënimet e shqiptuara, fitohet përshtypja se Gjykatat e Kosoves, janë treguar tepër tolerante dhe e mëshirshme me rastin e vendosjes për dënimet, nga të cilat denime shumica janë shqiptuar më gjobë.

gjoba	200€	250€	300€	350€	450€	500€	600€	700€	900€	1,350€
dënuar	2	1	1	2	49	1	1	1	23	8
me kusht	me kusht dhe gjobë				me burg					
40	7				18					

25. Kodi Penal i Kosovës, Nenet 176- 181.

Dënimet me gjobë janë të vlerave të ndryshme duke filluar nga 250 Euro e deri te dënimi më i lartë me gjobë që arrin në 1,350 Euro. Ndërsa dënimet me kusht janë dënime që parashohin që vendimi i gjykatës nuk do të ekzekutohet derisa personi i dënuar të mos përfshihet në ndonjë vepër tjetër kriminale deri në periudhën e caktuar. Në këto lëndë kemi vërejtur se periudha më e gjatë e shqiptuar është dy vite.

Në lidhje me shqiptimin e dënimeve për zgjedhjet, kishte mendime të ndryshme në mes të gjykatësve dhe prokurorëve, të cilat u diskutuan në tryezën e organizuar nga BIRN me 25.06.2012. Derisa prokurorët insistuan se dënimet e shqiptuara ishin të ulëta, në anën tjetër gjykatësit arsyetonin se dënimet e tyre janë të shqiptuara brenda suazave ligjore.

Sipas kryeprokurorit komunal në Prishtinë Haki Gecaj, politika ndëshkimore e gjykatave ka qenë e butë.

Për të gjitha lëndët e zhgjedhjeve që kanë qenë në kompetencë të prokurorisë komunale të Prishtinës, është bërë ankesë drejtë shkallës së dytë dhe është lajm i mirë që shkalla e dytë ka aprovuar ankesat e prokurorisë, pothuajse të gjitha, duke ndryshuar dhe rritur dënimet e shkallës së parë.

Të njëjtin mendim ndanë edhe kryeprokurori i Qarkut në Mitrovicë Shyqri Sylja, sipas të cilit politika ndëshkimore e gjykatës për rastet e zgjedhjeve ka qenë tepër e butë. Sipas këtij kryeprokurori, të gjitha dënimet për

zgjedhje, janë ankimuar në shkallën e dytë, dhe pothuajse 70 deri në 80% të dënimëve të shqiptuara nga gjykatat, janë ankimuar nga prokuroria.

Në anën tjetër, gjykatësit këtë e arsyetonin me kompetencën e gjykatave për të vlerësuar rastin, e të cilët kishin vendosur brenda suazave gjyqësore. Për më shumë, gjykatësi Ramiz Azizi, kryetar i Gjykatës Komunale në Gjilan, deklaroi se të gjitha vendimet që gjykata e tij i kishte shqiptuar, ishin dënime me burg. Sipas tij, kolgji i kësaj gjykate është takuar dhe ka arritur një qëndrim të parimor në lidhje me gjykimet e kësaj natyre.²⁶

Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Komunale në Ferizaj, deklaroi se politika ndëshkimore duhet të jetë humane dhe të shkojë drejt humanizimit. Burgu efektiv duhet të jetë vetëm për veprat penale të rënda.

Për shkak të manipulimeve dhe keqpërdorimeve të shumta, Sekretariati i KQZ-së ishte detyruar që të riorganizonte votimin në 185 vendvotime më 9 janar 2011 dhe në 126 vendvotime më 23 janar 2011. Për procesin e rivotimit u angazhuan 2,887 anëtarë shtesë të Këshilli I Vëndvotimëve (KVV). E ky riorganizim buxhetit të Kosovës i kushtoi rreth 674 mijë Euro.

E shumë nga ankesat u aprovuan nga PZAP-i dhe pastaj ankesat e palëve ju dërguan Prokurorit të Shtetit që të fillojë hetimet për vjedhje votash. Në bazë këtyre ankesave, janë ngritur aktakuza dhe propozim akuza në shumicën e komunave të Kosovës.

26. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

Si pasojë e këtyre ankesave PZAP-i dhe Gjykata Supreme e Kosovës, morrën vendime që të përsëriten votimet në tërësi në katër komuna të Kosovës.

Ndër të tjera, BIRN në raportin e saj për zgjedhjet, do të analizojë përpilimin e akteve akuzuese për këto lëndë në prokurori, procedimin e tyre në gjykata, mbarëvajtjen e seancave gjyqësore, çështjet procedurale dhe teknike në këto seanca si dhe do të fokusohet në llojet e dënimeve që ka dhënë gjykata për kryesit e këtyre veprave.

Dhe në fund BIRN do të jep rekomandime për Policinë e Kosovës, KQZ, PZAP si dhe për institucionet gjyqësore, lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, identifikimin e personave që kanë keqpërdorur të drejtën e votave të qytetarëve, si dhe dënimet që duhet të shqiptohen për kryesit e këtyre veprave.

5. Procesi emerimit të gjykatësve dhe prokurorëve

Procesi i emërimeve dhe riemërimeve, si një ndër proceset më të rëndësishme të reformimit të sistemit gjyqësor, ka shënuar progres të konsiderueshëm, por ende nuk ka përfunduar. Sipas raportit të Progresit të Komisionit Evropian, gjykatat e Kosovës parashihen të kenë 399 gjykatës për të gjitha gjykatat.²⁷

Sipas OSBE-së, në prill të vitit 2009, secili nga gjithsej 450 gjyqtarët e prokurorët e atëhershëm është dashur të riaplikojë për vendin tij/saj të punës.²⁸ Sipas të dhënave të publikuara nga OSBE më shumë se gjysma e

gjykatësve dhe prokurorëve nuk i kanë kaluar këto teste.²⁹

Detyrimi i gjykatësve dhe prokurorëve për t'iu nënshtruar testeve është vlerësuar në mënyrë të ndryshme, varësisht nga palët e intervistuar.

Kjartan Bjornson, ish-shef i operacioneve në zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë ka deklaruar "Shumë kandidatë kanë dështuar në këtë test të etikës dhe unë besoj se ne të gjithë pajtohemi se një gjyqtar do të duhej të jetë në gjendje të dëshmojë se i njeh parimet themelore të etikës. Për fat të keq, kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Ky proces nuk ishte i këndshëm – por ishte i domosdoshëm."³⁰

Një numër i gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë rënë në teste kanë pasur ankesa lidhur me organizimin e tij dhe me formulimin e pyetjeve. Sipas Abdurrahim Islamit, gjykatës në gjykatën komunale të Ferizajt "koha e ofruar për këtë test ishte tepër e shkurtër – vetëm 90 minuta".³¹

Përkundër nenit 150 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që parasheh që të gjithë gjykatësit dhe prokurorët duhet të nënshtrohen testit të etikës, për profesorin e së drejtës penale Ismet Salihu, ai test nuk ishte dashur të organizohej fare për gjykatësit e prokurorët të cilët ishin në shërbim. Sipas tij testi "ishte tepër nënçmues dhe jo i organizuar mirë dhe testit të etikës do të duhej t'i nënshtroheshin vetëm kandidatët e rinj".

27. Raporti i Progresit për Kosovën 2011, Faqe 11, Komisioni Evropian.

<http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf>

28. "Pavarësia e Gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe funksionale", Faqe 15, <<http://www.osce.org/sq/kosovo/87139>>.

29. Ibid.

30. BIRN intervistë me Kjartan Bjornson, ish-shef i operacioneve, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. 18 gusht 2011.

31. BIRN intervistë me Abdurrahim Islamin, gjykatës, Gjykata Komunale, Ferizaj, Kosovë. 22 tetor 2010.

Përfaqësues të Komisionit të Pavarur Gjyqësor Prokurorial (KPGjP), tani Koordinator në Zyrën për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor e Prokurorial, por poashtu edhe një numër i madh i gjykatësve të rinj, kishin vlerësuar se një test i etikës ka qenë i nevojshëm edhe për gjykatësit e

prokurorët në shërbim, për shkak të mundësisë për t'u siguruar që gjykatësit e prokurorët e tanishëm të mos krijojnë përshtypjen që do të jenë në ato pozita përgjithmonë.³²

Niveli i Gjykatës	Numri aktual i gjykatësve	Pozitat e miratuara për gjykatës-të shpërndara	Pozita të lira në Gjykata
Gjykata Supreme	15	17	2
Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme	10	12	2
Paneli ankues i AKP në Gjykatën Supreme	1	1	-
Gjykatat e Qarkut	56	61	5
Gjykatat Komunale	121	163	42
Gjykatat për Kundërvajtje (lartë dhe komunale)	59	102	43
Totali	267	361	94

Nga tabela mund të shihet se në nivelin suprem dhe atë të qarkut, ka përfunduar faza e plotësimit të vendeve për gjykatës, e që ende nuk është përfunduar në nivelin komunal dhe atë për kundërvajtje komunale.

Përkundër faktit që procesi i emërimit ka përfunduar në nivelin suprem dhe atë të qarkut, ende nuk janë plotësuar të gjitha pozitat e parapara dhe të miratuara për gjykatës. Në anën tjetër, gjykatat komunale vazhdojnë të kenë mungesë të gjykatësve, përkundër numrit të madh të lëndëve. Më keq qendrojnë gjykata komunale e Gjilanit me 5 gjykatës mangut, aq sa kanë mangut edhe gjykatat e Prishtinës dhe të Vushtrrisë.

Dhoma e Posaçme – Në bazë të ligjit për dhomën e posaçme pranë Gjykatës Supreme i cili ka hyrë në fuqi në janar 2012 është paraparë të shërbejnë 12 gjykatës vendorë dhe tetë ndërkombëtarë. Momentalisht në këtë dhomë janë 10 gjykatës, përkundër kërkesës të cilën e vendos standardi për nevojë të 12 gjykatësve.

Gjatë plotësimit të vendeve të zbrazëta, mosrespektimi i nivelit të gjykatave ka vazhduar të jetë shqetësues sikurse në fazat e mëhershme të emërimit dhe riemërimit të gjykatësve.

32. "Procesi i Emërimit dhe Riemërimit të Gjykatësve dhe Prokurëve." BIRN. Shtator 2011.

Praktika në Kosovë dhe në shtetet e zhvilluara është që gjykatësit të emërohen në gjykata të shkallës më të lartë pasi të kenë shërbyer në gjykata të shkallës më të ulët. Kjo praktikë nuk është përfillur kësaj here, pasi që në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në fund të vitit 2011 kanë shërbyer gjykatës pa asnjë ditë përvojë pune në pozitën e gjykatësit.

KGJK me rastin e shpalljes së konkursit për plotësimin e vendeve në Dhomën e Posaçme, kishte paraparë kriterin e përvojës së punës prej pesë, përkatësisht shtatë vjetësh në lëminë juridike, të paraparë edhe në rregulloret e sajë, duke e përjashtuar kështu kriterin e përvojës së punës si gjykatës dhe atë të respektimit të nivelit të gjykatave.

E gjithë kjo kishte mundësuar që Sabri Halili, Hilmi Bajrami, Shkëlzen Sylja, Sylejman Shumolli dhe Diellëza Hoxha të shërbejnë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme pavarësisht faktit që këta asnjëherë më parë nuk kishin punuar si gjykatës.

Përgjegjësia që u është dhënë këtyre pesonave është arsyetuar nga KGJK me përvojën e këtyre personave si zyrtarë ligjorë dhe juristë në kompani të ndryshme, bashkëpunëtorë profesionalë në gjykata të qarkut dhe komunale, si dhe gazetarë.

Jo vetëm se këta gjykatës kanë filluar punën pa pasur përvojë në gjykata tjera, por ka raste që të njëjtët gjykatës gjykojnë në shkallën e parë dhe të dytë të Dhomës së Posaçme, përkundër nevojës që në këto poste duhet caktuar persona me përvojë shumë më të madhe profesionale. Kryetari i Dhomës së

Posaçme është në dijeni për këtë dhe shprehet se kjo dukuri ndodh për shkak të numrit jo të mjaftueshëm të gjykatësve.

Dekretimi, si faza e fundit e emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve është vlerësuar të ketë qenë i shoqëruar më interferime në nominimin e tre gjykatësve të propozuar nga KPGJP. Në fakt në atë kohë, ushtruesi i detyres së presidentit të Kosovës nuk i ka emëruar tre kandidatët për gjykatës dhe prokuror, të dominuar nga KPGJP dhe KGJK.

Emisioni Jeta në Kosovë ka trajtuar këtë rast, i cili është konsideruar si ndërhyrje e patolerueshme e politikës në gjyqësor. Edhe pse askush nuk e ka pranuar përgjegjësinë për ndërhyrje në këtë listë, apostrofohet se aty ka ndërhyrë dikush nga Presidenca, e cila në moment të fundit ka hequr nga lista disa nga gjyqtarët dhe prokurorët e papreferuar.³³

E gjithë kjo situatë, padyshim që vërteton parregullsitë që kishin shoqëruar këtë proces me rastin e dekretimit të kandidatëve.

Emërimi i cili vazhdon tutje të plotësojë vendet e zbrazëta, ende reflekton në punën e gjykatës dhe prokurorisë për shkak të numrit jo të mjaftueshëm me gjykatës dhe prokurorë.

Prokuroria Komunale në Pejë, vazhdon të vuajë në punën e saj për shkak të numrit të vogël të prokurorëve. E njëjta prokurori ka funksionuar më vetëm katër prokurorë duke e mbuluar Pejën, Deçanin, Istogun dhe Klinën.³⁴ Për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, e njëjta prokurori ka

33. "Ndikimet Në Sistemin Gjyqësor." Emisioni Jeta Në Kosovë. 29 Tetor 2010. Web. <<http://jetanekosove.com/sq/Reportazhe-Hulumtuese/Ndikimet-ne-sistemin-gjyqesor-355>>.
34. "Problemët e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve" Emisioni Drejtësia në Kosovë. 31 janar 2011. Web. <<http://drejtesianekosove.com/sq/Reportazhe2/Problem-et-Prokuroreve-dhe-Gjyqtareve-775>>.

raste kur në mëngjes u cakton lëndët që prokurorët duhet të përfaqësojnë po atë ditë, pa kurrfarë përgatitje paraprake.³⁵

E gjithë kjo situatë që ka reflektuar më mospergatitje të prokurorit për lëndën, jo rrallëherë ka bërë që seanca të mos mbahet fare dhe të shtyhet për ndonjë datë tjetër, duke ndikuar kështu në grumbullimin dhe zvarritjen e lëndëve.

Nga tabela mund të shihet se në të gjitha nivelet e prokurorisë, do të duhej të kishte dyzet e një prokurorë më shumë, ku 19 prej

tyre janë të nevojshëm vetëm në nivelin komunal për veprat penale të dënueshme deri në 5 vjet.

Procesin e emërimit dhe rimemërimit OSBE-ja e quajti të ndikuar nga Presidenti i Kosovës. Sipas tyre "nuk është plotësisht e qartë se sa kandidatë të rekomanduar nga KPGJP-ja janë refuzuar nga vetë KGJK-ja, e sa u kthyen mbrapsht nga vetë Presidenti më vonë. Ajo që është e qartë është se në secilën fazë, kuadri i rekomanduar nga KPGJP-ja nuk ishte ai që përfundimisht emërohej."³⁶

Niveli i Prokurorisë	Numri aktual i Prokurorëve	Pozitat e miratuara për prokurorë	Pozita të lira në Prokurori
Prokuroria e shtetit	4	6	2
Speciale	10	10	1 suspenduar
Apelit	-	10	Në procedurë të plotësimit 10 prokurorë
Qarkut	36	46	10
Komunale	55	74	19
Totali	105	146	41

6. Çertifikata hetimore

Çertifikata hetimore është dokument me të cilin tregohet që ndaj një personi është apo nuk është duke u zhvilluar procedurë penale në territorin e Republikës së Kosovës. Në qoftë se ndaj një personi inicohet procedurë penale në njërin nga gjykatat në territorin e Kosovës, atëherë kjo do të reflektojë në çertifikatën hetimore e cila lëshohet nga gjykata përkatëse.

Mirëpo, praktika në shumicën prej gjykatave tona është se ato nuk kanë një koordinim të duhur, më anë të të cilit, do të lajmëronin

njëra tjetrën për zhvillimin e ndonjë procedure në gjykatat e tyre ndaj personave të caktuar dhe e cila do të ndihmonte në qartësimin nëse ndonjë person është gjykuar në ato organe.

Gjykatat ankohen për mungesë të shëmbimit kualitativ dhe me kohë në mes vete të informacioneve. Për këtë shkak, në mungesë të informacione për personat ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedurë penale, shumë persona e kanë marrë çertifikatën hetimore.

35. 1. BIRN intervistë me Vlora Banushaj dhe Ardian Hajdaraj, prokurorë, Prokuroria Publike Komunale në Pejë. Kosovë, Pejë, 14 mars 2012.

36. 2. "Pavarësia e Gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe funksionale", Faqe 15, <<http://www.osce.org/sq/kosovo/87139>>.

Një situatë e tillë është edhe rezultat i mangësive të cilat janë përmendur edhe me herët në këtë raport, e që kanë pasur të bëjnë me implementimin e sistemeve informative dhe komunikimin brenda përbrenda gjykatave.

Po ashtu një problem shumë i madh që po ndikon në këtë drejtim është edhe mungesa ligjore.

Nuk ekziston ndonjë ligj apo rregullore e cila do të obligonte gjykatat të njoftojnë njëra tjetrën për aktivitetet e veta hetimore dhe gjyqësore ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Gjykatat kanë improvizuar një shkëmbim të këtillë duke u bazuar në praktikën e krijuar gjyqësore gjatë punës së përditshme.

Mungesa e ligjit apo udhëzimit administrativ me të cilin KGJK e obligon lajmërimin më kohë për gjykatat kompetente për personat ndaj të cilëve zhvillohen procedura penale, është një e metë e cila ka efektin e tij në gjyqësorin e Kosovës.

Personat përgjegjës për lëshimin e certifikatave hetimore nuk obligohen me ligj apo me udhëzim administrativ për njoftimin e gjykatave tjera, se ndaj një personi është duke u zhvilluar procedurë penale. Gjykata të cilat nuk i njoftojnë me kohë gjykatat tjera se ndaj një personi është duke u zhvilluar procedurë penale, nuk vihen para përgjegjësisë penale dhe administrative.

Monitorimi njëvjeçar i BIRN-it ka identifikuar raste kur persona që janë nën hetime kanë

arritur të nxjerrin certifikatë me të cilën zyrtarisht është dëshmuar që nuk janë nën hetime, përkatësisht që ndaj tyre nuk është duke u zhvilluar procedurë penale. Arsyeja kryesore që ka shkaktuar një gjë të tillë konsiderohet koordinimi jo i mirë dhe mos njoftimi me kohë i gjykatave për personat ndaj të cilëve zhvillohet procedurë penale.

Një rast i tillë ka ndodhur në Gjykatën Komunale në Kamenicë, kur personi i akuzuar B. P. për vepër penale të dënueshme prej një deri në 10 vite është pajisur me certifikatë që nuk është nën hetime. Arsyeja thuhet të ketë qenë mungesa e koordinimi në mes të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit dhe Gjykatës Komunale të Kamenicës, pasi që gjykata komunale e Kamenicës nuk ka qenë në dijeni se ndaj personit të caktuar që ka kërkuar certifikatë, është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore në gjykatën e Qarkut në Gjilan.

Ngjashëm ka ndodhur ndaj personave nga Vushtrria. Është lëshuar certifikatë se nuk janë nën hetime edhe pse të njëjtit kanë qenë duke u gjykuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Sipas Mustafa Halil, i cili ushtron profesionin e referentit³⁷ në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë, vetëm Gjykata Komunale në Prishtinë është e rregullt në njoftimin për personat, ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedurë penale, ndërsa gjykatat tjera nuk ofrojnë informata me kohë. Ai tregoi se ndaj A.Xh. është lëshuar disa herë certifikata që nuk është nën hetime edhe pse ka qenë i ngarkuar me disa vepra penale, ndërsa më vonë kanë pasur problem me këtë certifikatë.

37. BIRN intervistë me Referentin Penal, Gjykata Komunale, Vushtrri. Kosovë, Vushtrri.

Pjesëmarrësit në tryezën e organizuar nga BIRN (gjykatës dhe prokurorë), bien në kundërshtim me njëri tjetrin kur deklarohen rreth kësaj çështjeje.

Gjykatësi nga Gjykata e Qarkut në Prizren Fillim Skoro këtë e quan si mangësi ligjore. Sipas tij, ligji ishte dashur ta parashihte lëshimin e certifikatave edhe ndaj atyre që janë nën hetime dhe duke u akuzuar, duke i shënuar detajet e hetimeve apo vepra për të cilën është duke u gjykuar personi i cili e kërkon certifikatën. Por, kishte gjykatës të cilët ndryshe nga i pari, edhe përkundër mungesës së një ligji të tillë specifik, aktualisht lëshojnë vërtetime të tilla.

Aziz Podvorica, kryetar në Gjykatën Komunale në Podujevë, deklaroi se gjykata nga ai vjen, lëshon vërtetim edhe për personat ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore.³⁸

E gjithë kjo, shpie në një standard të dyfishtë që aplikojnë gjykatat për certifikatat hetimore.

Për më shumë, gjykatat, përveç që ende nuk kanë mundur të organizohen që të lëshojnë certifikata që pasqyrojnë statusin e vërtetë të qytetarit ato edhe aplikojnë tarifa të ndryshme për një shërbim të këtillë.

Udhëzimi administrativ 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore e rregullon çmimin, mënyrën dhe në përgjithësi tërë çështjen e pagesës së taksave për shërbimet e gjykatave. Zbatimi i këtij udhëzimi vazhdon të jetë sfidë në praktikë pasi që deri më tani gjykatat ende nuk kanë unifikim të tyre.

Në gjykatat e Kosovës, ka laramani sa i përket taksës gjyqësore. Komunitet të cilat aplikojnë taksën prej tre eurosh janë gjykata komunale e Prizrenit, Therandës, Dragashit, Rahovecit, Malisheves, Pejës, Gjakovës, Podujevës, Deçanit, Ferizajt, Kamenicës, Istogut, Klinës, Vitisë dhe Kaçanikut, ndërsa ato që nuk e aplikojnë janë gjykata komunale e Prishtinës, Mitrovicës, Lipjanit, Drenasit, Skenderajt, Vushtrisë dhe Gjilanit.

BIRN gjatë hulumtimit ka gjetur se për pagesën dhe mospagesën për certifikata hetimore për punësim, gjykatat bazohen në të njëjtin udhëzim administrativ 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore dhe në të njëjtën pikë, disa gjykata e interpretojnë në favor të lirit nga pagesa, ndërsa disa tjera e interpretojnë në favor të marrjes së pagese prej 3 euro.

Konkretisht neni i kësaj rregullore shprehimisht thotë: "Në rastet e përcaktuara me këtë udhëzim, lirohet nga pagesa e taksës personi i cili parashtroi kërkesë që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, përveç kërkesave në të holla, si dhe personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai".

Mos koordinim i mirë i gjykatave, mungesa e një ligji apo udhëzimi administrativ që i obligon gjykatat për njoftimin me kohë për personat ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedurë penale dhe mos unifikim i taksave gjyqësore janë problem që po i përcjellin gjykatat e Kosovës në disa vitet e fundit.

38. 1. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.
39. 2. Udhëzimi administrativ Nr. 2008/02, Unifikimi i Taksave Gjyqësore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës. <http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Udhezimi-Administrativ-Nr-2008-02_259452.pdf>.
40. 3. Udhëzimi administrativ Nr. 2008/02, Unifikimi i Taksave Gjyqësore, Neni 7, Pika 1, Këshilli Gjyqësor i Kosovës. <http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Udhezimi-Administrativ-Nr-2008-02_259452.pdf>.

7. Parashkrimi

Institucioni juridik i parashkrimit që nënkupton kalimin e afateve ligjore brenda së cilës mund të ndërmerren veprime juridike për një vepër penale apo civile është shndërruar në dukuri të shpeshtë në gjykata dhe prokurori. Parashkrimi mund të jetë relativ dhe absolut, varësisht nga veprimet procedurale që ndërmerren në ndjekjen dhe gjykimet penale.

Parashkrimi relativ nënkupton që ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati i paraparë me ligj pa u ndërmarrë asnjë veprim, kurse ai absolut nënkupton që ndjekja penale dhe zhvillimi i procedurave nuk mund të bëhet në qoftë se ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit pa u ndërmarrë asnjë veprim. Afatin relativ e ndërprejnë çdo veprim që ndërmerret në procedurat e ndjekjes dhe ato të gjykimin.

Të shumta janë arsyet që e kanë shpjer gjyqësorin në këtë gjendje. Brenda këtij kaosi, e në mungesë të mekanizmave që do ta mbanin në kontroll të mjaftueshëm tërë sistemin, ka ardhur deri të lulëzimi i institucionit të parashkrimit. Ky fenomen kaq i përfolur në institucione gjyqësore, media dhe në opinion në përgjithësi është rezultat i neglizhencës së gjykatave dhe prokurorive për ta rregulluar atë.

Ligjvënësi e ka rregulluar me ligj institutin e parashkrimit. Kodi Penal i Kosovës në

kapitullin IX e parasheh këtë institut dhe afatet e parashkrimit të ndjekjes penale dhe ekzekutimit të sanksioneve penale në mënyrë taksative.⁴¹ Ndërsa, sa i përket legjislacionit në procedurë civile, kjo lëmi është e shkapërderdhur në shumë ligje që e rregullojnë atë.

Situata rëndohet edhe më shumë ngase Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk posedon të dhëna të sakta sa i përket numrit të lëndëve të parashkruara. Sipas Besnik Ramosajt, drejtor i departamentit të statistikës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk ka raport statistikor me numrin e saktë të lëndëve të parashkruara apo vjetërsuara.⁴²

Të dhëna statistikore për numrin e lëndëve të parashkruara ka ofruar organizata ÇOHU përmes një raporti për parashkrimin të ndjekjeve dhe ekzekutimit të lëndëve penale. Në bazë të këtij raporti, në periudhën 2001 – 2011 në 14 gjykata komunale janë parashkruar 4197 lëndë.⁴³

Gjithashtu, BIRN gjatë monitorimit të gjykatave ka arritur që të sigurojë të dhëna në lidhje me numrin e lëndëve të parashkruara për vitin 2011, e gjithashtu ka bërë krahasime me disa të dhëna të viteve të kaluara. Sipas të dhënave të mbledhura, ka lëndë për të cilat ekziston dyshim i bazuar se do të parashkruhen.⁴⁴

41. Kodi Penal i Kosovës, Nenet 90-95.

42. Intervistë me Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Kosovë, Prishtinë, janar 2012.

43. "Raport Monitorues: Parashkrimi i Ndjekjeve Penale dhe Ekzekutimeve Penale". ÇOHU. Janar 2012. <
http://www.cohu.org/repository/docs/Statutory_Limitation-Report-Shqip_837675.pdf>

44. Në gjykatën komunale në Mitrovicë, tre lëndë rrezikojnë të parashkruhen: P. nr. 58/08, vepra penale "Vjedhje e rëndë" nga neni 253 par. 1 të KPK-së, P. nr. 59/08, P. nr. 59/09, vepra penale "Kontrabandim i mallrave" nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, P. nr. 63/08, vepra penale "Lëndim i lehtë trupor" nga neni 153 par. 1, pika 1 të KPK-së.

Tabela: Numri i lëndëve të parashkruara në disa komuna

Gjykata Komunale	Lëndë të parashkruara	Parashkrim absolut	Parashkrim relativ
Pejë	456	54	402
Ferizaj	116	104	12
Gjilan	190	87	103
Rahovec	90	80	10
Kamenicë	17	4	13
Viti	249	53	196

Ishte menduar që me miratimin e Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara,⁴⁵ KGJK do të arrinte ta ndalë trendin e parashkrimeve. Inventarizimi apo identifikimi dhe kategorizimi i lëndëve të vjetra, i filluar në nëntor të vitit 2010 ka qenë i paraparë të përfundojë pas një viti, në nëntor 2011. Lëndët e inventarizuara, e kanë zbutur gjendjen në të cilën ndodheshin lëndët e vjetra, por numri i tyre vazhdon të rritet me shpejtësi.

Ndër arsyt kryesore që shkakton vjetërsimin apo parashkrimin e lëndëve konsiderohet neglizhenca e gjyqtarëve për të ndërmarë veprime procedurale të parapara me ligj të cilat do të parandalonin parashkrimin relativ. Veprime të tilla janë marrja në pyetje e dëshmitarit, nxjerrja e vendimit për paraburgim, hetimi në vendin e ngjarjes apo ekspertiza.⁴⁶ Përshtypjet janë se gjyqtarët qëllimisht i fshehin lëndët e vjetra, punojnë me lëndë të reja duke i injoruar ato të vjetrat me qëllim të favorizimit për personat e caktuar.

Vetëm lëndë të KEK-ut "Vjedhje e energjisë elektrike" e kategorizuar si vepër penale "Vjedhje" nga neni 252 i KPK-së, në gjykatën komunale të Istogut nga 106 lëndë që janë

parashkruar. 86 prej këtyre lëndëve janë me parashkrim relativ, që nënkupton neglizhencë të gjykatës dhe len hapësirë për dyshime.

Një arsye shtesë e cila sjell deri tek parashkrimet e lëndëve është mungesa e komunikimit në mes të gjykatave, prokurorive dhe policisë. Është konstatuar një numër i madh i kallzimeve penale të cilat sillen në prokurori nga policia pak kohë para se kallëzimit penal t'i përfundojnë afatet ligjore brenda së cilave mund të ndërmerren veprime juridike (para se të parashkruhen).

Deri më tani nuk ka pasur raste ku ndonjë gjyqtar apo prokuror ka dalur para përgjegjësisë penale apo disiplinore për papërgjegjësinë e tij apo neglizhencën gjatë zgjedhjes së lëndëve dhe lejimit të qëllimshëm të parashkrimit të lëndëve në aspektin relativ edhe pse për këtë pati premtuar kryesuesi i KGJK'së. Në emisionin Dretësia në Kosovë i transmetuar me datë 21.11.2010 me titull "Fshehja e statistikave të sakta për vjetërsimin e lëndëve" kryesuesi i KGJK-së pati deklaruar "se gjyqtarëve që u janë parashkruar lëndët do të sjellën para drejtësisë për të dhënë llogari se pse janë parashkruar lëndët si në aspektin relativ dhe absolut."⁴⁷

45. Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, Vendimi Nr. 22/2010, dt. 08.11.2010. Me këtë strategji synohet një dinamizim i punës së gjykatave në zgjedhjen e këtyre lëndëve. Për zbatimin e kësaj strategjie ngarkohen Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Njësia e auditimit Gjyqësor dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të gjitha gjykatat e rregullta dhe ato të Kundërvajtjes.

46. Ismet Salihu, "E drejta penale," Faqe 562, Botimi 2003, Prishtinë

47. "Fshehja e Statistikave të Sakta për Vjetërsimin e Lëndëve." Emisioni Jeta Në Kosovë. 21 Nëntor 2010. <<http://www.jetanekosove.com/sq/Reportazhe2/Fshehja-e-statistikave-te-sakta-per-vjetersimin-e-lendeve-772>>.

Gjithashtu, vet gjykatësit deklarojnë se situata me parashkrimin është shqetësuese. Sipas kryetarit të Gjykatës Komunale në Kaçanik, Ramadan Gudaçi, shumë lëndë janë parashkruar dhe shumë të tjera rrezikojnë parashkrimin, për çka duhet të identifikohen edhe gjykatësit për fajin e të cilëve janë parashkruar lëndët.⁴⁸

Procesi i emërimit dhe i riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk ka arritur që t'i plotësojë nevojat që kanë gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë. Ky fakt, jo rrallëherë

merret si arsyetim i gjykatësve dhe prokurorëve për dukurinë e parashkrimit të lëndëve. Në këtë drejtim, Ministria e Drejtësisë ka dështuar të ndajë buxhet shtesë për angazhimin e një numri më të madh të bashkëpunëtorëve profesional që do të mund të kryenin punë të çmueshme në këto institucione dhe rrjedhimisht sistemi gjyqësor do të përgatiste kandidatë potencial për gjyqtarë dhe prokurorë në të ardhmen. Mos përmirësimi i këtyre kushteve tejkalon retoriken e qeverisë për ta rregulluar sistemin gjyqësor në vend.

48. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

III. SHKELJET PROCEDURALE GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR

Shkeljet procedurale dhe të Kodit Penal

Sjelljet e gjykatësve, prokurorëve, avokatëve dhe palëve të përfshira gjatë gjykimeve janë të përcaktura detajisht me ligj, por jo gjithmonë këto sjellje janë në nivelin e kërkuar. Gjatë monitorimit të gjykatave BIRN ka vërejtur raste të shumta kur gjykatësit, kryetarët e kolegjeve dhe të trupit gjykues, avokatët dhe prokurorët gjatë gjykimeve kanë bërë shkelje të këtyre ligjeve, veçanërisht atij penal.

Përbërja jo e rregullt e trupit gjykues, mosleximi i të drejtave për të pandehurit, mosplotësimi i të drejtave për palën e dëmtuar, janë vetëm disa nga shkeljeve procedurale të evidentuara. Në vazhdim të këtij raporti, BIRN do të paraqesë vetëm disa nga rastet konkrete kur janë shënuar këto shkelje.

Përkundër faktit që Kodi i Procedurës Penale në Kosovë parasheh në mënyrë të qartë se cila duhet të jetë përbërja e gjykatës në rastet kur ato gjykojnë se janë vërejtur raste kur përbërja nuk është e plotë.⁴⁹ Neni 22 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ka paraparë shprehimisht përbërjen e trupit gjykues-anëtarët dhe për cilat raste gjykata vepron me gjykatës të vetëm, me trup apo kolegji gjyqësor, varësisht nga faza e procedurës dhe pesha e veprës penale.

Kanë ndodhur raste kur gjykatësi ka filluar dhe ka përfunduar seancën pa përbërjen e plotë të trupit gjykues ose në mungesë të ndonjërit nga anëtarët e trupit gjykues.⁵⁰ Mungesa e gjykatësve porotë ose e ndonjërit nga gjykatësit porotë në seancë është arsye e mjaftueshme për shtyrjen e seancës,⁵¹ nëse seanca mbahet pa praninë e tyre atëherë bëhet shkelje esenciale e procedurës penale.⁵²

Gjithashtu janë hasur raste kur trupi gjykues, edhe pse me përbërje të plotë, ka marrë aktgjykime nën minimumin e paraparë, e cila është aplikuar gjatë dënimeve të shqiptuara për personat që kanë kryer vepra penale gjatë zgjedhjeve, ashtu që dënimet zakonisht kanë qenë shumë të ulëta dhe në vend të dënimeve me burg ato u shndërruan në kusht ose gjobë.

Vetëm gjatë muajit qershor 2011, në Gjykatën Komunale në Drenas janë monitoruar 10 seanca gjyqësore për veprën penale "Mashttrim në votime" për të cilën vepër parashihet dënim me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Përkundër kësaj, kjo gjykatë nuk ka shqiptuar dënim më të lartë se tre muaj burg ose gjobë prej 1,350 euro. Ka pasur raste kur janë shqiptuar dënime edhe më të ulëta, si me dy muaj burg ose gjobë prej 900 euro dhe një muaj burg ose gjobë prej 450 euro.

49. Kodi i Procedurës Penale, Neni 22, Pika 1-5; Neni 24, Pika 1-5.

50. Në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në çështjen penale P.nr: 1036/07, ku të pandehurit akuzoheshin se kishin kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, e dënueshme me nenin 229 të KPK-së. Kryetarja e trupit gjykues, edhe pse pa përbërjen e plotë të trupit gjykues, në mungesë të njërit gjyqtar porotë, e filloi seancën dhe e mbajti atë deri në fund, ndërsa në procesverbal ishte konstatuar si prezent gjyqtari porotë që mungonte. Një rast i ngjashëm ishte edhe një seancë në Gjykatën Komunale në Viti, ku gjatë muajit tetor u mbajt shqyrtimi gjyqësor me numër P.nr:554/05. I pandehuri sipas aktakuzës së prokurorisë akuzohej për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 285 paragrafi 2 të KPK-së, vepër e dënueshme nga 6 muaj deri në 5 vite burgim. Rrjedhimisht edhe në këtë rast trupi gjykues duhej të ishte në përbërje prej një gjykatësi profesional dhe dy gjyqtarëve porotë ashtu si e ka paraparë neni 22 paragrafi 1 i KPPK-së. Por në këtë seancë trupi gjykues nuk ishte në përbërje të rregullt meqë në seancë nuk ishte prezent një gjyqtar porotë.

51. Kodi i Procedurës Penale, Neni 339.

52. Kodi i Procedurës Penale, Neni 403, Pika 1.

Shkelja procedurale e mosleximit të të drejtave të palëve vazhdon të jetë e pranishme në gjykatat e të gjitha niveleve. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në mënyrë të qartë ka paraparë që të pandehurit në çdo fazë të procedurës duhet të njoftohen me të drejtat që i kanë nga gjykatësi dhe kryetari i trupit gjykues.⁵³

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në çështjen penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje me numër P.nr:215/10, rast ky i cili kishte nisur nga e para, pasi që kishin kaluar më shumë se tre muaj nga seanca e fundit, kryetari i trupit gjykues Hajrije Shala nuk i njoftoi të pandehurit me të drejtat që i kanë gjatë gjykimit, gjë që është dashur të bënte.

Në një rast tjetër, me numër P.nr: 41/11 në Gjykatën Komunale në Istog me Zymber Geci si gjykatës i çështjes, gjatë kohës sa po mbahej seanca e shqyrtimit nuk i janë lexuar të drejtat të pandehurit i cili akuzohej për veprën penale vjedhje e rëndë.

Në Gjykatën Komunale në Prishtinë në çështjen penale me numër P.nr:1397/09 për veprat penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe i autorizimit dhe shpifje gjykatësi Faik Hoxha pos që nuk ka kërkuar të dhënat e të paditurit, pasi çështja ishte padi private, të njëjtit nuk ia ka lexuar as të drejtat.

Ndër të drejtat tjera të parashikuara me legjislacion penal është edhe e drejta e të pandehurit për të bërë pyetje gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve.⁵⁴ Gjatë monitorimit, BIRN ka gjetur raste kur të pandehurve nuk u është dhënë mundësia për të shtruar pyetje për dëshmitarët.

Por, edhe në rastet kur palët janë lejuar të parashtrojnë pyetje ka pasur raste kur është shkelur kodi i procedurës penale i cili e parasheh saktësisht se si duhet të jetë procedura e marrjes në pyetje të një dëshmitari dhe një të pandehuri.⁵⁵ Sidoqoftë, janë të monitoruara edhe raste kur nuk është respektuar rradha e marrjes në pyetje.

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për disa muaj me radhë nën udhëheqjen e EULEX-it janë mbajtur seancat në rastin e njohur TISA me numër P.nr:244/10. Gjatë këtyre seancave kryetari i kolegjit Gianfranco Gallo shpesh herë ka luajtur rolin e prokurorit duke shtruar pyetje për dëshmitarë dhe për të pandehur gjatë dhënies së dëshmisë, përkatësisht mbrojtjes së tyre. Për më shumë, në njërin nga seancat, kryetari i kolegjit ka shtruar pyetje për dyzet minuta, në kohën kur prokurori e kishte rradhën për të pyetur.

Në Gjykatën e Qarkut në Pejë në muajin maj 2011 është mbajtur seanca gjyqësore nën shenjen P.nr:96/10 për veprën penale të vrasjes, ku kryetari i trupit gjykues Shaban Shala nuk i ofroi mundësinë të dëmtuarit dhe të pandehurit për t'i shtruar pyetje dëshmitarit.

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në çështjen penale P.nr: 99/10 për veprën penale krim i organizuar dhe blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm e mbajtur në muajin maj, kryetari i kolegjit nga EULEX-i Gianfranco Gallo ka ndërhyrë derisa prokurori shtronte pyetje për t'i treguar prokurorit se si të shtrohen pyetjet dhe ka vazhduar me pyetje për më shumë se dyzet minuta.

53. Kodi i Procedurës Penale, Neni 356, Pika 2.

54. Kodi i Procedurës Penale, Neni 165, Pika 1.

55. Kodi i Procedurës Penale Neni 165; Neni 372.

Pos kësaj, legjislacioni penal ua lejon të gjitha palëve shtrimin e pyetjeve në mënyrë të drejtpërdrejt ose përmes kryetarit të trupit gjykues, por BIRN ka gjetur kur gjykatësit/kryetarët e trupave gjykues nuk ju ofrojnë mundësinë të pandehurve dhe të dëmtuarve që t'i shtrojnë pyetje dëshmitarëve.⁵⁶

Në Gjykatën e Qarkut në Pejë, gjatë muajve mars dhe prill 2011, nën udhëheqjen e EULEX-it është mbajtur shqyrtimi gjyqësor për veprën penale vrasje e rëndë me numër P.nr:336/10. Kryetari i kolegjit Guunar Oyhaugen, në asnjë nga gjashtë seancat e monitoruara nuk u ka dhënë mundësi të dëmtuarve që të parashtrojnë pyetje për dëshmitarë.

Shkelje të procedurave janë hasur edhe gjatë kohës sa të pandehurit kanë dhënë mbrojtjen e tyre.

Kodi i Procedurës Penale parasheh që të bashkakuzuarit të cilët ende nuk janë marrë në pyetje nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë pyetjes së të akuzuarit.⁵⁷ Pavarësisht kësaj, BIRN ka monitoruar raste kur në sallën e gjyimit kanë qëndruar të pandehurit e tjerë gjersa i bashkëpandehuri tjetër ka dhënë mbrojtjen e tij, e ka pasur raste kur e ka kundërshtuar dhe korrigjuar njëri tjetrin gjatë dëshmisë.

Në Gjykatën e Qarkut në Pejë nën numrin P.M.Q.nr:4/11 me kryetare të trupit gjykues Lumturije Muhaxheri gjatë muajit mars u mbajt seanca për veprën penale grabitje ku të pandehur ishin disa të mitur. Gjatë kohës sa i pandehuri i dytë jepte mbrojtjen e tij, i pandehuri i tretë qëndronte në sallë dhe

dëgjonte se çfarë po dëshmonte i bashkakuzuari.

Në Gjykatën Komunale në Pejë nën numrin P.nr:1034/08 gjatë muajit mars 2011 është mbajtur seanca gjyqësore për veprën penale të vjedhjes, ku akuzoheshin dy persona si bashkëkryes. Pas procedurës së provave gjykatësi Sami Sharraxhiu ka ftuar të pandehurën e parë që të japë mbrojtjen e saj, por pa e larguar nga sallat e pandehurës e dytë. Gjatë deklarimit të të pandehurës, i pandehuri që ishte në sallë ndërhynte dhe e kundërshtonte të bashkakuzuarën. Madje, në këtë seancë ndërhynte edhe vëllai i të pandehurit që ishte në publik duke kundërshtuar të pandehurën.

Gjykatësi nga Gjykata Komunale e Ferizajt, Agim Maliqi, deklaroi se është shqetësuese shkelja procedurale që ka të bëjë me përbërjen jo të plotë të trupit gjykues. Sipas tij, kjo nuk guxon të ndodhë. Sipas tij, në qoftë se vërtetë ka ndodhur që trupi gjykues të fillojë dhe vazhdojë gjykimin pa përbërjen e plotë, atëherë kryetari i trupit gjykues do të duhej të përgjigjej penalisht për këtë.⁵⁸

Përfundim

Gjykata, pra kryetari i trupit gjykues, është e obliguar që të kujdeset çdo herë për përbërjen e trupit gjykues që ai të jetë i plotë dhe në përbërjen që e ka paraparë KPPK-ja, përderisa mungesa e njërit anëtar të trupit gjykues është arsye e mjaftueshme që të shtyhet shqyrtimi.

Po ashtu gjykata duhet të kujdeset çdo herë për plotësimin dhe respektimin e të drejtave për të pandehurit, të dëmtuarit dhe dëshmitarët.

56. Kodi i Procedurës Penale Neni 165, Pika 3.

57. Kodi i Procedurës Penale Neni 371.

58. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

IV. Të gjeturat gjatë gjykimeve

1. Caktimi i pa-koordinuar i seancave gjyqësore mes gjykatësve e prokurorëve

Sipas legjislacionit civil dhe atij penal caktimi i seancave gjyqësore bëhet nga gjykata.⁵⁹ Në të shumtën e rasteve, gjykata mundohet që orarin e seancave ta koordinojë me palët tjera në procedurë siç është prokurori publik apo mbrojtësi i palëve.

Gjendja në terren tregon se palët e përfshira nuk po ia arrijnë të koordinohen gjatë caktimit të tyre. Kjo dukuri paraqitet në gjykatat e të gjitha niveleve në Kosovë, në veçanti në ato komunale të Malishevës, Rahovecit, Kamenices, Vushtrrisë, Istogut, Klinës dhe Deçanit, në të cilat në shumicën e rasteve prokurori shkon vetëm një herë në javë për të përfaqësuar aktin akuzues.

Në Gjykatën Komunale në Rahovec, me datën 22 dhjetor 2011 në ora 11.00, prokurori Sefer Morina, në të njëjtën kohë ishte paraparë të përfaqësonte aktakuza të dy gjykimeve, përkatësisht në lëndët Ka.nr: 258/2011 dhe P.nr: 261/09.

Në Gjykatën Komunale në Malishevë, të dyja lëndet P.nr 14/08 dhe P.nr: 373/08 ishin caktuar në të njëjtën kohë përfaqësueshin nga i njëjti prokuror Beqë Shala.

Në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë në rastin me numër P.nr.08/10 të mbajtur me 10 tetor 2011 për veprën penale rrezikim i trafikut publik, gjykimi është shtyer për shkak të mungesës së prokurorit Naim Beka i cili po përfaqësonte në një seancë tjetër për të mitur.

Në Gjykatën Komunale në Pejë është shkaktuar vonesa prej më shumë se një orë në seancën e mbajtur më 12 dhjetor 2011 për veprën penale rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës në të cilin rast gjykonte gjykatësja Hidajete Veseli. Vonesa u shkaktuar nga prokurorja publike Vlora Banushaj pasi që ajo në të njëjtën kohë ishte në një gjykim tjetër në këtë gjykatë.

Këto janë vetëm disa nga rastet e monitoruara të cilat vazhdojnë të ndodhin gjatë gjykimeve dhe të cilat si rezultat final kanë grumbullimin e lëndëve të pa gjykuara.

Në Gjykatën Komunale në Pejë, është vonuar mbajtja e seancës gjyqësore në rastet me numër P.nr. 279/08 dhe P. nr. 189/10, të mbajtur me 01 qershor 2011, përkatësisht me 12 dhjetor 2011.

Në rastin e parë, vonesa është shkaktuar për shkak të kryeprokurores Lirie Morina, ndërsa e dyta për shkak të vonesës të prokurores Vlora Banushaj. Derisa në rastin e parë kryeprokurorja nuk arrinte të përfaqësonte të gjitha rastet, në tjetrin prokurorja arsyetohet se është vonuar për shkak se ka qenë në përfaqësim të aktakuzës në një rast tjetër.

Përveç rasteve kur gjykatësit dhe prokurorët nuk ia dalin të organizohen gjatë caktimit të seancave, BIRN ka monitoruar shumë raste kur avokatët nuk koordinohen si duhet me gjykatën për përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve në gjykime, gjë që poashtu shkaktonte shtyrjen e seancave gjyqësore.

59. Ligji për Procedurën Kontestimore, Neni 123; neni 319, Pika 1.

Në gjykatën e qarkut në Prizren në lëndën Trafikimi me njerëz. KA.nr.109/11, të mbajtur me 04 tetor 2011, ku gjykatës ishte Vitol Jakingo, dhe prokuror Agron Matjani, si dhe prokurori Polak nga EULEX, Avokati Hajrip Krasniqi i dha vërejtje trupit gjykues për faktin se datat e gjykimeve janë caktuar pa u koordinuar fare me avokatët. E gjithë kjo bënë të pamundur prezantimin e të gjithë avokatëve në datat e lartëcekura. Për këtë pati reagime edhe nga mbrojtësit tjerë. Mirëpo kryetari trupit gjykues, tha se pas mbajtjes së seancës së parë të shqyrtimit kryesorë, do të vendoset edhe për seancat tjera në koordinim me palët në gjykim.

Po ashtu në Gjykatën e Qarkut në Prizren, në lëndën "Vrasje në tentativë" nga neni 146 lidhur me nenin 20, vepra penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 si dhe vepra penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPK-së.P.nr.187/07, mbajtur me mbajtur me 13 tetor 2011, me gjykatës Vaton Durguti dhe prokuror Mehdi Sefa, në mungesë të avokatit gjykimi filloi duke i kryer disa formalitete, mirëpo meqenëse mungonte avokati, seanca u ndërpre edhe për 1 orë tjetër, që do të thotë se seanca gjyqësore filloi me vonesë 1 orë e 25 minuta. Mirëpo arsyeja e avokatit ishte se nuk kishte marrë ftesë në mënyrë të rregullt, gjë të cilën e konfirmoi edhe kryetari i trupit gjykues.

Kordinimin jo të mirë në mes të gjykatësve dhe prokurorëve e pranojnë edhe vet prokurorët. Në tryezën për diskutimin e të gjeturave të BIRN-it në gjyqësi, të mbajtur me 25.06.2012, prokurori komunal nga Gjakova, Ali Selimaj, deklaroi se nuk ekziston një

koordinim i mirë në mes të gjykatësve dhe prokurorëve me rastin e caktimit të gjykimeve. Këtë e arsyeton më faktin se vetëm 2 apo 3 lëndë ka që iu kanë caktuar atij personalisht, ndërsa tjerat i ka trashëguar nga paraardhësi i tij.⁶⁰

Numri i vogël i prokurorëve edhe pas procesit të emërimit/riemërimit është arsyezim i përhershëm i prokurorisë për vonesat e prokurorëve dhe për mosarritjen e përfaqësimit të të gjitha lëndëve.

Në raportin e monitorimit të gjykatave, të publikuar nga BIRN për periudhën raportuese maj 2010 – prill 2011, BIRN ka trajtuar problemin e mungesës së koordinimit ndërmjet gjykatësve dhe prokurorëve. Kjo në veçanti bëhet me rastin e caktimit të seancave gjyqësore.

Përfundim

Një koordinim më i mirë në mes të gjykatësve dhe prokurorëve me rastin e caktimit të shqyrtimeve gjyqësore, natyrisht se nuk do të çonte në ndërprerjen dhe shtyerjen e gjykimeve.

Edhe për kundër angazhimit të madh të gjykatësve dhe prokurorëve, konsiderojmë që kryetarët e gjykatave dhe kryprokurorët kanë për obligim për të implementuar një disiplinë më të lartë dhe respektim të orarit të përcaktuar për seanca gjyqësore.

2. Vonesa e fillimit të gjykimeve

Gjykimet në gjykatat e Kosovës vazhdojnë të mos fillojnë me kohë. Në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar është shënuar një përmirësim i lehtë në këtë drejtim.


60. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

Gjatë periudhës për të cilën flet ky raport, prej 1,920 seancave gjyqësore 35.21% e tyre kanë filluar me vonesë, shifër kjo më e vogël se sa ajo e vitit të kaluar, kur BIRN kishte raportuar se 47% e rasteve të monitoruara kishin filluar me vonesë.⁶¹

Vonesa e trupit gjykues është ndër arsyet e shpeshta e fillimit më vonesë të seancave gjyqësore.

Kjo është e çuditshme pasi që koha e mbajtjes së gjykimit zakonisht është caktuar nga vet trupi gjykues. Në krahasim me vitin e kaluar, fillimi me vonesë i seancave gjyqësore për shkak të vonesës së trupit gjykues apo gjykatësit është më i lartë në vitin 2011, duke arritur shifrën prej 25.41% të rasteve të monitoruara. Në vitin 2010 kjo përqindje ishte 14.6% apo 314 seanca nga gjithsej 2,147. Rastet gjyqësore në vijim ilustrojnë vonesat e fillimit të gjykimeve.

Numri i seancave të monitoruara të cilat kanë filluar/nuk kanë filluar me kohë



Në gjykimin e mbajtur me 23 mars 2011 në Gjykatën e Qarkut në Prizren, për veprën penale "Pjesmarrja në grup nga neni 320 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së, dhe për v.p. Armëmbajtje pa leje nga neni 328 par.2 të KPK-së", KA.nr.24/11. Gjykatësi i çështjes Xhevdet Elshani, u vonua 40 minuta. Gjatë kësaj kohe, palët prisnin në sallë të gjykimit,

duke u ankuar për vonesën e gjykatësit, i cili ishte i angazhuar në një konfirmim tjetër. Madje avokatja e të pandehurit, shkoi në zyrë të gjykatësit dhe i dha vërejtje gojore në emër të kolegëve dhe e paralajmëroi se nëse do të ndodhë edhe njëherë kjo vërejtje do të shkojë në formë të shkruar.

61. "Raporti i Monitorimit të Gjykatave prill 2010 – shkurt 2011". BIRN. Prishtinë. Shtator 2011.

Gjithashtu, monitorimi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, ka identifikuar raste kur seancat kanë filluar më vonesë për shkak të vonesës së trupit gjykues/gjykatësit. Raste të njëjta nga gjykata e njëjtë, janë si në vijim: C.nr.248/10, mbajtur me 03.10.2011, Lënda “Vërtetim Pronësie”, P.nr. 268/07, mbajtur me 07.09.2011. Lënda “Vjedhje nga neni 252 par 1 të KPK-së”. C.nr.504/05, mbajtur me 03.10.2011, P.nr. 522/10, mbajtur me 07.12.2011, Lënda “Rrëzikim i trafikut publik nga neni 297 par 3 lidhur me par 1 të KPK-së”. P.nr. 130/10, mbajtur me 16.11.2011, Shpifje nga neni 188 par 1 i KPK-së. P.nr. 30/10, mbajtur me 06.12.2011. Lënda: Shpifje nga neni 188 par 1 i KPK-së.

Raste të tilla kishte edhe në Gjykatën Komunale në Skënderaj, me ç’rast lënda me nr P. nr. 09/11, mbajtur me 12.10.11 ishte paraparë të mbahej në orën 10:00, ndërsa filloi në orën 10:40 për shkak të vonesës së gjykatësit.

Gjykata e Qarkut Prishtinë, si gjykata më e madhe e Qarkut, ka raste jo të pakëta kur gjykimet nuk i ka filluar më kohë për shkak të vonesës së trupit gjykues/gjykatësit në lëndë të ndryshme.


Gjykimi i mbajtur me 06.09.2011 në këtë gjykatë, në lëndën “Krime lufte kundër

popullatës civile dhe Dhënia e ndihmës kryesit të veprës penale”; P.nr:411/10, i njohur si rasti Bllaca, Kolegji i gjykatësve: Horst Poetel kryetar, Tore Tomasson dhe Rafet Haxhaj, e filluan gjykimin me 35 minuta vonesë për shkak të vonesës së anëtarëve të kolegjit, njësisë së transportit të të burgosurve si dhe prokurorit special Mauricio Salustro.

Gjykata e Qarkut në Pejë, në gjykimin e mbajtur me 24.10.2011, Lënda: “Vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 147 par. 4 lidhur me nenin 20 të KPK-së. “Mbajtje në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve” nga neni 328 par. 2 të KPK-së dhe “Kanosje” nga neni 161 par. 2 të KPK-së. P.nr. 249/11.

Gjykimi kishte filluar më 40 minuta vonesë për shkak të vonesës së trupit gjykues në përbërje prej: Sali Berisha, Shaban Shala dhe tre gjyqtarë porotë. E njëjta ndodhë edhe në gjykimin e mbajtur me 17.10.2011 në lëndën “Vrasje në tentativë” nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe “Mbajtje në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve” nga neni 328 par. 2 të KPK-së. P.nr. 210/09, në gjykatën e njëjtë. Trupi gjykues në përbërje: Elmaze Syka kryetare, Muharrem Shala anëtar dhe tre gjyqtarë porotë, filluan më vonesë gjykimin për shkak të vonesës së tyre.

Arsyeja e mos fillimit me kohë të seancave



Sikurse në vitin e kaluar, po ashtu gjatë këtij viti gjykimet janë shtyrë jo vetëm për fajin e trupit gjykues.

Vonesat e prokurorëve, avokatëve, palëve dhe vonesat e përkthyesve kanë ndikuar po ashtu në zvarritjen dhe fillimin më vonësë të një numri jo të vogël të gjyimeve.

Nga 1,920 seanca të monitoruara, 117 gjykime apo 17.49% kanë filluar më vonësë për shkak të vonesës së prokurorëve. Në krahasim me vitin e kaluar, kur vetëm 8.6% e seancave kanë filluar me vonesë për shkak të vonesës së prokurorit publik, këto raste kanë shënuar rritje.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjykimin e mbajtur me 22 nëntor 2011, në lëndën "Krime lufte kundër popullatës civile dhe Dhënia e ndihmës kryesit të veprës penale" e kishte filluar më vonësë prej 1 orë e 20 minuta. Prokurori special Mauricio Salustro në gjykimin e njëjtë me numrin P.nr:411/10 (rasti Bllaca), nuk kishte ardhur në kohën kur ishte paraparë fillimi i gjyimit, përkatësisht

në ora 09:00.

Prokurori Salustro është vonuar 50 minuta ndërsa dëshmitarët janë vonuar edhe për 30 minuta të tjerë duke shtyer kështu fillimin e seancës për 1 orë e 20 minuta. Kolegji i gjykatësve ishte në përbërje prej: Horst Proetel kryetar, Tore Tomasson dhe Rafet Haxhaj.

Vonesa e prokurorëve ishte evidente edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Në Gjykimin e mbajtur me 13.04.2011. Lënda: Rrezikim i trafikut publik neni 297 par.1 të KPK. P.nr. 2099/07, seanca filloi me vonesë prej 30 minutash.

Arsyeja ishte vonesa e Prokurores Ferdane Sylejmani Kjo vonesë u shkaktua duke e pritur prokuroren e cila edhe pse kishte pranuar ftesën, nuk ishte e pranishme në seancë. Gjatë kohës së pritjes, gjykatësja ishte e detyruar që palët t'i ftojë brenda në zyren e saj, ku edhe mbahej seanca, për pritje për shkak të pluhurit të madh që ishte në korridor si pasojë e renovimit të gjykatës.

Rasti tjetër në Gjykatën Komunale në Prishtinë ishte ai të gjykatësja Shpresa Hyseni. Gjykimi i mbajtur me 23.11.2011, në lëndën P. nr. 1950/09; "Marrje rryshfeti" nga neni 343 par 1 të KPK-së, prokurori Faik Halilaj ishte shkaktar i fillimit me vonesë të gjykimit prej 45 minutash.

Edhe gjykatat tjera komunale si ajo në Vushtrri, Therandë, Drenas, etj., jo rrallëherë kishin filluar gjykimet me vonesë për shkak të prokurorit.

Në Gjykatën Komunale në Vushtrri, në gjykimin e mbajtur me 27.09.2011, në lëndën me numër P. nr. 49/09, prokurori Naim Beka kishte ardhur në gjykim në ora 13:50, edhe pse gjykimi ishte paraparë të fillonte në 13:30.

Gjykata e Komunale në Therandë, gjykimin e mbajtur me 21.03.2011, e kishte filluar me vonesë prej 40 minutash për shkak të vonesës së prokurorit Arben Ramadani. Në të njëjtën lëndë "Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 para 3 lidhur me para 1 të KPPK-së", Pnr – 292/05, gjykatësi i çështjes ishte Robert Tunaj; Filloi 40 min me vonesë për shkak të vonesës së Prokurorit.

Gjithashtu Gjykata Komunale në Drenas, nuk kishte filluar më kohë gjykimet. Në gjykimin e mbajtur me 10 mars 2011, në lëndën "Rrezikim i trafikut publik", nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-së; P. nr. 37/07; prokurori Ali Ajdini kishte ardhur në gjykim pas 1 ore kur ishte paraparë fillimi i gjykimit. Kryetar i trupit gjykues në këtë seancë ishte Shefqet Baleci.

Prokurorja Mirushe Llugiqi ishte shkaktar i fillimit me vonesë prej 40 minutash të gjykimit tjetër të mbajtur në këtë gjykatë me 29 mars 2011. Lënda ishte "Vjedhje", nga neni 252 par. 1 të KPK-së. P. nr. 354/09 me Shefqet Balecin si kryetar të trupit gjykues.

Në anën tjetër, përpos gjykatësve dhe prokurorëve si shkaktar të vonesave të mbajtjes së gjykimeve, edhe mbrojtësit e të drejtave të palëve në procedurë, konkretisht avokatët, shpeshherë janë treguar neglizhent dhe jo-respektues ndaj gjykimeve dhe vet gjykatës.

Trupi gjykues dhe gjykatësi janë të obliguar që ndaj mbrojtësve të shqiptojnë masa ndëshkimi në rastet kur të njëjtit nuk i përgjigjen ftesës së rregullt dhe vonohen në gjykime. Pavarësisht vonesave, trupi gjykues dhe gjykatësi i çështjes, për fajin e të cilëve edhe vonohen gjykimet, nuk evitojnë këtë problem dhe nuk shpitojnë sanksionet dhe masat e nevojshme ndaj atyre që vonohen.

Në Gjykatën e Qarkut Prizren, në gjykimin e mbajtur me 15.03.11. Lënda: Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20, Armëmbajtje pa leje nga neni 328 par.2, lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 të KPK-së. P.nr. 201/10, ku kryetar i trupit gjykues ishte Xhevdet Elshani, fillimisht seanca u shty për një orë derisa të vie avokatja Qollaku. Pas një ore nga fillimi i gjykimit me vonesë, gjykatësi i shqiptoi avokates Qollaku "Vërejtje Publike" me arsyetimin se e njëjta e ka ditur që seanca do të fillojë nga ora 10:00 dhe nuk ka treguar respekt për gjykatën dhe klientin e saj.

Edhe në Gjykatën Komunale në Lipjan, kemi raste të vonesave të avokatëve, të cilat pamundësuan fillimin e gjykimit me kohë. Në gjykimin e mbajtur me 07.04.2011, Lënda: "Anulim i kontratës" me numër Cnr. 31/2000, ku gjykatës ishte Jusuf Bytyqi, fillimi i seancës shtyhet për më shumë se 2 orë për shkak të vonesës së avokatit Naser Gashi.

Gjykata e Qarkut në Pejë kishte filluar po ashtu gjykimet më vonesë. Në gjykimin e mbajtur me 31.03.2011, Lënda: "Vrasje në bashkëveprim dhe tentim vrasje në bashkëveprim", nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe nenin 23; nenin 146 lidhur me nenin 23 të KPK-së, P.nr:217/08, ku trupi gjykues ishte në përbërje: Sali Berisha kryetar, Sylë Lokaj dhe 3 gjyqtarë porotë: Ramiz Baloku, Enver Dranqolli dhe Turhan Gjokolli; seanca filloi me 40 minuta vonesë për shkak të vonesës së mbrojtësit të të pandehurit të dytë, i cili ishte i angazhuar në një çështje tjetër penale në të njëjten gjykatë.

Në gjykimin e mbajtur me 21.04.2011, në lëndën: "Vrasje në bashkëveprim dhe Mosdhënie e ndihmës", nga neni 146 lidhur me nenin 23 dhe neni 156 par 1 të KPK-së, P.nr:94/10, gjykimi filloi me 35 minuta vonesë për shkak të vonesës së mbrojtësit Zenel Mekaj, i cili ishte i angazhuar në një gjykim tjetër që po mbahej në atë kohë dhe për të u desh të pritet 35 minuta. Përbërja e trupit gjykues ishte: Lumturie Muhaxheri kryetare, Gëzim Pozhegu dhe 3 gjyqtarë porotë Zehra Elezi, Ismet Imami dhe Nysret Bala.

Përfaqësuesi i palës paditëse ishte shkaktar i fillimit më vonesë të gjykimit të mbajtur me 17.05.2011 në Gjykatën Komunale në Therandë. Lënda ishte "Padi për kompenzim dëmi me pasoja vdekje", Cnr – 74/09, ku gjykatës i çështjes ishte Robert Tunaj.

Arsye të tjera që shkaktojnë vonesa të gjykimeve, e të cilat vazhdojnë të përsëriten, janë vonesat e palëve, zgjatja e gjykimit paraprak dhe transporti i palëve. Në vazhdim mund t'i gjeni disa nga rastet e monitoruara:

Gjykata Komunale në Skenderaj, mbajtur me 30.09.2011. Lënda numër C. Nr. 245/10. Seanca ka filluar me vonesë për shkak të vonesës së palëve.

Gjykata e Komunale në Therandë, mbajtur me 16.05.2011. Lënda: "Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 para 3 lidhur me para 1 të KPK - së", Pnr – 341/09. Gjykatësi: Avdyl Elshani; Seanca filloi me 25 minuta vonesë për shkak të vonesës së të akuzarit.

Gjykata e Qarkut në Pejë, mbajtur me 06.09.2011. Lënda: "Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve" nga neni 328 par. 2 të KPK-së. P.nr. 70/11. Trupi gjykues: Gëzim Pozhegu dhe dy gjyqtarë porotë. Kjo seancë gjyqësore nuk ishte e lajmëruar në tabelën e shpalljeve të gjykatës. E njëjta fillon me 35 minuta vonesë për shkak të zgjatjes së seancës paraprake.

Gjykata Komunale në Drenas, mbajtur me 15.03.2011. Lënda: "Dëmtim i pasurisë së luajtshme", nga neni 260 par. 1 të KPK-së; Lënda: P.nr. 170/09; Kryetar i trupit gjykues Shfqet Baleci. Seanca ishte e lajmëruar në tabelën e shpalljeve, u mbajt në sallën e gjykimeve dhe filloi me 1 orë e 35 min vonesë për shkak të zgjatjes së seancës paraprake.

Gjykata Komunale në Ferizaj, mbajtur me 01.11.2011. P.nr. 232/04, lënda “Vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 në nën par 1 të KPK-së”. C.nr. 201/08, mbajtur me 06/10/2011. Lënda “ Vërtetim Pronësie” u vonua për shkak të vonesës së përkthyesve.

Gjykata Komunale në Podujevë, mbajtur me 10.11.2011. Lënda: Vërtetim pronësie. Cnr. 251/07. Gjykatës: Virginia Rusova. Për shkak të mos ardhjes së përkthyesve, seanca fillon me 2 orë vonesë. Kjo u shkaktua duke pritur përkthesën deri sa të vij në gjykatë.

Gjykatat në Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Podujevë janë ato që më së shumti fillojnë gjykimet me vonesë për shkaqe të përmendura më lartë. Ndërsa në anën tjetër, gjykatat të cilat tregohen më të përpikëta, janë Gjykata Komunale në Ferizaj dhe Gjykata Komunale në Vushtrri.

Përfundim

Vonesat e fillimit të gjykimeve vazhdojnë të jenë një ndër të metat kryesore që shoqërojnë seancën gjyqësore e të cilat ne konsiderojmë se mund të evitohet me një angazhim të vogël.

Fillimi më vonesë i një seance gjyqësore, shkakton telashe në mbarëvatjen e gjykimeve tjera, të cilat shtyhen për shkak të vonesave. Gjithashtu, duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura në gjykata, vonesa e fillimit të gjykimeve vazhdon t'i komplikojë edhe më tej procedurat gjyqësore, duke zvarritur seancat dhe shtuar numrin e lëndëve të pazgjidhura.

3. Mospërgatitja e prokurorëve në gjykim

Sipas KPPK-së, prokurori publik është palë në procedurën gjyqësore, i cili sipas detyrës zyrtare obligohet të ndjekë veprat penale të parapara në legjislacionin penal të Kosovës.⁶²

BIRN gjatë monitorimit, ka identifikuar jo pak raste kur prokurorët publik të çështjes, kanë ardhur të papërgatitur në seancë gjyqësore.

Në Gjykatën komunale në Drenas, në gjykimin e mbajtur me 13.10.2011, Prokurori i çështjes Shkëlzen Ibrahim, gjatë leximit të aktakuzës bëri shumë gabime sa që disa herë e përseriti të njëjtën fjali pasi që nuk ishte i përgatitur për seancën. Arsyetimi i tij ishte se lëndën e kishte marrë në momentin kur ishte nisur për në gjykim në Drenas duke e fajësuar shkrimoren e prokurorisë. Lënda ishte "Vjedhje e rëndë" nga neni 253 par 1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, KA. 83/11 me gjykatës Daut Behrami.

Prokurori tjetër nga Prokuroria Komunale e Prishtinës, Imer Beka, vie i papërgatitur në gjykimin e mbajtur me 12.04.2011 në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Për më shumë, prokurori nuk e kishte me vete as aktin akuzues. Lënda ishte "Rrezikim i trafikut publik" nga neni 297 par. 5 të KPK-së, Pnr.508/10 me gjykatës Nexhmedin Sejdiu.

Gjatë tryezës për diskutimin e të gjeturave të këtij raporti të cilin BIRN e ka organizuar me 25.06.2012, kryeprokurori komunal në Prishtinë, Haki Gecaj, ka dhënë sqarim për rastin në fjalë. Sipas tij, Imer Beka e pa paraqitur aktakuzën, ngase për këtë është

lutur nga gjykatësi i lëndës, Nexhmedin Sejdiu, të cilin e kishte takuar në korridor të gjykatës. Sipas kryeprokurorit Gecaj, ai është informuar për këtë nga vet Imer Beka, me të përfunduar ky gjykim.⁶³

Mirëpo jo vetëm prokurorët komunal janë ata të cilët shkojnë të papërgatitur në gjykim.

Edhe në veprat penale të rënda, ku përfaqëson prokuroria speciale, monitorimi ynë ka identifikuar raste kur prokurorët kanë qenë të papërgatitur.

Konkretisht në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, me 20.07.2011, në lëndën: "Shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit Kontrabandimi me migrantë, Mundësim i prostitucionit dhe Pastrim i parave" nga neni 339 par. 1 lidhur me par. 23, neni 138 par. 1 dhe 3 lidhur me nenin 23, neni 201 par. 3, të KPK-së dhe neni 11 nga rregullorja e UNMIK-ut 2006/53, Pnr:20/10, seanca filloi me propozimin e prokurorit për leximin e disa provave materiale, të cilat ishin kryesisht raporte policore.

Mbrojtja e kundërshtoi një propozim të tillë, ndërsa kryetarja e kolegjit kërkoi shpjegime lidhur me këtë raport. Prokurori Special Sead Kuraja nuk pati një shpjegim se pse po e propozon një provë të tillë dhe nuk e dinte për çfarë duhej ajo në lëndë.

Gjatë kësaj seance u pa që prokurori nuk ishte i përgatitur, të jepte përshtypjen se nuk dinte se çfarë kishte lënda.

62. Për shkak të gjendjes politike në Mitrovicë, ku gjykatat e kësaj komunë gjenden në pjesën veriore, ekipi i monitoruesve të BIRN-t nuk ka monitoruar në pjesën veriore, mirëpo ka monitoruar seanca nga këto gjykata, e të cilat janë mbajtur në objektin e Gjykatës Komunale në Vushtrri për shkak të funksionimit të vet në kushte të jashtëzakonshme për shkak të pamundësisë për të funksionuar në ndërtesën e vet legjitime në Mitrovicë.

63. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 328, Pika 1, Shqyrtimi gjyqësor është i hapur; Ligji për Procedurën Kontestimore, Neni 444, Pika 1, Shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet publikisht.

Gjatë seancës, për shkak se kishta ardhur i papërgatitur, prokurori u detyrua që ta lexonte provën materiale që vet e propozonte, për ta prezantuar si provë para gjykatës. Për shkak të mugesës së përgatitjes, prokurori shkaktoi huti më vonë gjatë seancës pas kërkesës së gjykatës lidhur me emirin e një personi.

Pasi që kryetarja e kolegjit u mundua t'ia shpjegonte prokurorit se çka duhet të bënte, dhe për shkak se ky i fundit nuk dinte se si të vepronte, kryetarja e kolegjit morri aktvendim dhe e shpalli komplet provën si të papranueshme, por e lejoji mundësinë që të ftohet polici që e ka përpiluar raportin për të dëshmuar.

Monitorimi i BIRN-it, ka identifikuar raste edhe më ekstreme, kur kryetari i trupit gjykues, fillon të marrë në pyetje prokurorin e çështjes, edhe pse prokurori kishte përfunduar me fjalën përfundimtare. Në gjykimin e mbajtur me 20.11.2011 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, pasi që prokurorja e Qarkut në Prishtinë Fekrije Fejzullahu përfundoi fjalën e saj përfundimtare për akuzën, kryetari i trupit gjykues filloi të shtronte pyetje në lidhje me aktakuzën dhe çështjet që lidheshin me të.

Kryetari Hamdi Ibrahim i kërkoi prokurores që të tregojë dhe analizojë se cila provë lidhet me cilin veprim dhe të arsyetojë mirë atë e jo vetëm të mbetet pranë aktakuzës ashtu siç është bërë praktikë.

Kryetari i trupit gjykues i ofroi prokurores edhe një mundësi që e njëjta të përgatitet. Pas këtij reagimi të kryetarit të trupit gjykues, prokurorja kërkoi nga trupi gjykues kohë që të përgatitet mirë për këtë fjalë përfundimtare, e pastaj të paraqitet. Lënda kishte të bënte me "Grabitje të kryera në bashkëkryerje" nga neni 255 par 3 lidhur me

par 1 krejt lidhur me nenin 23 të KPK-së, me numer P.nr:268/09.

Edhe më keq qëndron situata kur prokurori i njëjtë, në të njëjten lëndë, pas një muaj kohë, në fjalën përfundimtare vie prapë e papërgatitur, përkundër vërejtjeve të marra në seancën paraprake.

Edhe pse BIRN ka trajtuar në vitet e kaluara problemin e mospërgatitjes së prokurorëve në gjykime, e në veçanti rastet kur prokurori shkon në gjykim pa aktakuzë fare, fatkeqësisht e njëjta dukuri vazhdon ta shoqërojë gjyqësinë e Kosovës.

BIRN ka identifikuar raste të shumta kur prokurori ka përfaqësuar aktakuzën edhe pse atë nuk e ka pasur fare me vehte. E në shumë raste, aktakuzën ka vazhduar ta huazojë nga gjykatësi/trupi gjykues.

Kjo ka ndodhur në gjykimin e mbajtur me 29.04.2011 në Gjykatën Komunale në Therandë, në lëndën "Vjedhje e rëndë" nga neni 253 paragrafi 1 i KPK-së, KA- 13/11. Prokurorja Elfete Purova, nuk e kishte lëndën me vehte, ndërsa aktakuzën e huazoi nga gjykatësi Nuredin Abazi.

Po të njëjten ditë, në lëndën penale "Lëndim i rëndë trupor" nga neni 154 para 1 i KPK-së, prokurorja e njejtë Elfete Purova, huazoi aktin akuzues nga gjykatësi i njejtë Nuredin Abazi, duke vazhduar kështu me përfaqësimet e papërgatitura.

Raste të njëjta, kur prokurori vie pa aktin akuzues në gjykim, kemi edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Kjo kishte ndodhur në gjykimin e mbajtur me 12.04.2011, kur prokurori i çështjes penale "Rrezikim i trafikut publik" Imer Beka nuk e kishte aktin akuzues me vehte, ndërsa në anën tjetër gjykatësi i çështjes Nexhmedin Sejdiu, në mes të gjykimit i përgjigjet thirrjes telefonike.

Procesi i emërimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve ka sjellur emra të rinj në prokurori, mirëpo nuk ka plotësuar të gjitha vendet e lira në prokuroritë e të gjitha niveleve.

Njëjtë si në vitin e kaluar, arsyetimi i prokurorëve është mungesa e numrit të mjaftueshëm të prokurorëve, e cila detyron prokurorët që të përfaqësojnë aktakuzat e shumta dhe në raste të caktuara, të shkojnë pa aktakuzë dhe të njëjtën ta huazojnë nga gjykatësi.⁶⁴

Ky është arsyetim i shpeshtë i prokurorëve, i cili në masë të madhe është edhe i bazuar. Por kjo nuk e arsyeton mungesën e përgatitjes dhe paraqitjes në seancë të papërgatitur dhe pa lëndë. Në rastet e tilla, trupi gjykues do të duhej të vendoste nëse janë plotësuar kushtet për të vazhduar gjykimin apo jo.

Përfundim

Trupi gjykues do të duhej ta njoftonte kryeprokurorin për mospërgatitjen e prokurorit, e në veçanti për ardhjen në seancë pa aktakuzë.


Kryeprokurori do të duhej që së paku të ndërmerre masa disiplinore ndaj prokurorëve të tillë për t'u siguruar që prokuroria e kryen punën e vet si duhet.

4. Pasiviteti i anëtarëve të trupit gjykues (porotë) gjatë gjykimit

Varësisht nga pesha e veprës penale, gjykata gjykon në trup gjykues. Monitorimi i BIRN ka identifikuar se nga 460 seanca të monitoruara me gjykatës porotë, në 177 apo 38.47% të këtyre seancave, gjykatësit porotë kanë qenë tërësisht pasiv. Pasiviteti i tyre ka shënuar rënie të dukshme në krahasim me vitin e kaluar ku gjyqtarët porotë kanë qenë pasiv në 315 seanca apo 63.10% të seancave të monitoruara.

64. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

Numri i seancave të monitoruara në të cilat gjyqtarët porotë kanë qenë/nuk kanë qenë aktivë



Anëtarët e trupit gjykues, në këtë rast gjykatësit porotë, kanë të drejtë pjesëmarrje aktive gjatë gjyimit, duke shtruar pyetje dhe gjithashtu duke votuar në procedurën e konsultimit gjatë vendosjes për rastin.

Fatkeqësisht, gjendja në terren, e monitoruar nga BIRN tregon që gjyqtarët porotë nuk luajnë rol aktiv gjatë gjykimeve. Pasiviteti i tyre shkon aq larg, sa që BIRN ka shënuar raste kur gjykatësit porotë i zë gjumi gjatë gjyimit.

Nga monitorimi i BIRN, kemi raste kur të njëjtit përveç që janë pasiv edhe flejnë në gjykim.

Monitorimi jonë tregon se në të shumtën e rasteve, gjyqtarët porotë vazhdojnë të jenë në gjykim vetëm sa për të plotësuar formalisht kriterin ligjor në lidhje me përbërjen e trupit gjykues.

Rast i tillë është kur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në seancën e mbajtur me 17.11.2011 Lënda: “Vrasje e rëndë” nga neni 147 I KPK-së gjykatësin porrot Hamëz Mehmeti e zinte gjumi derisa gjykohej një vrasje e rëndë për të cilën po dëgjohej dëshmia e dëshmitarit V.K. Kryetar i trupit gjykues ishte Mejdi Dehari.

Përfundim:

Anëtarët e trupit gjykues– gjykatësit porotë, do të duhej që të jenë aktiv gjatë seancave gjyqësore. Të njëjtit, përveq pjesëmarrjes aktive gjatë gjyimit me pyetjet e tyre, do të duhej të ishin aktiv edhe më rastin e procedurës konsultuese për votim dhe në vendosjen e çështjes.

Për këtë, përgjegjësia iu kalon më shumë kryetarëve të trupit gjykues, të cilët do të duhej të respektonin procedurat gjyqësore të cilat e rregullojnë angazhimin, detyrat dhe obligimet e anëtarëve të trupit gjykues.

5. Dëshmia e dëshmitarëve gjatë gjykimit

Gjatë seancave gjyqësore, dëshmia e dëshmitarëve është një ndër provat materiale e cila konsiderohet e rëndësishme për zbardhjen e së vërtetës dhe shpesh herë është provë kyçe për ndriçimin e rastit.

Sikurse në raportin e vitit të kaluar, BIRN gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, fillimisht ka identifikuar raste të mosparaqitjes së dëshmitarëve në gjykim. Edhe pse KPPK neni 167 parasheh dënim me gjobë për mosparaqitjen e dëshmitarëve në gjykim, nga 1920 seancat e monitoruara, BIRN ka shënuar vetëm dy raste kur është shqiptuar dënim me gjobë ndaj dëshmitarit për shkak të mungesës së tij.

Një rast i tillë ka ndodhur në Gjykatën Komunale në Prizren, në seancën e mbajtur me 01.03.11. Lënda: Lëndim i lehtë trupor nëni 153 të KPK-së, P.nr. 253/08. Gjykatës: Sefidin Bajraktari, PPK: Sefer Morina. Ndaj të dëmtuarit dhe dëshmitarit të cilët nuk kanë prezantuar në gjykim dhe nuk e kanë arsyetuar mungesën e tyre gjykatësi i shqiptoi dënimin me gjobë në vlerë prej 50 euro. Aktvendimi për këtë dënim do t'iu dërgohet palëve së bashku me ftesat e reja për seancën e ardhshme.

Nga seancat e monitoruara, janë identifikuar raste të shumta të mungesës së dëshmitarëve në gjykim, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt. Disa nga këto raste janë shënuar në vijim.

Gjykata Komunale në Ferizaj, mbajtur me 13/09/2011. Lënda: "Vjedhje nga neni 252 par 1 të KPK-së", P.nr 819/07. Gjyqtar: Bashkim Hyseni. Kjo seancë u shty pasi që në

këtë seancë nuk ishin prezent e dëmtuara R. T dhe dëshmitari M. T. Të njëjtit ftesën e kan pranuar në mënyrë të rregullt dhe mosparaqitjen e tyre në gjykatë deri më tani nuk e kanë arsyetuar me asgjë, andaj ndaj tyre gjykata lëshoi urdherarrest.

Gjykata Komunale në Ferizaj, mbajtur me 01/11/2011. Lënda: "Lëndim i lehtë trupur nga neni 153 par 1 nën par 4 të KPK-së", P.nr 1137/10. Gjyqtar: Agim Maliqi. Pasi që në këtë seancë nuk është prezent dëshmitarja H.A., Prokurori Publik i propozon gjykatës që në seancën e rradhës të ftohet e njëjta.

Gjykata Komunale në Malishevë, mbajtur me 09/12/2011. Lënda: "Vjedhje nga neni 252 par 1 i KPK-së", P.nr 183/08. Gjyqtar: Haki Kryeziu. Në gjykatë nuk prezantonte edhe përfaqësuesi i KEK-ut A. F. si dhe dëshmitarët A. M. dhe N. F. dhe M. B. Të gjithë ishin ftuar me kohë dhe me rregull, ndërsa mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata Komunale në Rahovec, mbajtur me 29/11/2011. Lënda: "Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par 3 i KPK-së", P.nr 245/11. Gjyqtar: Shaban Shala. Në seancë nuk prezantonte dëshmitari B. K. i cili ishte ftuar me kohë dhe me rregull.

Gjykata Komunale në Rahovec, mbajtur me 22/11/2011. Lënda: "vjedhje nga neni 252 par 1 i KPK-së", P.nr 261/09. Gjyqtar: Shaqir Zika. Gjykatësi konstatoi se në seancë nuk prezantonin i akuzuari i cili ishte ftuar me kohë dhe me rregull. Poashtu në seancë nuk prezantonte dëshmitari A.J. që gjithashtu ishte ftuar me kohë dhe me rregull dhe mungesën e tij nuk e kishte arsyetuar. Në gjykatë prezent ishte i dëmtuari A. Sh.

Gjykata Komunale në Rahovec, mbajtur me 22/11/2011. Lënda: “Punime ndërtimore të kundërligjshme nga neni 294 par 2/1 i KPK-së”, P.nr 13/07. Gjyqtar: Shaqir Zika. Seanca nuk u mbajt për shkak të mungesës së të akuzuarit dhe dëshmitarit. Nga fletëkthesa shihej se është i panjohur, poashtu nuk ishte prezent as dëshmitari I.B.

Gjykata Komunale në Therandë, mbajtur me 15/04/2011. Lënda: “Padi për kthimin e borxhit”, C.nr 294/08. Gjyqtar: Shaban Zeqiri. Në seancë nuk ishin prezent dëshmitari Xh.R., i cili është ftuar në mënyrë të rregullt por ka refuzuar pranimin e ftesës dhe H.Rr., i cili në seancën e datës 04.04.2011 ka qenë present dhe është ftuar gojarisht, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

Marrë parasysh faktin se nuk ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e gjykimit, trupi gjykues kishte ndërprerë seancat nga këto raste të paraqitura më lartë, mirëpo nuk kishte zbatuar dispozitat procedurale që kanë të bëjnë me sanksionet ndaj dëshmitarëve që nuk i ishin përgjigjur ftesës dhe nuk kishin arsyetuar mospraninë e tyre për të dëshmuar.

Poashtu, janë evidentuar raste kur dëshmitarëve nuk u lexohen të drejtat e tyre e as deklarata e betimit, siç është paraparë me kodin e procedurës penale. Disa prej këtyre rasteve përfshijnë:

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në gjykimin e mbajtur me 16.12.2011, trupi gjykues në përbërje prej Hajrije Shala kryetare, Mejreme Memaj dhe 3 gjyqtarë porotë në lëndën: “Grabitje dhe Raste të rënda të vjedhjes grabitqare dhe grabitjes” të gjitha të kryera në bashkëkryerje nga neni 255 par 3 lidhur me par 1 dhe neni 256 par 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, me numër

P.nr:171/11, nuk i lexuan fare të drejtat e dëshmitarit F.B., pasi që e kishin ftuar ta jepte dëshminë e tij.

Në të njëjtën gjykatë, me trupin gjykues në përbërje prej Mejdi Dehari kryetar, Hajrije Shala dhe 3 gjyqtarë porotë, nuk ju lexuan të drejtat dëshmitares të dëmtuar, edhe pse tha se i'u janë lexuar në seancën e parë, por ajo seancë ishte mbajtur para me shumë se 3 muajve, edhe përkundër faktit se gjykata prapë e ka obligim leximin e të drejtave të dëshmitarit nga neni 356 par 1, 2 dhe 3 të KPPK-së. Gjykimi ishte me numër P. Nr 215/10 dhe ishte mbajtur me 20.09.2011.

Monitorimi i BIRN-it, ka identifikuar raste tjera kur dëshmitarëve nuk iu kishin lexuar të drejtat në gjykim. Në Gjykatën e Qarkut në Pejë, trupi gjykues në përbërje prej Sali Berisha kryetar, Sylë Lokaj dhe 3 gjyqtarë porotë Ramiz Baloku, Enver Dranqolli dhe Turhan Gjokolli, vazhduan seancën me marrjen në pyetje të dëmtuarit/dëshmitarit Sh.M. të cilit nuk iu lexuan të drejtat si dëshmitar e as nuk iu tërhoq vërejtja, me çka u shkel neni 164 par 2 i KPPK-së. Gjykimi ishte mbajtur me 30 mars 2011, dhe lënda ishte “Vrasje në bashkëveprim dhe tentim vrasje në bashkëveprim”, nga nenin 146 lidhur me nenin 23; neni 146 lidhur me nenin 20 dhe nenin 23 të KPK-së, me numër P.nr:217/08.

Gjithashtu Gjykata Komunale Suharekë, në gjykimin e mbajtur me 04.04.2011 nuk kishte njoftuar fare dëshmitarin me të drejtat e tij. Gjykatës i lëndës ishte Shaban Zeqiri në lëndën: “Padi për kthimin e borxhit”, nën shenjen C. Nr 192/08.

Përgjashtim bëjnë gjykimet e EULEX, në të cilat fillimisht dëshmitari njoftohet me të drejtat e tij dhe i lejohet deklarata e betimit.

Rastet kur dëshmitarët ndërrojnë deklaratën me atë të dhënë në polici dhe prokurori janë të shpeshta, duke e kompromituar tërësisht rastin e ngritur nga prokuroria. Në shumicën e rasteve, kjo arsyetohet me faktin se ka kaluar një kohë e gjatë nga deklaratat e tyre fillestare në polici dhe prokurori dhe rrjedhimisht dëshmitarët arsyetohen se nuk iu kujtohet realisht çfarë ka ndodhur.

Konkretisht kjo ka ndodhur në rastet në vijim: Gjykata Komunale në Ferizaj, me datën 24/11/2011 - P.nr. 1060/11, lënda "Lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe vepra penale: Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 317 par 2 lidhur me par 1 dhe neni 23 të KPK.

Gjykata Komunale në Ferizaj, me datën 01/11/2011 - P.nr. 1137/10, lënda "Vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 në nën par 1 të KPK-së".

Gjykata Komunale në Shtërpce, mbajtur me 11/11/2011. C.nr.16/09, Kompensim dëmi;

Gjykata Komunale në Shtërpce, mbajtur me 25/10/2011. C.nr.47/04, lënda "Përmbushja e kontratës".

Parregullsia tjetër e identifikuar gjatë monitorimit është shkelja e procedurave gjatë marrjes së pyetje të dëshmitarëve. Në shumë seanca gjyqësore të monitoruara ka ndodhur që dëshmitarët të merren në pyetje në prani të dëshmitarëve tjerë që prisnin për të dëshmuar. Raste të tilla kanë ndodhur si në vijim:

Gjykata e Qarkut Prizren, gjykimi i mbajtur me 27 prill 2011. Lënda: vrasje nga neni 146 të KPK-së, pastaj vepra penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të

KPK-së, si dhe vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 të KPK-së. P.nr. 37/11. Kryetari i trupit gjykues: Xhevdet Elshani. Derisa merrej në pyetje ky dëshmitar, në sallë ishte prezent dëshmitari M. Sh, këtë e kuptoi gjykatësi vetëm kur kërkoi që të thirret dëshmitari për të dëshmuar, duke menduar se i njëjti është jashtë duke pritur për të dëshmuar, e që në fakt ai kishte hyrë brenda pas pauzës, të cilin trupi gjykues nuk e kishte vërejtur, për shkak se kishte shumë publik në sallë.

Gjykata Komunale Prizren, gjykimi i mbajtur me 10.03.2011. Lënda: Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së. P.nr.54/08. Gjykatës: Skender Çoçaj. Derisa përfaqësuesi i KEK-ut, jepte deklaratën e tij, nga salla nuk u larguan fare dy dëshmitarët tjerë, kjo i ra ndërmend gjykatësit vetëm pas deklaratës së përfaqësuesit të KEK-ut dhe i urdhëroi që të presin jashtë në koridor.

Fillimisht trupi gjykues është i obliguar me rregull procedural që t'i njoftojë dëshmitarët me të drejtat dhe obligimet e tyre gjatë seancës gjyqësore. Gjithashtu, obligim tjetër i trupit gjykues është që të shqiptojë gjobë ndaj dëshmitarëve të cilët nuk i përgjigjen në mënyrë të rregullt ftesave të gjykatës, e që nga monitorimi i BIRN, identifikohen situata të shumta kur trupi gjykues nuk respekton këto rregulla procedurale.

Për më shumë, trupi gjykues nuk do të duhej të marrë dëshminë e dëshmitarëve, në praninë e dëshmitarëve që presin për të dëshmuar në çështjen e njëjtë. Në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës ka për obligim që sa më shpejtë të miratojë ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili do të sigurojë shkallë më të lartë të bashkëpunimit të dëshmitarëve.

6. Përkthimi gjatë mbajtjes së gjykimeve Legjislacioni në fuqi, qoftë ai i fushës penale apo civile garanton palët dhe pjesëmarrësit e nacionaliteteve të tjera që në procedurat gjyqësore të përdoret gjuha e tyre zyrtare.

Monitorimi në terren ka treguar që ekzistojnë vështirësi në realizimin e kësaj të drejte. Ka shumë raste që mbahen në disa gjuhë, sidomos gjykimet e mbajtura nga EULEX ku edhe janë hasur shqetësimet kryesore.

BIRN ka identifikuar disa raste kur përkthyesit EULEX-it kanë pasur vështirësi në përkthimin adekuat të fjalëve, duke ndryshuar kuptimin e fjalëve në përkthimin e shkresave të ndryshme gjyqësore.

Një rast i tillë ka ndodhur me datën 06/09/2011 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, Lënda: "Krime lufte kundër popullatës civile dhe Dhënia e ndihmës kryesit të veprës penale"; P.nr:411/10. Kolegji i gjykatësve: Horst Poetel kryetar, Tore Tomasson dhe Rafet Haxhaj, Prokurori Special: Mauricio Salustro. Para se të fillonte me pyetjet, mbrojtja bëri vërejtje në arsyetimin për zgjatjen e paraburgimit, në të cilin gjykata kishte thënë se "nga dëshmia e dëshmitarëve dhe nga dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues si dhe provave tjera materiale shihet se i pandehuri ka kryer veprën penale të krimeve të luftës" e me këtë kolegji po e paragjykon çështjen. E kryetari i kolegjit deklaroi se në gjuhën angleze është ndryshe dhe atë se "ekziston dyshimi i bazuar që i pandehuri e ka kryer veprën penale të krimeve të luftës".

Me këtë shihet se përkthyesit e EULEX-it në këtë rast nuk kanë përkthyer si duhet çka edhe ndikon direkt në procedurë.

Më probleme të shumta të përkthimit, gjyqësori është përballur edhe në gjykimet e profilit më të lartë si ai i rastit Bllaca.

Gjatë përkthimit, ka pasur vërejtje të avokatëve e po ashtu të prokurorit për shkak të përkthimit të dobët. Vërejtjet kanë pasur të bëjnë me përkthim jo të plotë apo të pjesërishtë, përkthim jo të duhur, përkthimi tekstual pa përshtatje në kontekst, etj..

Këto mangësi në përkthim shkaktojnë pakuptimësi tek palët në procedurë duke e ulur kredibilitetin e tërë procesit gjyqësor. Rast i ngjashëm ka ndodhur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, mbajtur me 18/10/2011. Lënda: "Krim i organizuar, Trafikim me njerëz, Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe Shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit të gjitha në bashkëkryerje" nga neni 274 par 1 dhe 3, neni 139 par 1, neni 221 par 1 dhe neni 339 par 3 të gjitha lidhur me nenin 23 të KPK-së; P.nr:309/10; P.nr:340/10. Kolegji i gjykatësve: Arkadiusz Sedek kryetar, Dean Pineles dhe Hamdi Ibrahim, Prokurori i EULEX-it: Jonathan Ratel. Gjatë seancës disa herë pati vërejtje në përkthimin që po bënte përkthyesja e EULEX-it, për këtë edhe prokurori gjatë pushimit tha se do të ngrehë këtë çështje në instancat e EULEX-it.

Rast tjetër i ngjashëm është poashtu në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, mbajtur me 17/05/2011. Lënda: Krime lufte kundër popullatës civile dhe Dhënia e ndihmës kryesit të veprës penale"; P.nr:411/10. Kolegji i gjykatësve: Horst Protel kryetar, Tore Thomason dhe Rafet Haxhaj, Prokurori Special: Mauricio Salustro. Shqyrtimi vazhonte me marrjen në pyetje të dëshmitarit kryesor Nazim Bllaca, i cili ishte dëshmitar bashkëpunues.

Gjatë pyetjeve të mbrojtësit, mbrojtësi i të pandehurit e kundërshtoi përkthyesin për mënyrën se si po e përkthente dhe se nuk po e lejonte mbrojtësin që të pyesë dëshmitarin si duhet, me këtë rast reagoi përkthyesi duke thënë se i duhet kohë që të përkthejë atë që po thoshin palët, por kryetari i kolegjit e ndërroi përkthyesin që të mos shkaktoshin më shumë polemika.

Mirëpo nuk mungojnë edhe rastet kur vet gjykatësi, avokati, palët e deri të referentët, kishin marrë rolin e përkthyesit. Një rast i tillë ka ndodhur në Gjykatën e Qarkut në Pejë, mbajtur me 29/06/2011. Lënda: "Mbajtje në pronësi, kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve" nga neni 328 i KPK-së. Ka.nr. 165/11. Gjyqtar: Sali Berisha, Prokurorë publike: Xhemajlije Mustafa.

Gjyqtari e ftoi të akuzuarin për t'ia shënuar të dhënat personale, mirëpo i njëjti nuk e kuptonte gjuhën në të cilën zhvillohej gjykimi. Përkthimin e bënte gjyshi i tij Bajram Bicaj me ndihmën e avokatit mbrojtës dhe prokurorës. Gjyqtari thoshte se duhet të ftohet një përkthyes, ndërsa avokati dhe prokurorja publike deklarorin se këtë mund ta bëjnë edhe pa praninë e përkthyesit.

Prokurorja publike e lexoi aktakuzën në gjuhën serbo-kroate edhe pse të njëjtën e kishte të shkruar në gjuhën shqipe. Më pas, kur prapë kishte vështirësi me përkthim, gjyqtari e fton referentin Nysret Kolica i cili edhe pse nuk është përkthyes zyrtar i gjykatës, llogaritej si njohës i gjuhës serbo-kroate dhe në pjesën e mbetur të seancën bëri përkthimin.

Rast tjetër është në Gjykatën Komunale në Pejë, mbajtur me 16/06/2011. Lënda: "Shmangje nga tatimi" nga neni 249 par. 1 i KPK-së .P.nr. 396/08. Gjyqtar: Sami Sharraxhiu, Prokurorë publike: Sahide Gashi. Për disa minuta kur përkthyesja del nga salla e gjykimeve për t'i bërë disa kopje të dokumentacioneve të caktuara (fatura të pagesave), gjykimi vazhdoi pa përkthyes ku rolin e përkthyesit e luante vet gjyqtari e herë herë ndihmohej edhe nga prokurorja.

Gjyqtari madje kujdesej edhe për t'i ofruar përkthim publikut. Pandehuri ishte i nacionalitetit serb dhe nuk e kuptonte gjuhën në të cilën zhvillohej gjykimi.

Përfundim

Edhe pse e trajtuar në vitin e kaluar,⁶⁵ problemet në përkthim, vazhdojnë të reflektojnë negativisht në punën e gjykatës dhe në shkeljen e të drejtave themelore të njeriut për gjykim të drejtë në gjuhën e tyre. E gjithë kjo vazhdon të ndikojë në cilësinë e shqyrtimit gjyqësor si dhe në tendencën e komuniteteve të cilat nuk e flasin gjuhën shqipe të mos kenë besim të plotë në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Mbetet detyrë e KGJK-së që duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat në të cilat jetojmë, të ngrisë besimin e komuniteteve të cilat nuk e flasin gjuhën shqipe në sistemin kosovar të drejtësisë, së paku duke siguruar përkthim profesional në gjuhën e tyre.

7. Procesverbalet e gjykimeve

Nga monitorimi i Gjykatave, BIRN ka identifikuar edhe raste kur jo të gjitha veprimet procedurale gjatë gjykimeve, përfshihen në procesverbal.

65. "Raporti i Monitorimit të Gjykatave prill 2010 – shkurt 2011". BIRN. Prishtinë. Shtator 2011.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës shprehimisht parasheh se procesverbal i shqyrtimit gjyqësor duhet të përpilohet me shkrim dhe përcakton përmbajtjen e tij.

Në raportin e vitit të kaluar, BIRN kishte identifikuar raste të shumta kur procesverbalet nuk paraqisnin pasqyrën reale të veprimeve të ndërmarra gjatë seancave gjyqësore. Jo të gjitha veprimet procedurale ishin përfshirë në disa nga procesverbalet e gjykimit.⁶⁶ Edhe pse situata është përmirësuar lehtësisht, prapë qëndrojnë lëshime nga ana e gjykatës/trupit gjykues në përfshirjen e të gjitha veprimeve të nevojshme procedurale të një seance gjyqësore.

Gjykatësit, në shumicën e rasteve, bëjnë përmbledhjen e veprimeve që ndodhin gjatë shqyrtimit.

Në të njëjtat shqyrtime, BIRN ka identifikuar raste kur fare nuk është lexuar padia, përgjigja në padi, apo të drejtat tjera procedurale të përcaktuara me dispozita procedurale, kurse në procesverbal është konstatuar se të njëjtat janë lexuar.

E gjithë kjo ka bërë që publiku i pranishëm në shqyrtim të mos dijë se çka realisht përmban padia, apo pala të mos jetë e njoftuar më të drejtat e saj që i takojnë edhe në bazë të ligjit.

Sipas gjykatësve, më rëndësi është që të kuptohet padia dhe përgjegja në padi nga vet palët (padiësi dhe i padituri), të cilën edhe decidivisht e ka paraparë neni 403 pika 1 e LPK-së.

Gjykatësi nga Gjykata Komunale e Gjakovës,

Bardh Maksuti dhe ai nga Gjykata Komunale e Mitrovicës, Ramë Hyseni, deklarojnë se për këtë arsye është bërë praktikë që edhe të konstatohet në procesverbale se padia është lexuar, për faktin se e njëjta është kuptuar nga padiësi dhe i padituri. Sipas gjykatësve, ligji parasheh që ajo duhet të lexohet vetëm në rastet kur mungon padiësi.

Gjykatësi Ramë Hyseni, nga Gjykata Komunale e Mitrovicës, deklaroi se leximi i padisë po ashtu mund të ndodhë në shqyrtim për shkak të transparencës me të pranishmit tjerë. Mirëpo për gjykatësit, e rëndësishme është që palët ta kuptojnë padinë dhe të përgjegjen në padi.⁶⁷

Një shprehje dhe qasje e tillë e tillë e gjykatësve të cilët hezitojnë të jenë të përpiktë në përpilimin e saktë të procesverbalit, jo vetëm që i hedhë hije të keqe gjykatës dhe drejtësisë në Kosovë, por paraqet edhe problem praktik në rastet kur lënda apelohej dhe kur pritet nga gjykata e shkallës më të lartë të japë mendim në lidhje me rastin, ngase kjo gjykatë më e lartë është e privuar nga të gjitha infomatat rreth atij rasti.

Ndryshe nga vendoret, gjykatësit e EULEX, çdoherë në procesverbal fusin tërësisht rrjedhën, deklaratat dhe veprimet që janë marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përfundim

Edhe pse ka qenë rekomandim i vitit të kaluar, dhe i cili nuk është respektuar nga të gjithë gjykatësit/trupi gjykues, BIRN konsideron se është më se e nevojshme që gjykatësit të respektojnë dispozitat procedurale me rastin e përpilimit të procesverbalit gjatë shqyrtimit gjyqësor.

66. Ibid.

67. Tryptë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

KGjK duhet aplikuar masa ndëshkimore ndaj gjykatësve të cilët e neglizhojnë këtë segment të rëndësishëm të dokumentimit të procesit gjyqësor. Më anë të kësaj, do të respektohej edhe parimi i shqyrtimit publik të seancës gjyqësore, do të rritej besimi në gjykata dhe do të mundësohej punë më e lehtë për gjykatat e niveleve më të larta në rastet e apelimit të lëndës.

8. Ekzekutimi i lëndëve në gjykatat tona
Gjykatat tona në çdo nivel kanë një efikasitet me mesatare prej 84.5% në kryerjen e lëndëve, shifër e cila është arritur përkundër shumë mungesave objektive dhe subjektive në kryerjen e lëndëve.

Ajo që është vërejtur nga BIRN, tash e tre vite, është se gjykatat tona vazhdojnë të përballen me numrin shumë të madh të lëndëve të paekzekutuara, edhe pse deri tek ekzekutimi lënda ka kaluar nëpër faza të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme të gjykatave.

Nga viti 2009 për në vitin 2010 gjykatat tona kishin trashëguar si të paekzekutuara 89,201 lëndë, ndërkohë që këtyre lëndëve u janë shtuar edhe 26,921 lëndë gjatë vitit 2010.

Prej këtyre lëndëve vetëm 9,973 lëndë u ekzekutuan gjatë vitit 2010. 2011-në gjykatat tona e filluan me hiç më pak se 106,149 lëndë të paekzekutuara, të trashëguara nga vitet paraprake.

Gjatë vitit 2011, sipas raporteve të KGjK-së del se nga 106,149 lëndë të trashëguara nga viti 2010 ndërsa janë ekzekutuar 19,172 lëndë.

Pas iniciativës së USAID-it në bashkëpunim me KGjK-në përmes programit SEAD (Systems for Enforcing Agreements and

Decisions / Programi për përmbartimin e lëndëve) për ekzekutimin dhe regjistrimin e lëndëve të ekzekutimeve kanë bërë që numri i lëndëve të paekzekutuara të zvogëlohet dhe të këtë përparim të vogël në këtë fushë.

Nga numri i përgjithshëm i lëndëve të paekzekutuara, sa ishin në fillim të vitit 2011, gjykatat kanë ekzekutuar brenda këtij viti 19,172 lëndë, nga të cilat 2,462 janë vendime të gjykatave dhe 8,772 janë me dokument autentik, ndërsa të tjerat janë ekzekutimet e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë dhe ekzekutimet penale të Gjykatave Komunale.

Kreditori më i madh me dokumente autentike vazhdon të mbetet Posta dhe Telekom i Kosovës, e pasuar nga Korporata Energjetike e Kosovës.

Për BIRN mbetet shqetësues trendi i mos ekzekutimit të lëndëve me dokument përmbartues ose thënë ndryshe vendime të shumta të gjykatave në lëminë civile.

Nga viti 2010 ishin trashëguar 72,615 lëndë me dokument përmbartues, e këtij numri gjatë tërë 2011 iu shtuan edhe 13,687 lëndë të reja. Ndërsa për periudhën raportuese u ekzekutuan vetëm 8,772 lëndë me dokument përmbartues.

Si përfundim pa ekzekutuar me dokument autentik mbetën edhe 77,530 lëndë, çka e rritë numrin e lëndëve me 4,915 lëndë ose për 6.7%.

Një ndër gjykatat që vazhdon të ketë probleme me ekzekutimin e vendimeve të saj është edhe Gjykata Ekonomike e Qarkut, në të cilën gjykatë palët ankohen për mungesën e efikasitetit në ekzekutim të vendimeve të gjykatës.

Gjykatësit këtë vonesë e arsyetojnë me mungesën e marrëveshjeve me bankat komerciale në Kosovë, pasi që të njëjtat nuk i marrin parasysh vendimet e gjykatës për ekzekutimin e vendimeve.

Gjykatat tjera, numrin e madh të lëndëve të paekzekutuara e arsyetojnë me numrin e vogël të gjykatësve për këto lëndë, edhe pse gjyqësori i Kosovës ka kaluar në procesin e emërimit dhe riemërimit të gjykatësve.

Poashtu, si arsyetim tjetër përmendet mungesa e stafit mbështetës për gjykatësit e ekzekutimeve.

Njëkohësisht problem për mos ekzekutimin e shumë lëndëve është edhe ndërrimi i adresave të debitorëve, mungesa e adresave të sakta, mungesa e makinave për daljen në terren dhe gjendja ekonomike e debitorëve.

Gjykata Komunale në Prishtinë edhe gjatë vitit 2011 vazhdoi t'i prijë listës për nga numri i lëndëve të paekzekutuara në të dy lëmitë, me gjithsej 33,489 lëndë. Ajo pasohet nga Gjykatat Komunale në Pejë e Prizren me 9,083 përkatësisht 8,760 lëndë të paekzekutuara.

Pos USAID-it që me programin e saj SEAD ka zbutur deri në një masë gjendjen e keqe dhe rritjen e vazhdueshme të numrit të lëndëve të paekzekutuara, KGJK-ja po ashtu ka kontribuar në përmirësim të gjendjes me punësimin e disa zyrtarëve të përmbarimit.

Në anën tjetër nuk është i vogël as numri i lëndëve të paekzekutuara në lëminë penale.

Në gjykatat e Kosovës ka gjithsej 8,906 lëndë penale të paekzekutuara. Një numër kaq i madh i vendimeve penale të paekzekutuara tregon për mosefikasitet edhe në ekzekutimin e vendimeve penale.

Arsye për mos ekzekutimin e lëndëve të lëmisë penale janë të njëjta si me ato civile.

Gjithsesi mbetet edhe shumë për tu punuar në sjelljen e numrit të lëndëve të ekzekutimeve në një numër të pranueshëm për të gjitha gjykatat.

Përfundim:

Programi i KGJK-së dhe i USAID-it për regjistrimin dhe reduktimin e lëndëve të ekzekutimeve ka bërë që trendi në rritje i lëndëve të paekzekutuara të bie gjatë vitit 2011. Andaj BIRN konsideron se vazhdimi i një mbështetjeje të tillë nga USAID-i është i nevojshëm për reduktimin e këtij numri kaq të madh të lëndëve të paekzekutuara.

TË GJETURAT TEKNIKE

1. Mosefikasiteti i policisë për urdhërarrest

Mosefikasiteti i Policisë për urdhërarrest, vazhdon ta shoqërojë edhe më tej gjyqësorin e Kosovës.

BIRN gjatë monitorimit, ka identifikuar raste kur seancat gjyqësore nuk janë mbajtur, pikërisht për shkak të mosardhjes së palëve, apo thënë më mirë, për shkak të moszbatimit të urdhrit nga policia për sjellje të pandehurit në gjykatë, të lëshuar nga gjykata.

Edhe pse gjykata konform kodit të procedurës penale lëshon urdhërarrest më anë të të cilit i pandehuri do të duhej të sillet më forcë në gjykatë, sjellja e të pandehurve në seancën gjyqësore ndaj të cilëve gjykata ka lëshuar urdhër për sjellje të detyrueshme në gjykatë vazhdon të jetë problem për shkak të mosarritjes së zbatimit të kësaj urdhërese nga ana e policisë.

BIRN gjatë monitorimit ka identifikuar raste kur seancat gjyqësore, përveç se nuk janë mbajtur fare, disa prej tyre janë mbajtur pa praninë e palës së pandehur, më çka janë shkelur dispozitat e procedurës gjyqësore nga kryetari i trupit gjykues.

Në rastin konkret, kryetari i trupit gjykues, është ai i cili do të duhej të mos e vazhdonte gjykimin, ndërsa në anën tjetër të kërkojë arsyet e moszbatimit të urdhrit nga ana e policisë. Gjithashtu, policia do të duhej të sqaronte arsyet e mos-sjelljes së të pandehurve në gjykim.

Gjithashtu BIRN ka monitoruar seanca të cilat nuk janë mbajtur fare për shkak të mosefikasitetit të policisë për sjellje të detyrueshme të të pandehurve në gjykatë.

Raste të tilla janë shënuar në Gjykatën Komunale në Deçan, Lënda: “Lëndimi i rëndë trupor”, neni 154 par 1 i KPK-së. P.nr. 65/10, mbajtur më 22.11.2010;

Poashtu edhe në Gjykatën Komunale në Pejë, në çështjen penale: “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës dhe Lëndim i rëndë trupor” nga neni 164 par 1 dhe neni 154 par 1, P.nr:558/08, mbajtur më 13/05/2010. Seanca nuk u mbajt fare, për shkak se i pandehuri nuk u paraqit në shqyrtim pasi që nuk e kishte marr ftesën. I pandehuri ishte polic dhe gjykata i kishte dërguar ftesën në stacionin policor të Vitomiricës, pasi që fletëkthesa para këtij shqyrtimi ishte dërguar në stacionin policor në Pejë por ky stacion kishte konstatuar se polici punon në stacionin policor të Vitomiricës. Nga stacioni policor në Vitomericë ishte kthyer fletë kthesa me konstatimin se polici punon në stacionin policor në Pejë. Kjo të jep të kuptosh joseriozitetin e policisë në trajtim të ftesave të gjykatës.

Edhe në Gjykatën Komunale në Gjakovë në çështjen penale “Lëndim i rëndë trupor”, vepra penale nga neni 154 i KPK- së, P.nr. 533/07, mbajtur më 27/10/2010. Pasi në seancë nuk kishte ardhur i pandehuri, që sipas gjyqtarit kishte urdhëresë që policia ta sjellë në gjykim. Për këtë arsye, gjykata merr vendim me të cilin konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës dhe e shtyn gjykimin për datë 10.11.2010, në orën 11:45.

Sipas përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, kjo ndodhë për shkak të problemit me ndërrimin e vendbanimeve dhe mungesës së të dhënave për personat adekuat. Baki Kelani, zëdhënës në Policinë e Kosovës, shton se policia hasë edhe në raste kur dy persona kanë të njëjtin emër dhe mbiemër,

emërtimet e dyfishta të rrugëve, mungesa e informacionëve të kompletuara në urdhëresën dhe ftesën gjyqësore, problemët që PTK ka më rastin e dërgimit të urdhëresës së gjykatës në Polici etj., e të vështirësojnë punën e policisë për ta dërguar personin adekuat në gjykatë brenda kohës së paraparë.⁶⁸

BIRN identifikon po të njëjtat arsye të cilat vazhdojnë ta shoqërojnë këtë problematikë si ndërrimet e vendbanimeve dhe problemi me adresa. Përveç kësaj, problem vazhdon të jetë edhe komunikimi në mes të policisë dhe gjykatës. Policia, shumë rrallë e lajmëron gjykatën për mos-sjellje të të pandehurit në seancë.

Përfundim

Mos zbatimi i urdhrit nga ana e policisë dhe mos lajmërimi i gjykatës, mund të konsiderohen mospërmbushje e detyrës nga zyrtarët policorë, për dështimin e të cilëve gjykata do të duhej lajmëruar zingjirin komandues të policisë. Në anën tjetër, gjykatësit nuk do të duhej të mbanin shqyrtimin gjyqësor pa praninë e të akuzuarve, më kusht që procedura të mos jetë e ndarë ndaj të pandehurit që nuk është i pranishëm.

2. Problemet me transportin e të paraburgosurve për gjykim

Burgjet dhe qendrat e paraburgimeve kanë vazhduar që edhe gjatë vitit 2011 të kenë mungesë të automjeteve transportuese për të burgosur të cilët derisa nuk merret aktgjykim përfundimtar janë të obliguar të marrin pjesë në sanca gjyqësore nëpër gjykata.

Burgu i Dubravës, me afër 900 të burgosur ka

vetëm katër automjete për transportimin e të burgosurve. Qendrat tjera të paraburgimit janë në gjendje edhe më të vështirë se Dubrava, ngase e kanë vetëm nga një veturë në dispozicion. Për këtë arsye, shpesh ndodhë që këto qendra të kërkojnë huazim të veturave nga Dubrava. Situata ka qenë e njëjtë edhe në vitin 2010.

Mungesa e automjeteve për transportimin e të burgosurve dhe të atyre që janë në paraburgim, drejtpërsëdrejti rezulton në vonimin dhe zvarritjen e seancave gjyqësore.

3. Mos përdorimi i pajisjeve elektronike nëpër gjykata

Në bazë të nenit 348, paragrafi 5 i KPPK-së, kryetari i trupit gjykues, vendosë për mënyrën e regjistrimit të shqyrtimit gjyqësor. I njëjti nen, përkatësisht paragrafi 2, shprehimisht përcakton se mund të bëhet regjistrimi audio vizual i gjithë shqyrtimit gjyqësor.


Edhe pse ligji e parasheh këtë lehtësi teknologjike, e cila do të tejkalonte problemet me regjistrimin e të dhënave nga gjykimi, jo të gjitha gjykatat janë të pajisura me pajisje të cilat e mundësojnë këtë formë të arkivimit dhe dokumentimit të rrjedhës së proceseve gjyqësore.

Të gjitha gjykatat e Qarkut, kanë nga një sallë të pajisur me sistemin audio vizual, mirëpo këto janë përdorur në raste shumë të rralla.

Për ndryshim nga viti i kaluar ku në seancat gjyqësore është bërë audio/video incizimi në vetëm 0,9% të gjykimeve apo vetëm 20 gjykime nga gjithsej 2,147 seanca të monitoruara, në vitin 2011

68. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

Numri i seancave të monitoruara në të cilat është bërë/nuk është bërë audio/video incizimi



BIRN ka trajtuar të njëjtin problem vitin e kaluar, mirëpo institucioni përgjegjës që administron me gjykatat, nuk ka ndërmarrë asnjë masë e cila do të ndihmonte në vënien në funksion të këtij mekanizmi. Edhe pse mbajtja e gjykimeve nëpër zyre mund të dëgjohet si arsyetim për mospërdorjen e regjistrimit audio vizual, konsiderojmë se nuk ka arsye valide që kjo mundësi nuk shfrytëzohet atëherë kur është në dispozicion dhe kur është e mundur.

Përfundim

Çdo vit BIRN trajton të njëjtin problem dhe situata me audio inçizim të seancave gjyqësore nuk ndryshon fare. Audio inçizimi i seancave gjyqësore, ka një rëndësi të madhe për saktësinë e veprimeve procedurale në shqyrtim publik dhe në bazë të të cilit, në mënyrë të sigurtë, do të mund të ruheshin të dhënat e sakta nga gjykimi si deklaratimet e palëve, deklaratimet e dëshmitarëve, deklaratimet e gjykatësve, si dhe prezantimi i

provave tjera materiale.


Kryetarët e trupit gjykues/gjykatësit individual, do të duhej që ta aplikojnë në shumë audio incizimin, e këtë veçanërisht në seancat e rëndësisë më të madhe. Edhe pse ekzistojnë pajisjet elektronike nëpër disa nga sallat e gjykimeve, ku mbahen gjykimet, të njëjtat nuk përdoren fare.

4. Përdorimi i telefonave celularë gjatë mbajtjes së gjykimeve

Përkunder faktit se telefoni celular është ndaluar brenda objektit të gjykatës, një rregull i tillë vazhdon të mos respektohet edhe gjatë vitit 2011.

Përdorimi i telefonave celularë gjatë gjykimit vazhdon me intenzitet të njëjtë sikur vitin e kaluar. Derisa vitin e kaluar trupi gjykues apo gjykatësi i çështjes ka përdorur telefonin në 3.9% të seancave të monitoruara, gjatë këtij viti, telefoni është përdorur nga gjykatësit

Numri i seancave të monitoruara në të cilat është përdorur/nuk është përdorur telefoni



apo trupit gjyqësor në 2.29% të seancave të monitoruara, prokurorët 2.5%, ndërsa avokatët kanë përdorur celularin në 3.34% të rasteve të monitoruara.

Gjatë monitorimit të 1,920 seancave gjyqësore, BIRN ka identifikuar 201 gjykime kur është përdorur telefoni nga trupi gjyqësor, prokurori dhe avokati.


Është obligim i kryetarit të trupit gjyqësor që të kujdeset për mbarrëvajtjen e shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht për mos-përdorimin e telefonave në gjykim, së paku për të siguruar një seancë gjykim me dinjitet dhe

profesionalizëm.

Nga kjo përqindje, del se kemi një përmirësim të lehtë të kësaj shkeljeje. Megjithatë, konsiderojmë që përqindja mund dhe duhet të zbrësë edhe më shumë, pasi që reflekton në mbarrëvajtjen e seancës.

Përkundër rekomandimit të viteve të kaluara të BIRN-it se kryetari i trupit gjyqësor/gjykatësi i çështjes do të duhej të kujdesej që seanca të mos ndërprehet nga përdorimi i telefonave dhe në rastet e tilla, do të duhej t'i japë vërejtje atyre që përdorin, dukuria e njëjtë vazhdon të jetë prezentë në gjykatat tona.

Numri i seancave të monitoruara në të cilat janë/nuk janë përdor uniformat gjyqësore



Përfundim

Kryetari i trupit gjyqësor/gjykatësi i çështjes, do të duhej të shqiptojë edhe sanksione ndaj atyre që përdorin telefonin, e që realisht asnjëherë nuk ka ndodhur. Për më tepër, janë vet gjykatësit të cilët vazhdojnë të përdorin telefonat gjatë gjykimit.

5. Mosmbajtja e uniformës nga ana e gjykatësve, prokurorëve dhe avokatëve gjatë gjykrimeve

Mbajtja e uniformës gjatë shqyrtimit gjyqësor, është e rregulluar edhe më

dispozita ligjore. Në krahasim me vitin e kaluar, mbajtja e uniformës ka shënuar rritje për afër 20%. Derisa në vitin e kaluar nga 2,147 seanca të monitoruara, uniformën nuk e kanë bartur në 52.2% të seancave të monitoruara, gjatë këtij viti gjykatësit, prokurorët dhe avokatët, kanë filluar ta përdorin më shumë. Nga 1,920 seanca të monitoruara, në 686 prej tyre apo 35.73% uniforma nuk është përdorur nga askush.

bartjen e uniformës, duke mos respektuar kështu qarkoren e lëshuar nga kryetari i Gjykatës Supreme 2 vite më parë. Në bazë të së njëjtës qarkore, kryetari kishte kërkuar që gjatë shqyrtimit, uniformën ta përdorin edhe prokurorët dhe avokatët.

Në tryezën për diskutimin e të gjeturave të BIRN për gjyqësi, mbajtur me 25.06.2012, gjykatësit ankohen për mungesën e uniformave dhe fajësojnë KGJK-në për mos pajisje. Mirëpo përfaqësues nga KGJK, të pranishëm në tryezë, përkatësisht zëdhënësja Aishe Qorraj, deklaroi se për këtë nuk mund të fajësohen gjykatësit. “Është hapur tender dhe ende nuk është mbyllur” dhe “që nga 2013-ta, të gjithë gjykatësit detyrohen ta bartin atë” ka deklaruar Aishe Qorraj- Berisha.

Mos respektimi i Urdhëresave Administrative (Qarkores për bartje të uniformës) konsiderohet shkelje e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë nga gjykatësit dhe prokurorët.⁶⁹

Mbajtja e uniformës nga subjektet në procedurën gjyqësore, përveç respektimit të urdhëresës së Gjykatës Supreme, do t'i jepte poashtu natyrë më formale dhe zyrtare procesit të gjykimit. Palët dhe pjesëmarrësit tjerë në gjykim, do të kishin më shumë konsideratë dhe respekt për shqyrtimin gjyqësor dhe vet institucionin e gjykatës.

BIRN vazhdon të konsiderojë se është e nevojshme bartja e uniformës nga të gjithë

gjykatësit, prokurorët dhe avokatët gjatë shqyrtimëve gjyqësore. Kryetari i trupit gjykues/ gjykatësi i çështjes, do të duhej që me rastin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor të kujdesej për respektimin e këtij rregulli edhe nga prokurorët dhe avokatët.

TJERA:

Tranzicioni në Gjykata

Miratimi i Ligjit për Gjykata nga Kuvendi i Kosovës pritet të ndryshojë rregullimin strukturor të gjykatave dhe të prokurorive.

Sipas Institutit GAP, projektligji për Gjykatat ka qenë pjesë e strategjive legislative që nga viti 2008.⁷⁰ Sipas tyre, “ky ligj ka qenë edhe kërkesë e dy raporteve të fundit të Komisionit Evropian për Kosovën”.⁷¹

Sipas sistemit që zbaton Kosova, niveli i gjykatave fillon më atë supreme, për të vazhduar me gjykatat e qarkut, komunale dhe për të përfunduar me nivelin më të ulët, atë për kundërvajtje.

Edhe procesi i emërimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, është bërë në pajtueshmëri me këtë hierarki të gjykatave. Bazuar në Ligjin për Gjykatat, Planin e Zbatimit të këtij ligji nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe udhëzimet administrative të Këshillit Gjyqësor për shpërndarje të gjykatësve dhe lëndëve në sistemin e ri rregullativ,⁷² Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të drejtojë transferimin në sistemin e ri organizativ të gjykatave, që do të fillojë në janar të vitit 2013.

69. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, Neni 10, Pika 2.C

70. “Miratohet ligji për gjykata por do të hyjë në fuqi tek më 2013”. GAP Monitor: Instituti GAP. 2 Mars 2010, <<http://www.gapmonitor.org/index.php?id=2&n=174>>.

71. Ibid.

72. Ligji për Gjykatat. Kuvendi i Kosovës. <<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-199-alb.pdf>>;

Nga 2013-ta, të gjitha gjykatat për kundërvajtje, gjykatat komunale dhe ato të qarkut do të shndërrohen në një të vetme, në atë Themelore. Do të ekzistojë vetëm një gjykatë e Apelit me seli në Prishtinë dhe vetëm një Supreme.⁷³

Edhe pse janë bërë strategjitë e transferit dhe shpërndarjes së gjykatësve dhe lëndëve në sistemin e ri organizativ, përshtypjet e para janë se gjyqësori do të përballlet më një sfidë jo të vogël në vitet në vijim.

Sfidat që priten të shoqërojnë tranzicionin e gjykatave numërohen nga gjërat me teknike siç janë mungesa e objekteve për gjykata apo regjistrat e rinj, e deri te ato më përmbajtësore si themelimi i degëve të reja apo shpërndarja dhe vendosja e gjykatësve në departamentet dhe degët e reja.

Republika e Kosovës ka gjithsej 58 objekte të gjykatave për kundërvajtje, komunale dhe të qarkut. Shtatë nga këto objekte do të shndërrohen në objekte të gjykatave themelore, ndërsa objektet tjera pritet të përdoren për degë dhe departamente.

Një Gjykatë Supreme, një Gjykatë e Apelit dhe shtatë gjykata themelore me degët dhe departamentet e tyre do të jenë sistemi i ri gjyqësor i Republikës së Kosovës nga 2013-ta, në të cilat do të shpërndahen lëndet dhe gjykatësit.

Komisioni mbikqyrës i përbërë nga gjykatës profesionist dhe grupi punues i formuar nga ky komision, do të jenë trupa që do të bartin sfidën e këtij transferi.

Gjykata Themelore që bartë në vehte departamentet si atë për krime të rënda, departamentin e përgjithshëm, atë për të mitur, për çështje ekonomike dhe atë për çështje administrative, do të ketë edhe degët e saja në komunat gjeografikisht më të afërta.

Në bazë të analizës dhe hulumtimeve të bëra nga monitoruesit e BIRN-it, pritet që problemi kryesor të paraqitet me dy gjykatat themelore që do të formohen në Ferizaj dhe Gjakovë, ku përveç mungesës së objekteve adekuate, do të ketë problem edhe me gjykatës të cilët do të gjykojnë veprat e krimeve të rënda, për të cilat territore nuk kanë gjykuar më parë.

Të njëjtat gjykata do të kenë edhe degët e tyre në Shtërpce, Kaçanik përkatësisht Malishevë dhe Rahovec.

Njëjtë pritet të jetë gjendja edhe në Prishtinë, e cila përveç tjerash do të përbëhet edhe nga departamenti për çështje ekonomike dhe ai për çështje administrative.

Duke pasur parasysh formimin e degëve të reja dhe kompetencat e reja, pritet të shtrohet nevoja për staf të ri që do të mbështesë nevojat e reja.

73. http://kgjk-ks.org/repository/docs/Plani-i-Implementimit-te-Ligjit-per-Gjykata---Shqip_166260.pdf
Ligji për Gjykatat, Neni 8. Kuvendi i Kosovës.

Grupi Punues i krijuar nga komisioni për mbikëqyrje, ka planifikuar që deri në muajin nëntor të vitit 2012 të bëjë bartjen e lëndëve në të gjitha nivelet, ndërsa në muajin dhjetor 2012 të përfundojë shpërndarjen e gjykatësve.

Mirëpo i njëjti grup nuk ka paraparë nëse gjyqësori ka nevojë për staf të ri administrativ, i cili do të plotësonte nevojat në departamentet e degëve të reja.

Edhe pse është shtruar një bazë e mirë me procesin e emërimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, që nuk është lënë pa u përmendur edhe në raportin e progresit për Kosovën, duhet qenë skeptikë nëse e njëjta do të ndodhë në raportin e progresit për vitin 2013.

Pirja e duhanit në gjykata vazhdon të jetë shqetësuese

Pirja e duhanit në institucione publike është e ndaluar me ligjin për duhanin.⁷⁴ Ky rregull nuk vlen për shumicën e zyrtarëve të punësuar në gjykatat e Kosovës.

Gjatë monitorimit të më shumë se dy mijë seancave gjyqësore, monitoruesit e BIRN-it kanë vërejtur që gjykatësit, personeli administrativ i gjykatës, prokurorët, avokatët dhe palët tjera, që vijnë në gjykatë për shkaqe të ndryshme, e konsumojnë duhanin brenda objektit të gjykatës, sidomos gjatë pushimeve që ndodhin në mes të seancave gjyqësore.

Monitoruesit kanë qenë dëshmitarë kur gjykatësit, procesmbajtësit dhe prokurorët,

duke mos lënë anash avokatët, pijnë duhan në zyrat e gjykatësve. Raste të pirjes së duhanit janë evidentuar edhe në shkrimore apo korridore të gjykatave, përkundër disa vërejtjeve që kanë mundur t'i marrin nga sigurimi i gjykatës.

Në disa prej gjykatave, sidomos ato model, janë të vëna alarmet për tym dhe zjarr dhe jo rrallë herë ka ndodhur që këto alarme të aktivizohen.

Për të mos u penguar gjatë konsumimit të duhanit personeli është kujdesur që seansoret e këtyre paisjeve kundër zjarrit të mos mund të aktivizohen duke i mbuluar me kapak të plastikës dhe me letra.

Disa shembuj të mirë janë hasur në disa gjykata ku kryetarët e gjykatës kanë menduar për duhanxhinjtë ku atyre iu është lënë një hapësirë e caktuar për pirjen e duhanit.

Urdhërat Ndëshkimor

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, ka paraparë procedurën dhe rastet kur për kryrësit e veprave penale, mund të shqiptohet masa e urdhrit ndëshkimor.⁷⁵ Në bazë të kësaj dispozite, personat të cilët kanë kryer vepra penale të dënueshme deri në tre vjet burgim, dhe ndaj atyre që parashihet dënimi më gjatë, mund të sanksionohen nga gjykata me urdhër ndëshkimor që nënkupton dënimin e këtyre personave pa zhvillim të procedurës së rregullt penale, në rastet kur pala e akuzuar pajtohet me një propozim të tillë.

74. Ligji për Duhanin. Kuvendi i Kosovës.

75. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 476.

Monitorimi i BIRN-it në gjykatat komunale të Republikës së Kosovës, ka vërejtur se jo gjithëherë respektohen procedurat për shqiptimin e këtij urdhëri, e gjithashtu jo të gjitha gjykatat respektojnë procedurat më rastin e shqiptimit apo jo të një urdhëri ndëshkimor.

Gjatë monitorimit në gjykatat komunale, monitoruesit kanë vërejtur se edhe në rastet kur është mbajtur shqyrtimi në një çështje të caktuar, për shkak të mungesës së të akuzuarit ose për shkak se nuk ka pasur kushte për mbajtjen e gjykimit, prokurori komunal ka propozuar që për të njëjtën çështje, gjykata të japë urdhër ndëshkimor, edhe pse në rastin e tillë ishte dashur të vazhdohej shqyrtimi.

Në bazë të statistikave të të dhënave të monitorimit të gjykatave, del se veprat më të shpeshta penale për të cilat shqiptohet urdhëri ndëshkimor në gjykatat komunale janë: vjedhja e energjisë elektrike, vjedhje pylli, rrezikim i trafikut publik dhe në raste më të rralla lëndim i lehtë trupor.

Pas shqiptimit të kësaj mase, i pandehuri mund të kundërshtojë vendimin e gjykatës në afatin prej tetë ditësh, në të kundërtën vendimi behet i formës së prerë. Pas përfundimit të këtij afati, lënda konsiderohet e përfunduar.

Sidoqoftë, janë identifikuar gjykata dhe raste të shumta kur nuk respektohet afati i kundërshtimit dhe menjëherë pas shqiptimit të urdhërit ndëshkimor, lënda përfundon dhe e njëjta nëse kundërshtohet, merr numër të ri të lëndës, duke iu llogaritur kështu gjykatësve si lëndë e përfunduar edhe pse nuk ishte dashur të merr numër të ri dhe të evidentohet si e përfunduar. Një praktikë e tillë është vërejtur sidomos në gjykatat komunale në Malishevë, Rahovec, Deçan dhe

Therandë. Në këto gjykata, gjykatësit e evidentojnë si të kryer një lëndë në momentin kur ata japin urdhër ndëshkimor dhe kur bëhet kundërshtimi nga i pandehuri, lënda merr numër të ri.

Në këtë rast lënda e njëjtë merr dy herë numër dhe llogaritet si lëndë e re, duke reflektuar kështu në statistika të numrit të përgjithshëm të lëndëve në këto gjykata. Në bazë të kësaj, gjykatësve iu lejohej mundësia që të përmbushin normën e tyre mujore me lëndët të cilat në të vërtetë nuk i kanë kryer, sepse për të njëjtën lëndë mbahet shqyrtimi gjyqësor më vonë.

Për ndryshim nga gjykatat të cilat e konsiderojnë të përfunduar lëndën edhe nëse ajo goditet me kundërshtimin dhe mbahet shqyrtimi gjyqësor, ka gjykata të cilat nuk e aplikojnë këtë rregull. Të tillë janë gjykatësit nga gjykatat komunale në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Gjakovë dhe shumicën e gjykatave tjera, të cilët kanë deklaruar se mund të evidentojnë një lëndë si të kryer vetëm kur ajo nuk kundërshtohet.

Në gjashtë mujorin e fundit të vitit 2011 në gjykatën komunale në Malishevë, nga tre gjykatësit e kësaj gjykate janë shqiptuar rreth 220 urdhëra ndëshkimorë. Të gjitha këto lëndë janë evidentuar si të kryera edhe pse për to ka pasur raste kur është bërë kundërshtimi.

Sipas panelistëve gjykatës dhe prokurorë të pranishëm në tryezën e BIRN-it për diskutimin e të gjeturave nga gjyqësia, lëndët që kanë të bëjnë me urdhërat ndëshkimor, nuk duhet të marrin nga dy numra në momentin kur ankimohen. Fillim Skoro, gjykatës në Gjykatën e Qarkut në Prizren, deklaroi se në rastet e tilla ishte dashur që KGJK t'i lajmërojë gjykatat, për faktin se kjo shfrytëzohet për çështje të normës nga gjykatës të ndryshëm.

Shaqir Zika nga Gjykata Komunale në Rahovec dhe Nuredin Abazi nga ajo e Therandës, deklarojnë se kjo ka qenë praktikë e gabuar nga gjykatat e tyre dhe me ardhjen e tyre në krye të gjykatës, lëndët më urdhërat ndëshkimor nuk marrin më numër të ri. Sipas të parit, kjo praktikë është ndalur në Gjykatën Komunale në Rahovec nga viti 2010, ndërsa sipas të dytit, nga mesi i vitit 2011, në Gjykatën Komunale në Therandë lëndët më urdhër ndëshkimor nuk marrin numër të ri.⁷⁶

Mirëpo, monitorimi i BIRN, vërteton se në Gjykatën Komunale në Therandë, lëndët më urdhër ndëshkimor janë pajisur më numër të ri gjatë tërë vitit 2011.⁷⁷

Marrja e urdhërit ndëshkimor është duke u praktikuar çdo ditë e më shumë pothuajse nga të gjithë gjykatësit e gjykatave komunale në Kosovë.

Shumë lëndë të vjetra për të cilat ka prova të mjaftueshme se i pandehuri ka kryer veprën penale, mund të kryhen, mirëpo mosunifikimi për dhënien apo mosdhënien e numrit të ri lëndës në rastet kur bëhet kundërshtimi është si duket një çështje ende e pazgjidhur në sistemin tonë gjyqësor.

76. Tryezë për diskutimin e të gjeturave të monitorimit mars-dhjetor 2011. BIRN. 25 qershor 2012. Prishtinë.

77. Në Gjykatën Komunale në Suharekë, lëndët me urdhër ndëshkimor gjatë vitit 2011 kanë marrë numra të ri pasi që palët kanë paraqitur ankesë. Lënda me urdhër ndëshkimor që në fillim ka pas numrin Pnr:410/10, pas kundërshtimit nga pala ka marrë numrin e ri Pnr:725/11, kundërshtimi është bërë me datën 28.12.2011. Lënda për veprën penale e rrezikimit të trafikut publik nga neni 297 para 3 i KPK-së, ka pasur fillimisht numrin Pnr:369/10, ndërsa pas kundërshtimit e njëjta lëndë merr numrin Pnr:623/11, kundërshtimi është bërë me datën 14.11.2011. Një lëndë e njëjtë është po ashtu ajo me numër Pnr:127/10, por pas paraqitjes së kundërshtimit e njëjta lëndë merr numrin e ri Pnr:484/11, kundërshtimi është bërë me datën 25.08.2011.

REKOMANDIMET:

Rekomandimet për Parlamentin e Kosovës:

Nga rekomandimet e vitit të kaluar të cilat BIRN i ka paraqitur në raportin e monitorimit të gjykatave për vitin 2010, Parlamenti i Kosovës ka miratuar ligjin për dëshmitarët.

Ndërsa si i paplotësuar ka mbetur rekomandimi në vijim:

- Komisioni parlamentar për legjislacione e gjyqësi, duhet të monitorojë në mënyrë më rigoroze zbatimin e legjislacionit gjyqësor;

Sipas të gjeturave të raportit të monitorimit të gjykatave për vitin 2011, si rekomandim për Parlamentin e Kosovës është si në vijim:

- Komisioni për legjislacione e gjyqësi, duhet të lejojë qasje më aktive të shoqërisë civile në procedimin dhe miratimin e legjislacionit gjyqësor;

Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës:

Shumë shpesh Qeveria e Kosovës është akuzuar për moskrijimin e kushteve të nevojshme për funksionim të gjykatave dhe prokurorive. Një rast eklatant i cili ka ngjallur indinjatë të thellë ka qenë momenti kur Qeveria e Kosovës ka lejuar që buxheti i pashpenzuar për Prokurorinë e Kosovës për paga, të përdoret për ngritje retroaktive të pagave të prokurorëve.

Një hap i tillë është kritikuar ashpër nga publiku dhe shoqëria civile në Kosovë, duke rezultuar me tërheqjen e këtij vendimi, ngase një hap i tillë është konsideruar si favorizim i një segmenti të sektorit të drejtësisë. Edhe sot e kësaj dite, mjetet e paguara në mënyrë të parregullt si paga shtesë të prokurorëve nuk janë kthyer në

buxhetin e Kosovës.

Një problem tjetër të cilin konsiderohet se është obligim i Qeverisë së Kosovës, është edhe mos-sigurimi i hapësirave adekuate për funksionim të të gjitha gjykatave dhe prokurorive në Kosovë. Përpos problemit të ndërtesës së Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut të Mitrovicës, qëndron fakti se edhe një numër i madh i gjykatave model ka mungesë të numrit të mjaftueshëm të sallave të gjykimit dhe hapësirave tjera për funksionim normal.

Rekomandimet e paplotësuara nga viti i kaluar:

- Qeveria e Kosovës duhet të garantojë transparencë në përpilimin e legjislacionit nga fusha e drejtësisë;
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë buxhet të mjaftueshëm në përputhje me kërkesat e KGJK-së;
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mjete të mjaftueshme për programin e dëshmitarëve të mbrojtur;

Përpos rekomandimeve të paplotësuara nga raporti i kaluar, këtë vit i shtohen edhe disa rekomandime tjera, duke e zgjatur detyrat dhe obligimet e Qeverisë së Kosovës ndaj sektorit të drejtësisë në Kosovë, si në vijim:

- Qeveria e Kosovës duhet të ndajë fonde për ndërtimin e objekteve të standardeve bashkëkohore për gjykatat e vendit;
- Qeveria e Kosovës duhet të procedojë ligjin për pensionet e gjykatësve.

Rekomandimet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

Nëse krahasohen rekomandimet të cilat janë dhënë për KGjK-në në raportin e vitit 2010,

mund të vërehet një përmirësim i vogël, sidomos në gjërat teknike si në tabelën në vijim:

	Viti 2010	Viti 2011
Lajmërimi i gjykimeve	49.9%	72.12%
në tabelën e shpalljeve		
Bartja uniformës (nga të gjithë gjykatësi, prokurori, avokati)	3%	9%
Përdorimi i Sallave	42.7%	43.85%
të gjyqimit		
Mospërdorimi i telefonave gjatë seancës	87.3%	89.62%

Mirëpo, shqetësuese vazhdon të mbetet situata me numrin e vogël të gjykatësve dhe prokurorëve, numrin e madh të lëndëve të pa-ekzekutuara, numrin e madh të lëndëve të parashkruara dhe atyre që rrezikojnë parashkrimin, mungesën e transparencës, etj..

Për të pasur një pasqyrë të saktë të rekomandimeve që nuk janë plotësuar, edhe pse të rekomanduara vitin e kaluar, kemi bërë një ndarje të atyre që nuk janë plotësuar dhe atyre që kanë të bëjnë me këtë periudhë raportuese.

Sipas Raportit të vitit 2010, del se Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka arritur që:

- të plotësojë sa më shpejtë numrin

vakant të gjykatësve dhe prokurorëve në gjykata dhe prokurori të të gjitha niveleve;

- të sigurojë transparencë më të madhe në dhënien e informatave me detaje për veprimtarinë e gjyqësorit;

- të bëjë vlerësimin e performancës së fletëdorëzuesve dhe të marr masa disiplinore ndaj fletëdorëzuesve të cilët neglizhojnë punën e tyre;

- të ndërmerrë masat e nevojshme për mospërdorimin e telefonave brenda objektit të gjykatës;

- të kujdeset për respektimin e kodit të uniformës në shqyrtimet gjyqësore;

- të sigurojë që seancat gjyqësore të mbahen në sallat e gjykimeve, atëherë kur kjo është e mundur;

- të sigurojë që pranë secilës gjykatë të

- të kujdeset për hapjen e faqes zyrtare të internetit ku do të shpallëshin koha dhe vendi i mbajtjes së gjykimeve si dhe ku do të bëhej shpallja e aktgjykimeve;
- Kryetarët e trupave gjykues/ gjykatësit duhet të informojnë kryeprokurorin për mungesën e prokurorit publik në seancat që ndjekin sipas detyrës zyrtare;
- të kujdeset për aktivizimin dhe respektimin e sistemit të audio dhe video incizimit të seancave gjyqësore;
- Gjykatësit e çështjes duhet të kujdesen që ftesat gjyqësore të shënohen të plota dhe të jenë të mbyllura ashtu si është paraparë më ligj;
- Kryetari i trupit gjykues/ gjykatësi i çështjes dhe administratori, duhet të lajmërojnë në komisionet përkatëse disiplinore rastet kur fletëdorëzuesit nuk kanë dorëzuar ftesën në mënyrë të rregullt;
- Kryetari i trupit gjykues/ gjykatësi i çështjes nuk duhet të përdorin telefonin celular gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- Kryetari i trupit gjykues/ gjykatësi i çështjes duhet të sigurojë mbarëvajtjen e shqyrtimit gjyqësor duke mos lejuar përdorimin e telefonit gjatë shqyrtimit gjyqësor nga palët dhe pjesëmarrësit tjerë në gjykim;

Përpos rekomandimeve të cekura më lartë, ky Raport i Monitorimit të gjykatave për vitin 2011 del me Rekomandimet e vitit 2011 për KGjK-në si në vijim:

- KGjK, përkatësisht sekretariati i KGjK-së duhet të kërkojë nga administratorët e gjykatave model, zbatimin e programit për gjykatat model;
- Gjykatësit duhet që përmes kolegjiave të caktojnë politikë të përbashkët ndëshkimore për lëndë të cilat përsëriten;
- Gjykatësit duhet të aplikojnë politikë ndëshkimore adekuate për kryrësit e veprave

penale që kanë të bëjnë më zgjedhjet në proporcion me veprat e kryera;

- Gjykatësit duhet të jenë më të koordinuar me prokurorët më rastin e caktimit të gjykimeve;
- KGjK përmes një qarkore, duhet të ndalojë praktikën e marrjes së numrave të rinj të lëndëve më urdhër ndëshkimor, me rastin e ankimit të tyre;
- Gjykatësit janë të obliguar që të konstatojnë në procesverbal gjithë rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor;
- KGjK dhe USAID, duhet të vazhdojnë me programin për regjistrimin dhe reduktimin e lëndëve të ekzekutimeve.
- Duhet të amgazhohet dhe të koordinohet me Policinë e Kosovës dhe komunat e Kosovës për zgjidhjen e problemit të emërimit të rrugëve dhe vendbanimeve nëpër komunat e Kosovës;
- KGjK më kërkesën e gjykatave përkatëse, duhet ta rrisë numrin e fletëdorëzuesve;
- KGjK duhet të kërkojë përgjegjësi dhe llogari nga PTK për mënyrën e shpenzimit të mjeteve për postierët që kryejnë përgjegjësi në lidhje më ftesa;
- KGjK duhet të bëjë projekte lidhur me rritjen e hapësirave për gjykatës dhe personel të gjykatës në kuadër të rritjes së numrit të gjykatësve.
- KGjK duhet të intervenojë sa më shpejt që të krijohen kushtet për hapësirat e veçanta për dëshmitarët e mbrojtur;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duhet të ndërmarrë të gjitha masat disiplinore ndaj gjykatësve dhe personelit tjetër të gjykatave, për fajin e të cilëve janë parashkruar lëndët;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkatësisht Departamenti për Statistika, duhet të ketë të gjitha statistikat e lëndëve të parashkruara nga të gjitha gjykatat të ndara dhe të filtruara në mënyrë adekuate dhe veç e veç;

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, sa më parë duhet të sanksionojë me rregulla ligjore çështjen e lajmërimit ndërmjet gjykatave për personat ndaj të cilëve janë duke u zhvilluar procedura;
- Të gjitha Gjykatat e Kosovës duhet të kryejnë obligimin e njoftimit të gjykatave kompetente për personat ndaj të cilëve zhvillohen procedura;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të bëjë unifikimin e interpretimit të udhëzimit administrativ 2008/02, më anë të të cilit të gjitha gjykatat interpretojnë në mënyre unike dispozitat për taksat;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duhet të sigurojë përkthim adekuat për palët në procedurë në shqyrtimet gjyqësore që ka nevojë;

Rekomandimet për Këshillin Prokurorial të Kosovës:

- Prokurorët duhet të jenë më të koordinuar me gjykatësit më rastin e caktimit të gjykimeve;
- KPK duhet të plotësojë pozitën e zbrazëta me prokurorë në të gjitha nivelet e prokurorive;
- Prokurorët duhet të jenë më të përgatitur në përfaqësimin e aktakuzave;
- KPK (Këshilli Prokurorial i Kosovës), duhet të marrë masa ndaj prokurorëve të cilët shkojnë në përfaqësimin e aktakuzave pa aktin akuzues, të cilën në raste të caktuara huazojnë nga gjykatësit;
- KPK duhet të sigurojë transparencë më të lartë të prokurorëve dhe gatishmëri të tyre për të qenë më komunikativ ndaj mediave dhe qytetarëve, gjithmonë duke mos i rrezikuar hetimet dhe proceset gjyqësore.

Rekomandimet për Policinë e Kosovës:

Problem i vazhdueshëm për Policinë e Kosovës është se nuk po arrijnë të përmbushë rekomandimin e viteve të kaluara dhe i cili ka të bëjë me dështimin e Policisë për të sjellur me kohë personat të cilët gjykata i ka kërkuar. Arsyeja e Policisë vazhdon të mbetet ndërrimi i vendbanimeve dhe i adresave, emrat e njëjtë, etj..

Rekomandimi me të cilat ka dalur raporti i Monitorimit të gjykatave për vitin 2010 saktësisht ka cekur se Policia e Kosovës duhet të respektojë dhe zbatojë deri në fund urdhëresat e gjykatës për sjellje në gjykatë të të pandehurve dhe personave tjerë sipas kërkesës së gjykatës.

Si rekomandim i raportit të vitit 2011 për Policinë e Kosovës janë:

- Duhet të amgazhohet dhe të koordinohet me KGJK-në dhe komunat e Kosovës për zgjidhjen e problemit të emërimit të rrugëve dhe vendbanimeve në për komunat e Kosovës;
- Duhet ta njoftojë gjykatën për moszbatimin e urdhëresës dhe arsyeën pse e njëjta nuk është zbatuar;
- Duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ndaj atyre policëve që nuk zbatojnë urdhëresat e gjykatës, apo që neglizhojnë përgjegjësitë e tyre ndaj gjykatave.

REKOMANDIMET:

BIRN sinqerisht falënderon të gjithë pjesëmarrësit e mëposhtëm në tryezën e rrumbullakët për kohën e tyre, reagimet dhe transparencën e treguar gjatë diskutimit të problemeve të sistemit gjyqësor dhe gjetjeve nga procesi i monitorimit të gjykatave:
Baki Kelani, zëdhënës i Policisë së Kosovës;

Aishe Qorri Berisha, zëdhënëse e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGjK;

Fillim Skoro, Gjykata e Qarkut në Prizren;

Xhevdet Abazi, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë;

Shyqyri Sylaj, Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë;

Ramiz Azizi, Gjykata Komunale në Gjirokastrë;

Sadedin Gacaferi, Gjykata Komunale në Pejë;

Bashkim Hyseni, Gjykata Komunale në Ferizaj;

Ramë Hyseni, Gjykata Komunale në Mitrovicë;

Bardh Maksuti, Gjykata Komunale në Gjakovë;

Skender Çoçaj, Gjykata Komunale në Prizren;

Agim Maliqi, Gjykata Komunale në Ferizaj;

Gani Zabeli, Gjykata Komunale në Lipjan;

Lulzim Paqarizi, Gjykata Komunale në Malishevë;

Nuredin Abazi, Gjykata Komunale në Suharekë;

Ramadan Gudaçi, Gjykata Komunale në Kaçanik;

Shaqir Zika, Gjykata Komunale në Rahovec;

Aziz Podvorica, Gjykata Komunale në Podujevë;

Haki Gecaj, Prokuroria Komunale në Prishtinë;

Ali Selimaj, Prokuroria Komunale në Gjakovë;

Flamur Ramadani, Oda e Avokatëve të Kosovës.

